

BIBLIOTEKA

80  
LL 85

XHEVAT LLOSHI

**MBESHTETJE**

**PER GJUHEN**

**LETRARE**



80  
LL 85

XHEVAT LLOSHI

MBËSHTETJE  
PËR GJUHËN LETRARE



BOTIMET TOENA

*Redaktore teknike:* Irena Toçi

*Botues:* FATMIR TOÇI

©Copyright 1997: Autori

**SHTËPIA BOTUESE TOENA**  
Rr. "Muhamet Gjollësja"; K. Postare 1420, Tiranë  
Tel: (042) 40116; 40117  
Tel.Fax: (042) 27232

# KULTURA SHQIPTARE PËRPARA SHQETËSIMESH TË REJA

- Rreth librit të Arshi Pipës  
“Politika gjuhësore në Shqipërinë Socialiste” -

Nuk besoj që gjatë vitit 1989 në gjithë gjuhësinë botërore të jetë botuar një libër me mendësi më të prapambetur se ai i Arshi Pipës.

Titulli anglisht i librit është : “*The Politics of Language in Socialist Albania*”. Është botuar më 1989 në SHBA në serinë Monografi për Europën Lindore, nr. CCLXXI, që shpërndahen nga Shtëpia Botuese e Universitetit të Kolumbias, Nju Jork. Përfshin 283 faqe me germa të vogla dhe, përveç hyrjes, shënimeve, bibliografisë dhe treguesit, ka 11 kapituj. Nuk ka nevojë që të lexohet i gjithë libri, për të rrokur idetë e tij themelore. Ato janë shpalosur që në parathënie dhe 283 faqet e tjera sillen për t’i argumentuar. Mirëpo kur e përfundon librin, bindesh se ky nuk është një vështrim shkencor për politikën gjuhësore, por është thjesht politikë në kuptimin popullor të fjalës: më thua diçka me zell e me zjarr, më betohesh se e ke me sinqeritet e vetëm për të mirën time, më përgjërohesh e më siguron se do të më shpëtosh nga rreziqe të mëdha e, megjithatë unë e ndiej, pavarësisht se më është turbulluar mendja e prekur zemra, që këtu ka diçka tjetër, ka një kurth. Ky

libër e thotë dhe e kërkon hapur, që ne të ndjekim modelin serbo-kroat, domethënë të ndahemi në dy gjuhë të veçanta, në dy kultura, rrjedhimisht edhe në dy kombe, siç u ndanë serbët dhe kroatët. Shënimet e mëposhtme kanë qëllim pikërisht të zbulojnë se si ca përpjekje për të hedhur dritë mbi një çështje madhore të identitetit kombëtar të shqiptarëve, në të vërtetë e mohojnë këtë identitet.

1.

Ideja themelore e Arshi Pipës është se: “E shtuquajtura gjuhë letrare e njësuar as ka qenë e nevojshme dhe as e ka kërkuar populli shqiptar, meqë shqiptarët prej kohësh kanë qenë mësuar me bashkekzistencën e tyre paqësore dydialektëshe”. (f. XVI). Për ta provuar këtë, autori ndërmerr një rishikim tërësor të historisë, kulturës, letërsisë, etnografisë dhe personaliteteve të Shqipërisë.

A janë shqiptarët një popull dhe një komb? Sipas A. Pipës nuk janë. Veriu dhe jugu, gegët dhe toskët, kanë ecur historikisht në dy rrugë të ndryshme, prandaj përfaqësojnë dy orientime të kundërta kulturore, dy mendësi të papajtueshme deri në urrejtje, madje, edhe një pjesë të madhe i ka munguar patriotizmi, nuk ka pasur dashuri për atdheun. Jemi të detyruar të japim citime të gjata nga monografia, sepse çdo lexues ka të drejtë të revoltohet e të thotë: nuk është e mundur të ketë një shqiptar që të predikojë gjëra të tilla!

E megjithatë në parathënie shkruhet: “Gegët, që janë kryesisht myslimanë ose katolikë (pak janë ortodoksë), janë të orientuar nga Perëndimi, duke qenë të gjithë katolikët gegë, ndërsa toskët, që janë myslimanë ose ortodoksë, janë të orientuar nga Lindja, duke qenë bashkësia ortodokse shqiptare kryesisht toske.”(f. XII). Argumenti i autorit është historik dhe fetar: këto dy pjesë kanë qenë të pushtuara nga dy perandori të ndryshme (Romake dhe Bizantine) dhe janë përfshirë në dy sisteme të ndryshme fetare (ashtu si serbët dhe kroatët, paralelizmin mund ta nënkuptojë vetë lexuesi dhe nuk do ta përsërisim më tej). Pra, atë që përbën thelbin e një shqiptari të Veriut dhe të një të Jugut nuk e

ka krijuar rruga mijëvjeçare e këtij populli në trojet e veta, por e kanë krijuar pushtuesit e huaj dhe fetë e ardhura. Janë të huajt që na kanë bërë, mjafton që dikush të vihej mbi ne nga ana shtetërore, fetare e kulturore dhe tek ne nuk mbetet gjë shqiptare, përkundrazi, përjetësohej e huaja.

Dhe kështu A. Pipa u përvishet toskëve ortodoksë: “Në kulturën e ortodoksëve shqiptarë mbisundon bizantinizmi i: në folklorin, traditat e legjendat, në manastire e kisha. Kjo duket në toponiminë e shumë fshatrave e qyteteve, në disa nga zakonet e tyre dhe gjithashtu në emrat e tyre.

Kjo shpjegon pakënaqësinë e rrënjosur thellë tek ata kundrejt qytetërimit perëndimor dhe, në fushën e gjuhës, kundërshtimin e tyre ndaj vazhdimësisë iliro-shqiptare. Për ta Iliria do të thotë Iliriku romak, kurse Ilirizmi i do të thotë lëvizja kulturore kroate me po atë emër. Por meqë pushtetin e kanë myslimanët përgjithësisht dhe katolikët janë tërësisht për teorinë e origjinës ilire, shqiptarët bizantinë nuk kanë guxim t’u kundërshtojnë hapur.” (f. 206).

Studiuesit shqiptarë jo vetëm të gjuhësisë, por edhe të arkeologjisë, të historisë, të etnografisë, të folklorit kanë dhjetëra vjet që me një punë shkencore të miratuar në nivel botëror po sjellin argumente bindëse për vazhdimësinë iliro-shqiptare. E quaj se më lejohet të përfaqësoj zërin e tyre për të kundërshtuar prerazi akuza të tilla, për të cilat nuk do të shtoj epitete as këtu dhe as më poshtë, sepse nuk më lejon dinjiteti i të gjithë atyre, zërin e të cilëve marr leje të përfaqësoj.

Siç dihet, shumë shqiptarë kanë emigruar për arsye ekonomike në vende të ndryshme. Një koloni e madhe është edhe në SHBA, ku shumica dërrmuese janë nga Shqipëria e Jugut. Libri i A. Pipës është botuar në SHBA. Do të dëshiroja që ata të lexojnë se çfarë thotë A. Pipa për ta dhe për vëllezërit e tyre në atdhe: “Shqiptarët ortodoksë bizantinë nuk duan të dëgjojnë për ilirët dhe gjuhën e tyre, sepse “ilir” është e lidhur në mënyrë të pashlyeshme si me “gegë” ashtu edhe me “katolik” në mendjet e tyre. Ata i shohin shtrembër gegët, meqë kanë frikë prej tyre, sepse përbëjnë shumicën, kurse katolikët i urrejnë se janë papistë.” (f. 181).

Por ka edhe shqiptarë të vendosur historikisht në Itali, të cilët gjithashtu janë kryesisht nga Shqipëria e Jugut. (Që të mos ngatërrohet lexuesi, po i kujtojmë se SHBA dhe Italia janë në Perëndim). Edhe ata A. Pipa nuk i kursen: “Studiuesit arbëreshë të Italisë përgjithësisht nuk janë në favor të tezës së vazhdimësisë iliro-shqiptare. Pse? Sepse kultura e arbëreshëve të Italisë ka një vullë të fortë bizantine.” (f. 180).

Megjithatë A. Pipa nuk mund të kënaqej duke laskaruar vetëm një pjesë të toskëve. Pa marrë para sysh faktet historike, kontradiktat e thella që i hapen në arsyetimet e veta, kapërcimet kokëteposhtë nga një absurditet te tjetri, ai ecën me këmbëngulje në drejtimin që ka caktuar. Dhe ja një përgjithësim i tillë: “Dallimet krahinore ndërmjet gegëve e toskëve ndoshta janë pasojë e dallimeve fetare (cuius regio, huius religio).” (f. 210). Thënia latine në kllapa ka kuptimin: njeriu pranon fenë e atij që sundon. Pra ne jemi ndarë në gegë e toskë sipas fesë që kemi pasur, si pasojë e sundimtarëve të huaj që kemi pasur mbi krye. Mirëpo si i bëhet që shumica e popullsisë ka qenë myslimane si në Veri dhe në Jug, kurse perandoritë që na kishin pushtuar, na kishin gllabëruar tërësisht e jo copa-copa? Kini durim, se prandaj ka shkruar qindra faqe A. Pipa, që të ketë vend të lirë t’u përvishet mbarë e mbrapsht edhe atyre.

“Është e vërtetë, - thotë ai, duke përmendur Shkodrën, - se qyteti dhe rrethinat e tij përfshijnë një numër të mirë myslimanësh. Megjithatë kontributi i tyre për kulturën shqiptare ka qenë më pak i dukshëm. Sa për patriotizmin, pjesëmarrja e tyre në lëvizjen kombëtare nis me Lidhjen e Prizrenit, vetëm me ndonjë shfaqje të rastit para saj.” (f. 198). E dëgjoni ju, myslimanët e Shkodrës? Deri në fund të shekullit të kaluar ju pak keni dhënë për kulturën shqiptare, sa për patriotizmin, për nja 300-400 vjet nuk keni pasur asnjë pikë. Por mos u mërzitni, sepse: “E njëjta gjë është e vërtetë, - vijon po aty A. Pipa, - për myslimanët e Shqipërisë së Mesme e të Jugut, ndonëse disa prej tyre, veçanërisht toskët, u bënë udhëheqës të shquar të periudhës së Rilindjes.”

Dikush mund të kundërshtojë: po ja, megjithatë autori ka pranuar disa udhëheqës të shquar të Rilindjes! Ashtu vërtet, por mos kini asnjë iluzion se ky autor heziton qoftë edhe një thërrime në revanin e tij. Krijimi i gjuhës së përbashkët, thotë A. Pipa: "Ishte një veprim hakmarrës, i nxitur nga një ndjenjë e fuqisë më eprore intelektuale të toskëve, së cilës ia ka hedhur manovrimi politik i gegëve në bërjen e historisë shqiptare. Të marrim, për shembull, Abdyl Frashërin, organizatorin toskë të Lidhjes së Prizrenit. Atë e arrestuan dhe ndenji pesë vjet në burg. Ali Pashë Guçia, kryekomandant i forcave të armatosura të Lidhjes u bë mytesarif i Pejës.

Ismail Qemali, një burrë shteti liberal dhe organizues e themelues i pavarësisë së Shqipërisë, ka qenë toskë. Ai që i voli frytet e pavarësisë ishte "maloku i shkathët" që u bë mbret. Heroi kombëtar shqiptar gjithashtu ka qenë gegë." (f. 192).

Besoj se është e qartë si e rishikon historinë tonë A. Pipa: sipas tij, Ali Pashë Guçia ia ka hedhur Abdyl Frashërit, kurse A. Zogu ia ka hedhur I. Qemalit. I lumtë Skënderbeut që ka qenë gegë, se ndryshe kushedi ç' do ta gjente në këto lloj monografish. Por ka edhe më:

Kështu ka qenë në lashtësi: "Sundimtarët që kanë lënë emër në historinë e lashtë kanë qenë nga ato pjesë të Ilirisë, që janë ose kanë qenë Shqipëria e Veriut: mbretërit ardianë, perandorët ilirë të Romës (Diokleciani, Konstandini, Justiniani). Është e vërtetë që Pirroja i mundi romakët. Por pas vdekjes së tij, Teuta e pushtoi Epirin." (po aty). Pra edhe Pirroja i Epirit e mori shqelmin që i takonte, si ka guxuar ai të ishte nga Jugu e të thyente romakët?

Kështu është edhe sot: "Nënë Tereza, e para shqiptare që ka marrë një çmim ndërkombëtar, është një kosovare katolike, në një kohë që kosovarët janë pothuaj qind për qind myslimanë. E megjithatë një shqiptar, i lindur në një familje bektashinjsh, e shpalli Shqipërinë vendin e parë ateist në botë." (f. 191).

Është krejt e mundur, që duke u nisur nga kjo monografi shkencore, të shkruash një *pamflet humoristik*, për një revistë satirike. Por këto faqe e lëndojnë kaq thellë ndjenjën kombëtare të çdo shqiptari, sa që je i detyruar të bëhesh serioz përpara gjërave të tilla tmerrësisht shqetësuese për kulturën shqiptare.



Fati tragjik e solli që pothuaj gjysma e popullsisë shqiptare të mbetej jashtë kufijve të Shqipërisë si shtet. Me vendosmëri të patundur i shkel me këmbë A. Pipa edhe ata, edhe historinë e kulturën e tyre.

“Rasti i kosovarëve myslimanë është i ndryshëm. Ata i mbetën besnikë islamizmit dhe sulltanit (siç e tregojnë edhe këngët e tyre epike) deri në Lidhjen e Prizrenit, në të cilën roli i tyre që mbizotërues vetëm pasi Fuqitë e mëdha vendosën që Plavën dhe Gucinë t’i mernte Mali i Zi... Trupat e parregullta të kosovarëve në shërbim të qeverisë turke shtypën kryengritjen maqedone (1901-1902) dhe njëkohësisht kanë bërë mizori kundër serbëve. Qëndrimi i tyre pro Turqisë në përgjithësi ndryshoi gradualisht, kur disa prej udhëheqësve më të ndriçuar (Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Dervish Hima) e kuptuan se ditët e Perandorisë Osmane ishin të numëruara.” (f. 198).

Le ta themi me fjalë të tjera, atë që është shkruar nga A. Pipa. Kosovarët myslimanë nuk kanë qenë asnjëherë patriotë. Edhe eposi i tyre tregon besnikërinë ndaj islamizmit e sulltanit. Studiuesit serbë e kanë sharë eposin e kreshnikëve dhe kanë pasur plotësisht të drejtë, ja ku e thotë vetë studiuesi shqiptar A. Pipa më 1989. Kosovarët u kujtuan vetëm kur u shkëputën Plava e Gucia. Nuk kanë bërë mizori të pashembullta shovinistët serbë kundër shqiptarëve, por e kundërta. Etnografja dhe publicistja e njohur angleze Edith Durham ka shkruar 6 libra me fakte për mizoritë e shovinistëve kundër shqiptarëve. Por A. Pipa e rishkruan historinë pas 80 vjetësh, siç do ta dëshironte famëkeqi Çubriloviç, sepse faktet e historisë dhe vetë E. Durhami të paktën duhen fshirë si të paqena. H. Prishtina, N. Draga dhe D. Hima nuk kanë bërë asgjë si patriotë, ata vetëm e drodhën kur panë se po u rrezikoheshin interesat e tyre.

E megjithatë edhe kjo nuk mjaftoka. A. Pipa nuk ngopet duke i gproposur kështu kosovarët gjatë shekujve, ai u vërsulet më tej kosovarëve të sotëm.

“Ajo që shkruajnë sot kosovarët nuk është “gjuha shqipe letrare e njësuar”, por një gjuhë as toske, as gege, në vend të saj është një mishmash i modeleve kosovare të të folurit, i përzier me klishe të huazuara nga shqipja zyrtare e

gjithashtu nga serbokroatishtja. Duke lexuar gazetat kosovare, ndeshesh me fjali të ndërtuara në mënyrë të rreme aq sa nuk kanë kuptim, kurse shkrimet e tyre diturore janë të ngathëta dhe fjalëshumë, ndërsa poezia e tyre është inferiore kundrejt asaj që është shkruar më parë në kosovarçen.” (f. 255).

Këta rreshta janë një çomangë prapa kokës së gazetarëve kosovarë sot, kur gazetat e tyre i kanë mbyllur serbët e Sllobodan Milosheviçit. Ata janë një çomangë kundër studiuesve kosovarë sot, kur mbyllet Instituti Albanologjik i Prishtinës, konkretisht kundër Rexhep Qoses për të përmendur një emër, sepse A. Pipa nuk zë në gojë asnjë prej kësaj plejade të heronjve intelektualë të shqiptarizmit. Ata janë një çomangë kundër poetëve kosovarë, konkretisht kundër Ali Podrimjes, për të përmendur një emër, sepse A. Pipa nuk zë në gojë asnjë prej kësaj plejade krijuesish, që na ngrohën zemrën me frymëzimin e tyre shqiptar të nivelit artistik e shprehës europian. Nuk i zë në gojë, sepse për të: “Letërsia kosovare është një çorbë e gegërishtes së toskëzuar.” (f. 216). Kështu, pasi u bie në kokë kosovarëve, ai kujdeset edhe për stomakët e neve, 3 milionë e ca shqiptarëve të tjerë, që të shpëtojmë nga kjo çorbë, të cilën duke mos qenë të ndriçuar nga kjo monografi arshishkencore, e paskemi shijuar me etje për letërsi.

Si u arrit që këtë shqipe e pranuan përgjithësisht shqiptarët brenda kufijve të asaj që tashmë është ish Jugosllavia? Edhe për këtë ka menduar A. Pipa.

“Si shpjegohet që kosovarët e kthyen fletën? Kjo ka ndodhur në fund të prillit 1968, atëherë kur revolucioni kulturor shqiptar ishte në kulmin e tij në Shqipëri. Sipas njoftimeve gojore të gjuhëtarëve kosovarë, që morën pjesë në Konferencën konsultative, pranimit i gjuhës zyrtare të Tiranës ishte pasojë e presionit të madh të studentëve...”

Duke qenë puna kështu, na mbetet të shprehim hipotezën se zbatimi nga kosovarët i gjuhës zyrtare të Tiranës ka qenë në një shkallë të gjerë rezultat i propagandës staliniste shqiptare nëpërmjet studentëve, disa prej tyre ishin simpatizantë e disa ndoshta agjentë të regjimit të Tiranës.” (f. 256).

Kur një monografi është e mbushur me llaftari të tilla, ajo ta lehtëson krejt polemikën. Pasi i hodhi shigjetat e arshishkencës kundër historisë dhe karakterit njerëzor të kosovarëve, kundër eposit dhe fesë së tyre, kundër figurave të tyre të ndritura në të kaluarën dhe gazetarëve, shkrimtarëve, arsimtarëve e shkencëtarëve të tyre të sotëm, A. Pipa u ndërsehet studentëve, rinisë kosovare. Jo pa qëllim ai i harron shqiptarët e Maqedonisë e të Malit të Zi, që gjithashtu kanë nënshkruar Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit më 1972. Nga pikëpamja e gjuhësisë së mirëfilltë, ndodhemi përpara një zbulimi të padëgjuar: asnjë gjuhëtar, në asnjë lloj studimi nuk ka shprehur një hipotezë të tillë, sipas së cilës disa studentë mund t'i imponojnë gjuhën një kulture të tërë të një popullsie, madje në pak ditë, me një konferencë. Pas këtij zbulimi, duhet rishikuar edhe gjithë historia e gjuhëve letrare të botës dhe do të themelohej një degë e re: arshigjuhësia.

Konferenca gjuhësore e Prishtinës më 1968 u mbajt nën parimin: “Një komb - një gjuhë”, që e paraqiti në emër të gjithë forcave intelektuale e kulturore të Kosovës profesori Ali Hadri. Rruga dhe ngjarjet historike, që sollën deri në atë konsultë, janë trajtuar në mjaft punime të ne e në Kosovë. Prandaj do të ndalem vetëm në një rrethanë, që e vlen të theksohet këtu dhe që nuk është përmendur në shtypin shkencor. Një ndër stratagjemat e shovinistëve të Beogradit për t'i përçarë kosovarët nga shqiptarët e tjerë ka qenë kjo: të krijohen dy gjuhë të veçanta, pikërisht që të mos thuhet më në të ardhmen: “Një komb - një gjuhë”. Për këtë qëllim madje krijuan edhe dy terma: shqipja e Shqipërisë do të vijonte të quhej “Albanski jezik”, ndërsa shqipja e Kosovës do të quhej “Shiftarski jezik”. Përpara këtij rreziku të drejtpërdrejtë për fatet e tyre historike, kosovarët u mblodhën në Konsultën e tyre gjuhësore më 1968, kur askush ende në Shqipëri nuk kishte menduar për Kongresin e Drejtshkrimit, që do të bëhej 4 vjet më vonë. Ne,

gjuhëtarët shqiptarë, e pranojmë me kënaqësi se përkundrazi, ka qenë presioni i fakteve të Kosovës një nga faktorët që na çoi te Kongresi i Drejtshkrimit. Viti 1968 ka qenë viti i lëvizjes studentore të fuqishme në të gjithë Europën, na mbetet vetëm të presim kur A. Pipa do të formulojë hipotezën tjetër, se ajo ishte nxitur edhe në Francë nga revolucioni kulturor në Shqipëri. Sa për gjuhëtarët kosovarë, ata kanë shkruar gjerësisht për këto probleme pas vitit 1968. A. Pipa nuk i përmend me emër, sepse ata janë kosovarë myslimanë, pasardhës të atyre që kanë bërë mizori kindër serbëve dhe sot bëjnë shkrime diturore të ngathëta e fjalëshumë, apo jo?

Që në rreshtat e parë kam folur për një mendësi të prapambetur. Në gjuhën shqipe sipas normës drejtshkrimore tema fjalëformuese e huazuar “arki-” ka dalë në praktikë edhe me trajta të tjera: *arshiv*, *arshivist*, *arhimandrit*, *argjipeshkëv*. Prandaj *arshishkencë* është njësoj me *arkishkencë*. Na lejohet edhe neve të bëjmë ndonjë neologjizëm të shqipes, kur vetë autori i monografisë ka krijuar neologjizma të anglishtes. A ka mbetur gjë pa iu nënshtuar rishikimit arshishkencor? Posi. Janë një varg figurash të tjera të shquara të kulturës shqiptare. Ndër ta është edhe toska jo vetëm ortodoks, por edhe luftëtari i kishës ortodokse shqiptare të pavarur, Fan S. Noli. Autoriteti i gjuhës së tij është kaq i madh, sa pa e shkatërruar atë, nuk mund të triumfojë A. Pipa. Prandaj ky na merr përkthimin e famshëm nolian të monologut të Hamletit:

*Të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja*

dhe jep përkthimin pipan:

*Me qenë a mos me qenë, kjo asht pikpyetja.*

Nga krahasimi i hollësishëm që u bën të dy varianteve, A. Pipa arrin në përfundimin se varianti i vet është shumë më i bukur, dhe se: “Vargu gëgërisht ka një diapazon zanor më të pasur, meqë përfshin tri hundore, dy “e” dhe një “a”.”(f. 92). E thënë troç: përkthimi im është më i mirë se i Fan Nolit. Madje absolutisht çdo përkthim i A. Pipës do

të jetë më i pasur se çdo përkthim i Fan Nolit, sepse Noli nuk ka zanore hundore, ndërsa përkthimet e një A. Pipe do të kenë gjithmonë zanore hundore. (Unë pres me ëndje se si do ta pasurojë emrin dhe mbiemrin e vet A. Pipa me zanore hundore). Le t'ia lëmë lexuesit ta mendojë vetë me qetësi, se ku të çon një politikë e tillë politikisht e politizuar, që në këtë rast nuk është më mendësi e mbrapambetur, por mendjemadhësi e mbrapshtë. Mjerë kultura shqiptare po ra në këto kurthe.

A ka tjetër? Është edhe Faik Konica, tosku mysliman, të cilin për gjuhën dhe stilin e tij të shkëlqyer Noli e quante “mjeshtri”. Për ta cenosur edhe atë, A. Pipa përmend një letër të F. Konicës të datës 9 dhjetor 1908, dërguar Kristo Qiriazit:

“Kjo letër është tipike për stilin e tij therës, që gjithashtu është një tregues i mendësisë së tij elitariste (e prandaj edhe raciste këtu): ‘Ju shkruani *mbajet, pe*. Këto trajta përdoren në një gjuhë shumë vulgare, sermo proletarius, njerëzit e arsimuar shkruajnë *mbahet, prej*. Ju gjithashtu shkruani *vëjuerë, dëgjonetë, të parëtë*. E kenë gabim, 95 për qind të fjalëve shqipe janë paroksitone... Ju do ta kuptoni se njerëzit që nuk rrojnë në kope delesh thonë: *dëgjonet, të parët etj.*’.” (f. 230). Stili i tij, pra, është stili i një njeriu me mendësi raciste. Askush prej nesh nuk mendohet sot, se cili ngulmoi që të hiqet në drejtshkrim “ë” fundore e këtyre rasteve dhe as me çfarë stili i ka mbrojtur Konica ato trajta, që kanë fituar sot. Ai kishte të drejtë dhe historia e provoi këtë. Por A. Pipës i duhet të sulmojë sot drejtshkrimin normativ dhe për këtë i jep një flakërimë edhe F. Konicës.

A ka tjetër? Është edhe Ismail Kadareja. Fushatës kundër tij A. Pipa i ka rezervuar një vend të veçantë, prandaj nuk po zgjatemi këtu, mjafton të jetë e qartë tabloja e përgjithshme, ku janë përfshirë: toskët ortodoksë, gegët myslimanë, toskët myslimanë, kosovarët, arbëreshët e Italisë, Pirroja i Epirit, Ali Pashë Tepelena, Abdyl Frashëri, Ismail Qemali, Fan Noli, Faik Konica, gjithë studiuesit, gjuhëtarët, shkrimtarët, gazetarët, studentët, këngët epike, toponimet, zakonet, mendësia, fetë, historia.

Nëntëdhjetë vjet më parë Sami Frashëri shkroi manifestin politik për çlirimin dhe bashkimin e shqiptarëve *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*. Kurse ky është **manifesti i përçarjes së shqiptarëve**. Autori e parashikon, e dëshiron dhe na e hedh mbi sofër përçarjen. Për grekët e vjetër molla e sherrit ishte bukuria, për shqiptarët le të bëhet gjuha amëtare molla e sherrit.

Jo të gjithë lexuesit janë të predispozuar dhe të parapërgatitur për t'ë ndjekur më tej këtë diskutim, që detyrimisht do të merret edhe me aspekte të ngushta e teknike të gjuhësisë. Prandaj të përfundojmë së pari me realitetin politik.

Sipas A. Pipës ne kemi bërë një faj të rëndë politik, që kemi pranuar një trajtë gjuhësore letrare. "Shqiptarët kanë qenë të mësuar ta shohin gjuhën e tyre dydialektëshe, po ashtu siç shihnin shqiponjën e zezë dykrenore në flamurin e tyre të kuq. Ka qenë hedhur kjo parullë: Shqipja me dy dialekte, si shqiponja e flamurit dykrenore." (f. 210). Atëherë duhet sa më parë të kthehemi në dy gjuhë letrare: një për Veriun dhe një për Jugun.

Ja se çfarë do të ndodhë praktikisht, kur ne do t'i përulemi me nderim gjenisë arshishkencore dhe do ta zbatojmë atë devotshmërisht në Shqipëri:

*Më 1 shtator do të vijmë në klasën e parë të shkollës "Kosova" në Tiranë nxënësit me tufa lulësh e të shoqëruar nga prindët. Drejtoresha do t'i presë me buzëqeshje dhe me pyetjen: Çfarë je ti, xhan, gegë apo toskë? Përgjigja nuk do të jetë aq e thjeshtë. Ndoshta A. Pipa do të përgatisë një udhëzues për alternativat e mundshme:*

- 1. Prindët janë liberalë dhe vendosin që fëmija vetë të përgjigjet.*
- 2. Kur nuk janë, do të kenë udhëzime sidomos për rastet, kur burri është gegë e gruaja toskë, dhe anasjelltas. Më në fund do të kemi një përgjigje. Pas kësaj, drejtoresha do të thërresë mësueset: je gege, do të marrësh këtë grup; ti tjetra do të marrësh toskët e tosket se je vetë toskë. Urdhëroni librat: kjo abetare është për gegët dhe*

kjo për toskët, e kështu me radhë për gjithë librat e tjerë, edhe artimetika do të jetë edhe gege, edhe toske. Ja edhe regjistrat për gegët e për toskët veçan. Ja edhe dokumentet e tjera, deri te një dëftesë për gegët e një për toskët, të ndryshme nga po ajo shkollë "Kosova".

Në Bankën e Shtetit do të shtypen dy lloje kartëmonedhash: në njërën, për shembull, do të shkruhet "Njiqind lek", në tjetrën "Njëqind lekë". (Me këtë mënyrë do të zgjidhet përfundimisht papunësia në Shqipëri, se gjithçka do të kërkojë fuqi punëtore të dyfishtë). Kuvendi Popullor do të hartojë dy kushtetuta: një gegërisht e një toskërisht. Pas kësaj kështu do të ribëhen të gjitha ligjet, kodet, dekretet, regjistrat, formularët, shkresat zyrtare. Në fund të vitit, kur të vijë ushtarët e rinj në reparte ushtarake, do t'i presin me të njëjtën pyetje: je gegë apo toskë? Urdhëroni oficerët e nënoficerët gegë dhe toskë, edhe rregulloret ushtarake në dy gjuhë. Tabelat e dyqaneve, të institucioneve, të qendrave të prodhimit, do të jenë në dy rreshta. Etiketat e prodhimeve, të patateve, të kastravecave, reklamat, parullat e partive në fushatat elektorale do të jenë dy llojesh. Kështu do të ketë shishe ku shkruhet "Verë" dhe shishe ku shkruhet "Venë". Do të botohen dy gramatika të shqipes, dy fjalorë të shqipes, dy fjalorë anglisht-shqip e shqip-anglisht dhe për të gjitha gjuhët e tjera të huaja. Do të vihen në qarkullim dy farë hartash të vendit, njëra do të quhet "Harta e Shqipërisë", tjetra "Harta e Shqipnis" (apo e Shqypnis, si ta vendosin udhëzimet e A. Pipës). Sipas standardeve të sotme ndërkombëtare, emrat e vendeve në harta shkruhen ashtu siç i ka vendi. Prandaj në "Hartën e Shqypnis" do të shkruhet "Gjirokastër", por në të gjitha botimet e tjera gegërisht do të shkruhet "Gjinokastër". Nuk po e gjej dot se si do të jetë në udhëzimet arshishkencore puna e radios dhe e televizionit. Po besoj, meqë do të shkruhet edhe Republika e Shqipërisë, edhe Republika

e Shqypnis. do të jenë dy palë programe, për të arritur barazinë e për të shpëtuar nga gjuha letrare e njësuar, e cila "është një strategji e shpikur për të përjetësuar hegjemoninë kulturore të një pjese minoritare të kombit mbi pjesën tjetër". (f. 99). Gjuhëtarët kosovarë, miq të Arshi Pipës, do të bëjnë një konsultë tjetër gjuhësore, këtë radhë pa studentët (këtë lehtësi ua ka bërë tashmë Sllobodan Milosheviçi, se i ka përjashtuar nga universiteti dhe ua ka mbyllur shkollat) dhe do të vendosin hedhjen poshtë të Konsultës së vitit 1968, të Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit që kanë nënshkruar më 1972, si edhe ndalimin e gjuhës letrare, sepse: "Imponimi i dialektit toskë mbi gegërishten ishte një reflektim i hegjemonisë politike-ushtarake toske, ngadhënjimtarët shpesh ua kanë imponuar gjuhë e tyre të mundurve". (f. 5). Nuk po zgjatëm më tej, por do të shtoj vetëm kaq. Pres me padurim një lajm nga SHBA, që do të jetë pak a shumë kështu:

Zoti Arshi Pipa u paraqit në zyrat e programit shqip të "Zërit të Amerikës". U hapi monografinë e tij në faqen XII të parathënies dhe u lexoi: "Kjo dëshmi e çuditshme e kolonializmit gjuhësor vendës shpjegohet me faktin se Shqipëria Veriore antikomuniste u pushtua ushtarakisht nga ushtria partizane e udhëhequr kryesisht nga gjeneralë dhe komunistë toskë". Si vazhdoni ju, nga Amerika demokratike, t'u drejtoni shqiptarëve emisione në gjuhën e gjeneralëve dhe të komisarëve komunistë toskë? Dhe lajmi do të përfundojë: që nga kjo datë gjuha e programeve të "Zërit të Amerikës" do të ndryshojë. Por meqë z. Arshi Pipa në faqen 223 ka thënë se "Zgjidhja e drejtë do të ishte të lireshin dy gjuhët letrare të bashkekzistonin paqësisht", ne do t'i japim programet në dy gjuhë. Atë punën e gjeneralëve dhe të komisarëve do ta shpjegojmë më tej në dy gjuhë.

## 2.

Gjuhën letrare të njësuar A. Pipa e shënon gjatë librit me shkurtimin anglisht ULA, ne po përdorim më tej shkurtimin GLN. Tehu kryesor i monografisë në sipërfaqe është drejtuar kundër saj.



Ai ndërmerr një shkatërrim tërësor të historisë, të bazës, të lëndës, të strukturës, të sociologjisë, të teorisë dhe të vlerave të gjuhës shqipe letrare të sotme.

Meqë GLN ka në bazë tipare dialektore të toskërishtes, atëherë duhet të diskreditohet toskërishtja. Ta mohosh fare si pjesë të shqipes, sikur nuk kapërdihet kaq lehtë. Atëherë ka një rrugë me një marifet më të hollë: të zbatohet nocioni i përzierjes. Toskërishtja nuk është e pastër, është e ndotur, dhe kështu do të bëhet e neveritshme për shqiptarët.

“Dallimet dialektore toske mund të jenë rezultat i ndikimit të një gjuhe tjetër mbi protoshqipen. Kjo nga ana e vet mund të nënkuptojë pushtimin nga një popull tjetër të pjesës së Ilirisë jugore, që kufizohet me Epirin dhe Maqedoninë”. (f. 202). Fërkoni duart shovinistë grekë: ju ka dalë aleat një diturak shqiptar. Banorët e Epirit të Veriut qysh në kohë të lashta kanë qenë të përzier, me ç’të drejtë ata sot thonë se janë një komb me shqiptarët mbi lumin Shkumbin? Ndërsa në mesjetë ata u bënë bizantinë dhe sot janë kundër prejardhjes ilire; janë tuajt, merrini.

Gjuhësia arshishkencore jep edhe një argument të mirëfilltë gjuhësor. Ka një dukuri, që quhet rotacizëm, domethënë tingulli “n” ndërmjet dy zanoreve kthehet në “r”. Për shembull, *lumtuni* dhe *lumturi*. Rotacizmin e ka toskërishtja.

“Pse u zhvillua rotacizmi vetëm në Shqipërinë e Jugut? Duhet përjashtuar një zhvillim i brendshëm i gjuhës shqipe, meqë zhvillimi i ndodhi vetëm në një pjesë dhe jo në gjuhë në tërësi. Dhe nëse zhvillimi është një efekt i një shkakut të jashtëm, mendojmë se nuk mund të ketë tjetër veçse një shkak gjeopolitik”. (f. 203). Me rotacizmin janë marrë shumë studiues. Gjuhëtari i shquar danez Holger Pedersen e shpjegon me shqiptimin e labërguar të tingullit “n” në gjuhën shqipe. Ndërkaq, si gjithnjë kur ke të bësh me diletantë, nuk ka nevojë për diskutime të thelluara. Vetëm një diletant mund të çuditet se përse një zhvillim ka ndodhur në një dialekt e jo në gjuhë në tërësi. Po si do të dalloheshin dialektet,

nëse çdo ndryshim do të përfshinte gjuhën në tërësi? Në të folmet e një pjese të gegërishtes qendrore tingulli “i” i theksuar është zbërthyer, pra shqiptohet “paj” në vend të “pi”. Sipas A. Pipës të gjitha këto zhvillime duhen përjashtuar si zhvillime të brendshme të shqipes. Çfarë zbulimesh, çfarë dialektologjie e re! Tani A. Pipa trokon i lirë në gjeopolitikë dhe arrin në rezultate epokëkrijuese për historinë e gjuhës dhe sociolinguistikën:

“Kështu na mbetet përfundimi se rotacizmi si një tipar toskë u ngulit në Shqipërinë e Jugut gjatë Perandorisë së Parë Bullgare. Fakti që vetëm Rumania e Veriut dhe Shqipëria e Jugut kanë rotacizmin të përbashkët, mund të shpjegohet duke pranuar një simbiozë më të hershme, në Dardani dhe në Peoni, të ilirëve dhe trakëve. Këta të fundit pastaj u zhvendosën drejt jugut, duke arritur Shqipërinë e Jugut disa kohë para se ta pushtonin bullgarët. Rotacizmi nuk u përhap në Shqipërinë e Veriut, sepse ajo ndahej prej Shqipërisë së Jugut nga një brez i formuar në një rën anë, nga një zonë e vështirë për të depërtuar, Mati e ndoshta Mirdita, dhe nga ana tjetër, prej Themës së Durrësit”. (f. 203).

Shkenca gjuhësore është përpjekur të vërtetojë në mënyrë bindëse se rotacizmi në gjuhën shqipe ka nisur para ardhjes së sllavëve dhe se ai po pushonte së vepruari në kohën kur erdhën sllavët në Shqipëri. Po këto nuk i interesojnë A. Pipës. Ai është dalldisur që të vërtetojë se toskët nuk janë ilirë, se kanë qenë ndoshta trakë, se kanë ardhur shumë vonë në Shqipërinë e Jugut, madje pikërisht këtu, në Shqipëri, as nuk kishin mundësi të komunikonin me gegët, se i pengonin Mati e Mirdita dhe Thema e Durrësit. Që të dalë e qartë, se çfarë kucurash këput A. Pipa, mjafton të saktësojmë se Thema e Durrësit është krijuar nga fillimi i shekullit IX, ajo shtrihej nga Vjosa e deri në Tivar në Veri. Ajo e përfshinte brenda Shqipërinë e Veriut nga ana perëndimore tërësisht, në zonën më fushore, kurse ky na thotë se ishte një brez ndarës. Dhe ajo që është më kryesorja, *thema*. more zoti Pipa, ishte njësi ushtarake-administrative bizantine, ishte themë bizantine, me atë epitet për të cilin ti i kërdise toskët!

55556

Dhe për ta mbyllur këtë pikë. Gjatë sundimit osman shqipja ka huazuar një numër fjalësh, që në dialektin toskë e kanë ruajtur theksin: *babá, agá, pashá*. Në dialektin gegë theksi është shpërngulur dhe te këto fjalë konkretisht ka sjellë deri edhe ndryshimin e gjinisë gramatikore formale, pra *babai* është bërë *babë-a, agai* është bërë *agë-a* dhe *pashai* është bërë *pashë-a*. Ky ndryshim ka ndodhur vetëm në një pjesë dhe jo në gjuhë në tërësi, dhe atëherë, sipas arshishkencës, duhet të jetë efekt i një shkakut të jashtëm, i një shkakut gjeopolitik, mund të nënkuptojë pushtimin nga një popull tjetër të Shqipërisë së Veriut, ka të bëjë me protoshqipen në Dardani ose në Epir, dhjetë shekuj më këtë a dhjetë shekuj më andej, hajt babë se s'kanë rëndësi këto gjëra. A u trilluan me lehtësi të gjitha këto për toskët e periudhave pa dokumentim historik? Urdhëroni dhe i trilloni tani edhe për gegët në shekujt 16-19, kur ka dokumentim historik. Sidoqoftë, na mbetet neve “të mendojmë se”, “mund të jetë se”, “na mbetet përfundimi se”, “mund të shpjegojmë se”, “na mbetet të shprehim hipotezën se” në Shqipërinë e Veriut kanë zbritur banorë të Marsit dhe të Hënës, që kanë shkaktuar dukuritë inovative të gegërishtes.

Prof. E. Çabej dhe të tjerë kanë treguar se dokumentet më të para të gjuhës shqipe, vetë libri i Gjon Buzukut, janë dëshmi që dallimet e sotme dialektore nuk kanë qenë në këtë shkallë në shekujt e kaluar. Që më 1880 K. Kristoforidhi në një intervistë me lordin anglez E. Fitzmaurice thoshte se dallimet dialektore të shqipes janë tepruar. Kurse A. Pipa shkruan se deri në fund të shek. XIX “Dy dialektet, që deri atëherë nuk kishin lidhje njëri me tjetrin dhe që ishin shkruar në mënyra të ndryshme, me shkronja latine, greke dhe arabe, nisën në këtë periudhë të konvergojnë. Numri i parë i “Albanisë” (1897) së Konicës përmban edhe tekste toske, edhe gege”. (f. 1). Atij i duhet që t'i mbajë pa lidhje dialektet që nga koha e protoshqipes e deri në fund të shek. XIX. Por i vjen për hosh që të diskreditojë edhe përpjekjet e shekullit tonë për afrimin gjuhësor.

Më 1916 u krijua në Shkodër një komision gjuhëtarësh e shkrimtarësh, për lëvrimin e gjuhës e të letërsisë shqipe dhe njihet me emrin “Komisia Letrare Shqipe”. Ajo dha një ndihmesë të çmueshme për ngulitjen e trajtës së shkruar të shqipes dhe vendimet e saj shërbyen për gjithë periudhën e pavarësisë. Por për A. Pipën gjithçka për ngulitjen e varianteve letrare të shqipes është parë me syrin e dy tregtarëve, që bëjnë allishverish, ose të dy palëve kundërshtare, që merren vesh me lëshime të ndërsjella. Prandaj për të: “Komisia Letrare e Shkodrës me shumicën e anëtarëve gegë e ndjeu të detyrueshme t’i bënte këto lëshime të rëndësishme dialektit toskë për hir të afrimit dialektor... Duke i bërë këto lëshime toskërishtes, Komisia Letrare në fakt e shkatërroi parimin fonetik që ishte themelor për projektin e reformës së vet. Me fjalë të tjera, zelli patriotik e prishi rreptësinë shkencore”. (f. 3). Ata që nuk janë gjuhëtarë mund të tulaten përpara “rreptësisë shkencore”, por e vërteta është ndryshe. Nuk ka asnjë mundësi, që drejtshkrimi i shqipes të mbështetet vetëm në parimin fonetik. Edhe për gjuhë të tjera, trajtimi i kësaj ane është mjaft i ndërlikuar. Ky parim do të thotë të shkruhet siç shqiptohet. Këtë mund ta arrijë me përafërsi alfabeti fonetik ndërkombëtar. Por edhe sikur ta marrim atë, cilin shqiptim do të marrim për bazë? Të kujt konkretisht, të cilit fshat, qytet, lagje, krahinë, shtresë të popullsisë? Po sjell vetëm një shembull. Norma kërkon të shkruajmë *gjysmë*, po sa variante ka për të: *gjymës*, *gjymis*, *gjysëm*, *gjys*, *gjimës*, *gjimsë*, *gjismë*, *gjis*, *xhims*. Prandaj është i ndërlikuar ky problem, prandaj kërkon një proces të gjatë, prandaj meritojnë nderim të gjithë ata që kanë dhënë ndihmesën e tyre, e jo t’i shash se kanë bërë lëshime, se kanë shkelur rreptësinë shkencore. Pasi ka fshikur Komisinë Letrare të Shkodrës, A. Pipa e ka pasur të hapur rrugën për të diskredituar gjuhëtarët e sotëm: “Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954 dhe Ortografia e vitit 1956 tashmë i kishin dhënë gegërishtes letrare një goditje vdekjeprurëse dhe varrosja e saj pa ceremoni ishte vetëm një çështje kohe”. (f. 134). Që të dalë e qartë, po shënojmë se autorë të Fjalorit të vitit 1954 kanë qenë K. Cipo, E.

Çabej, M. Domi, A. Krajni. O. Myderizi, ndërsa në redaktimin e fundit të Ortografisë së vitit 1956 punuan A. Xhuvani, E. Çabej, M. Domi dhe A. Kostallari. Këta janë pra, ata që i paskan dhënë gegërishtes letrare goditjen vdekjeprurëse, pas një procesi të nisur nga Komisia Letrare.

Gjuha e gjallë është gjithnjë në lëvizje. Ajo do të ishte rreptësisht e njëjtë në gojën e të gjithëve, vetëm nëse njerëzit do të ktheheshin në robotë të prodhuar vetëm nga një fabrikë. Për një varg arsyesh, sipas shtrirjes gjeografike gjuhët ndahen në dialekte, që janë njëra nga shfaqjet e lëvizjes së gjuhës, të ndryshimit të saj. Nuk është vendi këtu për të shtjelluar dialektologjinë, na mjafton të pohojmë diçka të njohur përgjithësisht. Dallimet ndërmjet dialekteve janë kryesisht në sistemin fonetik, janë të pjesshme në sistemin morfologjik, të pakta në sintaksë dhe një kureshti interesante në fushën e leksikut e të frazeologjisë (sepse nga pikëpamja rreptësisht shkencore, ato lidhen me faktorë jashtëgjuhësorë). Dialektet, nga ana e vet, mund të jenë të copëzuara në të folme gjithashtu me dallime. Nëse përpjesëtimet e këtyre dallimeve i kalojnë ata kufij që u përmendën më lart, atëhere nga dy dialekte mund të përftohen dy gjuhë të ndryshme. Faktorët jashtëgjuhësorë e ndërlikojnë historinë e dialekteve. Një krahinë ose një tjetër arrin një shkallë më të lartë zhvillimi ekonomik, ose politik, ose shoqëror e kulturor. Kjo nuk është meritë e dialektit, por me kohë si në çdo aspekt të jetës njerëzore, dukuritë ndërthuren midis tyre. Gjuhësia ka vërtetuar prerazi, se nuk ka lidhje në përpjesëtim të drejtpërdrejtë midis sistemit fonomorfologjik të gjuhëve e dialekteve dhe shkallës së zhvillimit të një vendi ose krahine. Një popull më i madh, më i zhvilluar, më i pasur, nuk do të thotë aspak se ka edhe një gjuhë me më shumë tinguj, morfema e trajta gramatikore. Të thuash se një dialekt është më i pasur nga ana e sistemit fonetik e gramatikor, duke i dhënë kësaj kuptim të përpiktë shkencor, është një absurditet

i papranueshëm për shkencën. Gjuhëtarët e shquar, po përmend amerikanin Eduard Sepir (Edward Sapir), i kanë kundërshtuar mendime të tilla për gjuhët e dialektet, sepse ato çojnë në nënvleftësimin e gjuhëve dhe të kulturave të popujve të vegjël, të popullsisë indigjene në kontinentet e përvetësuara prej evropianëve, dhe në fund të fundit çojnë ujë në mullirin e racizmit. Mirëpo A. Pipa quan Konicën racist dhe për vete nuk i zgjedh mjetet për të arritur qëllimin: “Sistemi fonomorfologjik i gegërishtes është më i pasur se përgjegjësi i tij toskë”. (f:92).

Fjalët dhe shprehjet e gjuhës pasqyrojnë më nga afër historinë, mendësinë, kulturën, marrëdhëniet sociale, teknologjinë etj. të një populli. Është krejt e natyrshme, që një krahinë me bujqësi të zhvilluar do të ketë edhe më shumë fjalë e shprehje të lidhura me të; ose, eskimezët kanë 40 emërtime për ngjyrat e bardha të dëborës! Përsëri unë nuk do të hyj këtu në leksikologji, sepse është një disiplinë e gjerë, që i ka trajtuar dhe i trajton vazhdimisht këto probleme me argumente shkencore. Po si t’ia bëjmë A. Pipës, i cili ose nuk i di, ose nuk i do ato trajtime dhe shkruan: “Përvoja ime me gjuhën shqipe më ka treguar prej kohësh, se gegërishtja është më e pasur se toskërishtja në leksik dhe frazeologji”. (f. 55). Në shumë faqe ai, pas disa numërimeve krejt të papërgjegjshme, rreket të tregojë se në fjalorët e botuar të shqipes ka dy herë më shumë fjalë të gegërishtes, se të toskërishtes, se përgjithësisht “leksiku i toskërishtes është më i varfër se leksiku i gegërishtes”. (f. 224).

Më vjen me të vërtetë zor që jam i detyruar të argumentoj për të hedhur poshtë teza të tilla, sepse ky lloj argumentimi më përul për të shkruar gjëra, që përndryshe as do të më shkonin ndonjëherë nëpër mend. Po të pranohet rruga ku ka hyrë A. Pipa, do të duhet të vërtetohet se toskët gjatë mijëvjeçarëve paskan pasur më pak sende në jetën e përditshme për t’u vënë emra, kanë qenë më të prapambetur nga ana teknologjike, kanë pasur shumë më pak, dy herë më pak lidhje me botën, kanë qenë dy herë më pak të kulturuar,

dy herë më pak të zgjuar, dy herë më pak të emocionuar e kështu me radhë, dhe prandaj për të gjitha këto na kanë mbetur me dy herë më pak fjalë e frazeologji! Letërsia e pasur shqipe, mbledhja e gjerë e visarit leksikor nga goja e popullit dhe studimet kanë treguar, se përfytyrimet e dikurshme për dialektet e të folmet, për dukuritë dhe fjalët dialektore nuk përputhen me gjendjen reale. Edhe nga kjo pikëpamje, shumë gjykime e paragjykime në këtë monografi e nxjerrin atë të prapambetur. Po marrim vetëm një shembull.

Autori na ka kritikuar, përse nuk kemi në fjalorin e botuar më 1980 mallkimin “gjoftu rrefta!” dhe me atë na mallkon edhe ne, që kemi punuar për fjalorin. Është e vërtetë se mallkimet paraqesin interes shkencor për etnografinë dhe folkloristikën. Por ata që kanë qejf të lëvdohen me pasurinë e mallkimeve në gjuhën shqipe, bëjnë mirë të mos e harrojnë se mallkimi është një mënyrë të menduari e lashtë, e periudhës primitive, kur njerëzit besonin te fuqia magjike e fjalës. Popujt e zhvilluar e kanë lënë mënjanë këtë mendësi në shumicën e rasteve dhe prandaj në gjuhët e tyre ka sot një numër të kufizuar mallkimesh të përdorimit të gjallë. Anglezët e kohës së Shekspirit kishin më tepër mallkime se sot. Është mirë të provohet se populli ynë është i lashtë, por nuk është mirë të ngulmohet që ai ka mbetur te ajo lashtësi, te ai primitivizëm, te ajo prapambetje. Sa për leksikografinë si shkencë, në asnjë punim ose artikull leksikografik në botë nuk është kritikuar ndonjë fjalor, sepse nuk ka përfshirë gjithë mallkimet e një gjuhe.

Akuza e parë kryesore, pra, kundër GLN është, se ajo mbështetet në toskërishten, në një dialekt dy herë më të varfër në çdo pikëpamje. Akuza tjetër është se, për ta kapërcyer këtë varfëri, GLN ka përvetësuar pasuritë e gegërishtes dhe ka dalë një përzierje artificiale e papranueshme.

“Ekipi i GLN, - shkruan A. Pipa, - është si një grup monopoli, që e ka trajtuar dialektin gegë tamam siç bënte një trust europian me vajgurin ose me pasuritë e tjera koloniale”. (f. 94). Që të dalë më e kuptueshme për

lexuesin, po marrim vetë mbicmrin “i kuptueshëm”. Toskërishtja nuk bënte dallim ndërmjet dy kuptimeve të mbicmrave *i kuptuar - i kuptueshëm* me dy fjalë të veçanta, dhe përdorte vetëm fjalën e parë me të dy kuptimet. Në gjuhën e sotme “i kuptueshëm”, që përdorej dikur vetëm nga gegët, përdoret nga të gjithë shqiptarët. Ky veprim na qenka “imperializëm kolonial gjuhësor vendës” (f. 210). Domethënë, t’ia arrish që një fjalë, një shprehje, një trajtë, që e përdorte vetëm një pjesë e popullsisë, sot ta përdorin normalisht gjithë shqiptarët, ky është “imperializëm gjuhësor i brendshëm” (f. 93). Meqë është fjala për vajgurin, qenka imperializëm shtëpiak ta marrësh vajgurin nga pusët e Shqipërisë së Jugut e ta përhapësh në çdo shtëpi shqiptare që gatuan ushqimin me të, ja kjo është logjika arshishkencore. Për të mos u ngatërruar më tej me këtë punë, po e përmbledhim shkurt: gjuha shqipe gjatë historisë së saj ka pasur kontakte me gjuhë të tjera dhe ka përvetësuar mjaft elementë prej tyre, aq sa për pak ka shpëtuar nga latinizimi, por askush nuk e ka quajtur këtë imperializëm iliro-arbëror, por përkundrazi, gjuha e shkruar shqipe gjithashtu ka huazuar e vazhdon të huazojë nga gjuhët e tjera fjalë, shprehje e madje ndërtime sintaksore. Dhe tani na del një njeri, që thotë se gjuha letrare nuk ka të drejtë të bëjë të vetat, të përpusojë e të asimilojë elementët e dialekteve të veta!

Lexuesi ka të drejtë të më qortojë për të metat e gabimet gjuhësore, që më kanë shpëtuar deri këtu në këtë shkrim para syve të tij. Megjithatë dëshiroj ta pyes: A e ndien ai, se në këta rreshta ka një përzierje, një çorbë gjuhësore, një gjuhë artificiale? Sepse pikërisht për këtë gjuhë të këtyre faqeve e të miliona faqeve të tjera të librave të shkollës ose të veprave të I. Kadaresë e kështu me radhë, A. Pipa na shprehet se: “Kjo përzierje i është servirur popullit shqiptar si gjuha letrare kombëtare e njësuar e Shqipërisë. Parimi bazë i saj është ‘Një komb - një gjuhë’. Vetë kjo parullë nënkupton që shqipja ka qenë një gjuhë dygjuhëshe para se grupi i GLN t’i përziehte dy gjuhët në një”. (f. 209). Autori i monografisë e hedh poshtë edhe vetë termin e përdorur te ne:



“çështja më e rëndësishme është nëse mund të quhet me termin ‘gjuhë shqipe letrare e njësuar’ një përzierje e dialekteve, që përfundon me eliminimin e njërit prej dy dialekteve letrare ekzistuese të shqipes”. (f. 29). Kjo është arsyeja, që ai e përdor me përçmim shkurtimin anglisht ULA. Por unë kam qejf të shkruaj këtu pikë për pikë siç arsyeton, përfytyron dhe shkruan A. Pipa disa herë në kryeveprën e tij.

*Edhe mua, duke e lexuar disa herë shkurtimin ULA, sepse nisi të më dukej si USA. Dhe atëherë u binda se kjo nuk ishte e rastit. Me të vërtetë në USA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) ka shumë gjuhë e dialekte, por anglishtja me imperializmin e saj shtëpiak i gëlltit elementët e tyre, i ka bërë shqiptarët të flasin anglisht, madje ka ndikuar edhe në shqipen e tyre; halli është i madh sidomos për gegët, sepse kur ata nuk përvetësojnë dot toskërishten e shqipes pa zanore hundore, merreni me mend se si mund ta mësojnë dot anglishten. E për të gjitha këto A. Pipa është kundër imperializmit të ULA dhe të USA, i quan përzierje artificiale edhe ULA edhe USA, nuk ka pasur nevojë për unifikim as të ULA e as të USA. Dhe atëherë më kapi një ankth për fatin e vetë A. Pipës, por u lehtësova në çastin që m'u kujtua se tashmë nuk vepron më Komisioni për Veprimtari Antiamerikane. Për shembull, në faqet 34-35 të monografisë pikërisht kështu arsyeton A. Pipa, pasi thotë vetë se ka hequr syzet e ka ndezur një duhan.*

Por edhe rrugët e tjera të pasurimit të GLN autori i hedh poshtë si i teket e si i vjen për mbarë. Kështu, në faqen 108: “Risitë masive të GLN janë bërë me një ‘arbitrazh’ administrativ, duke na dhënë një gjuhë artificiale”. Kuptohet, për një mendësi të prapambetur çdo risi është e papranueshme dhe artificiale. Megjithatë, ky monografishkrues ka një parapëlqim të veçantë për llogaritjet me shifra. Kam një përvojë me disa diletantë të ne, që po kështu i përdorin shifrat në gjuhësi dhe, për fat të mirë, në shumicën e rasteve i kam bindur që të mos botonin gjëra të tilla, si për shembull: “Kjo do të thotë se kemi një mesatare prej 2000 fjalësh të krijuara nga gjuha letrare e njësuar, që janë

hedhur në tregun kulturor në çdo vit gjatë 8 vjetëve të jetës së pavarur të GLN". (f. 88). Le të marrim një shembull konkret nga monografia dhe le të më gjykojnë njerëzit, nëse po i hyj në gjynah.

"Pse GLN, - pyet A. Pipa, - formon një neologjizëm nga *bijë* dhe jo nga *bir*? Mos është nisur nga konsiderata fem iniste?... Arsyja është për eufoni. Një fjalë e prejardhur *bir-ri* jep *birri*, pra duke u prishur tiparet fonetike të temës, meqë *r* dhe *rr* janë tinguj të ndryshëm të shqipes. Për të ruajtur *r* të *bir* duhet ndërfitur një *ë* epentetike: *birëri*, në trajtën e shquar *birëria*. Por *birëria* tingëllon si italisht *birreria*, gjermanisht *Bierstube*. Për ta shmangur këtë lidhje me birrën në vijën mashkullore, GLN iu drejtua lidhjes në vijën femërore". (f. 233). Ju lutem lexues, të hapni Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, të botuar më 1980 (më tej do ta citoj shkurt F.1980), në faqen 148 dhe do ta shihni, se aty është fjala *birëri* me 3 kuptime, e ka edhe Fjalori i vitit 1954. A kemi të drejtë të qeshim pak? Kështu mund të bëjë shkencë kushdo, po të ketë pirë një fuçi me birrë gjermane.

Për një varg arsyesh, në kohën tonë shqipja ndeshet me vërshimin e fjalëve të huaja. Ky është një problem tepër i ndërlikuar për ta shtjelluar këtu. Ndërsa A. Pipa është vazhdimisht kontradiktor. Nga njëra anë, ai bën një politikanizëm të skajshëm e të papranueshëm shkencërisht: "Gjuhësia shqiptare nuk i pranon huazimet në leksik nga gjuhët e huaja, po ashtu si qeveria shqiptare nuk i pranon borxhet ndaj vendeve të huaja si Bashkimi Sovjetik dhe Kina". Nga ana tjetër, ai pohon: "Nuk po zgjatemi më për përmbytjen e fondit kombëtar nga vërshimi i ndërkombëtar, po kufizohemi vetëm duke cituar nja dy fjalë ndërkombëtare të deformuara aq, sa nuk njihen dot: *funt* (njësi mase), *dispeçer*, *biznes*". (f. 90). Tani të pyesim: a ka shqiptar, që nuk i njeh fjalët *dispeçer* e *biznes* dhe që nuk ka nevojë të dijë se sa është një *funt*?

I rrëmbyer nga synimi për të kundërvënë toskërishten me gegërishten, me qëllim që të diskreditohet e para bashkë me gjithë toskët, A. Pipa ka bërë një pështjellim të paparë të nocioneve e të termave. Aty nuk merret vesh se çfarë janë dialektet dhe gjuha letrare, nëndialektet dhe variantet letrare mbi bazë dialektore, për cilin është fjala në çdo rast. Po më mirë përsëri le të marrim ndonjë

shembull konkret. Në faqen 9 ai pohon se “ë” kurrë nuk dëgjohet në pozicione fundore në të folurit gegërisht. mungesën e “ë” e quan një tipar themelor dallimi të dy dialekteve. Komisinë letrare e qortoi se ka shkelur rreptësinë shkencore, duke mos iu përmbajtur parimit fonetik. Dhe është pikërisht ai vetë, që aty thotë se gegët e Veriut shkruajnë “dy lopë”, pra me “ë” në fund. Në faqen tjetër jep shembujt e Bogdanit: *anshtë, reentë, banhenë* - të tria me këtë tingull në fund, madje edhe fjalën *përtëri* si fjalë të gegërishtes e ka me dy “ë”. Në dallimet strukturore ndërmjet gegërishtes e toskërishtes fut *i - y*, duke dhënë si shembull *hipim - hypim*. Që të dalë në pah se me çfarë lehtësie janë kapërcyer nyje të tilla komplekse të shqipes lidhur me përcaktimin e normave letrare, po shtojmë këta shembuj për tingujt e mësipërm: ndërsa toskërishtja e ka *hyri*, dhe kjo është trajta normative, në të folmen shkodrane del *hini*, e kundërta me “dallimin strukturor”; anasjelltas, *mbylli* e normës letrare del *mbidhi* në të folmen e Gjirokastrës. Pra, Shkodra dhe Gjirokastra kanë njësoj “i”, me çfarë kataklizme do t’i kapërcejë këto gafa A. Pipa? Po në faqen 9 ai jep si fjalë të gegërishtes *amëlsin*. E ku e gjen ai këtë të drejtë, mbi çfarë bazash, që të thotë se kjo përfaqëson trajtën e gegërishtes? Po të hapim Fjalorin e vitit 1954 ai e ka trajtën e gegërishtes *ambëlsinë*, po të hapim Fjalorin e S. Mannit (1948), të cilin e citon vetë, e ka *ambëlcinë!* Prandaj është e natyrshme pyetja: **për cilën gegërishte flet A. Pipa?**

Në të vërtetë, autori e ka dhënë një përgjigje. Ai shkruan në faqen 255: “Zbatimi i GLN nga kosovarët ka dalë dështim total. Kosovarët duhej të kishin përpunuar dialektin e tyre brenda traditës së pasur të gegërishtes letrare. Ata duhej të ndiqnin shembullin e shkëlqyer të Pjetër Bogdanit, krijuesit të prozës letrare geqe, ashtu siç është Manzoni krijuesi i prozës tregimtare italiane”. Po të njëjtën gjë ripohon një faqe më poshtë: “Gjëja më logjike që duhej të kishin bërë kosovarët, do të ishte të ndiqnin gjurmët e përfaqësuesit të tyre të shquar, aq më tepër meqë dheu i Shkodrës ka nxjerrë një letërsi të klasit të parë, me poetë si Fishta e Mjeda, me tregimtarë si Nikaj e Koliqi dhe

madje me një shkrimtar socialist pionier si Migjeni". Arsyeja jashtëgjuhësore përse propozon këtë zgjidhje libri i tij buron nga gjithçka thamë në pikën e parë. "Vështrimi i mësipërm historik na tregon me forcë, se qendra e gravitetit të kombit shqiptar, që nga koha e Skënderbeut e deri në shpalljen e pavarësisë duhet kërkuar në Shqipërinë e Veriut". (f. 199). Nuk do t'i përsërisim më argumentet që parashtruam, se kjo mënyrë të menduari u mohon shqiptarëve të tjerë atdhedashurinë e ndihmesën për kulturën kombëtare. Por pasi bën këtë ngushtim, autori na rrudh vetëm në një pikë: "Shkodra ka qenë qendra shqiptare e qytetërimit ilir-romak" (f. 198). Shkurt, A. Pipa na kërkon që **gegërishtja e Shkodrës të jetë gjuha letrare shqipe**. Të gjitha paragjykimet e autorit mund t'i kthehen atij në fytyrë me kusurin bashkë, por po shtrojmë vetëm këtë pyetje: nëse gegët nuk mund ta flasin variantin toskë në mënyrë korrekte (f. 228), çfarë garancie ka që shumica e popullsisë do të flasë në mënyrë korrekte një gjuhë mbi bazën e së folmes shkodrane? A e dini se çfarë gjërash fyese nënkuptojnë këto lloj zhbirimesh obsesive? Nuk më bën pena t'i hedh në letër. Por po e thjeshtoj punën. Vargun e famshëm të Hamletit, autori na e përktheu gegërisht:

*Me qenë a mos me qenë, kjo asht pikpyetja.*

Për ne ka vërtet një pikëpyetje: çfarë gegërishteje është kjo? Pse vetë përkthyesi nuk e ka përmirësuar gjuhën sipas asaj të dheut të Shkodrës? Sepse folja do të dilte *keen* dhe pyetja do të dilte *pvetje*. Ne e dimë shprehjen: bëni si them unë, e mos bëni si bëj unë.

Edhe veprat e mirëfillta gjuhësore kanë tërhequr mbi vete gjithë peshën e mërisë së shkencëtar-kordhëtari\* me të njëtin politizim e primitivizim. "Viti 1976, - shkruan ai, - i cili pa botim in e Fjalorit Drejtshkrimor të Kostallarit dhe të Gramatikës së Domit, është gjithashtu viti në të cilin qarkullimi i përgjithshëm tregtar i vendit ra nga 517 milionë dollarë më 1974 në 359 milionë dollarë më 1976, shkëmbimet tregtare me Tregun e Përbashkët European i kapërcyen ato me Kinën. E rënduar nga problemet ekonomike të

shkaktuara prej shkëputjes nga Kina, graduafisht Shqipëria po ecte drejt vetizolimit të plotë. Vizita e Titos vitin tjetër në Pekin praktikisht e çoi drejt fundit aleancën". (f. 113). Le t'i marrim me radhë:

Për "Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe" autori i librit deklaroi: "Unë kam parë dhe kam përdorur shumë fjalorë në gjuhë të ndryshme gjatë jetës sime, por kurrë nuk kam ndeshur ndonjë fjalor *drejtshkrimor*, diçka që më duket se është një tjetër çudi staliniste shqiptare". (f. 114). Që të mos mbetet shteg për hamendjet lidhur me vendet e Europës Lindore, nuk po përmend fjalorët e tyre drejtshkrimorë, por po i drejtohem Gjermanisë Perëndimore. Botimi i njohur gjerman Duden në 10 vëllime ( *Der Duden in 10 Bänden*) nis me librin e parë për drejtshkrimin, një fjalor me rreth 200.000 fjalë (Band I: *Die Rechtschreibung*). Vëllimi i 10-të është shtypur më 1970 (unë këtë botim kam, nuk di a ka të mëvonshëm), pra kishte 18 vjet kohë autori që ta mësonte se një çudi të tillë staliniste e kanë bërë edhe gjermanët perëndimorë të Institutit Bibliografik AG, Mannheim.

Sa për gramatikën e gjuhës shqipe, mbi bazën e saj dhe pjesërisht duke e përkthyer atë është hartuar dhe botuar anglisht një libër i madh nga Universiteti i Standfordit, Kaliforni, SHBA, me titullin "Standard Albanian" (1982, faqe 347). Autorë janë profesori Leonard Newmark, i cili po përgatit tani një fjalor shqip-anglisht, Philip Hubbard, profesor i gjuhësisë në Universitetin e San Diegos, dhe Peter Prifti gjithashtu në Universitetin e Kalifornisë. Lexuesit do të më lejojnë në këtë ribotim të shtoj një shënim. Profesori Peter Prifti kishte përgatitur një recension për librin e A. Pipës që më 1990 me titullin anglisht *A Commentary on Prof. Pipa's Critique of Unified Literary Albanian* për revistën "The South Slav Journal", Londër, vëll. 13, nr. 3-4, vjeshtë-dimër 1990, por që doli nga shtypi me vonesë në vjeshtë 1992. Recensionin është botuar shqip më 1995 me titullin *Gjuha letrare është organizëm i gjallë...* Një punim të P. Priftit e ka futur në bibliografinë e vet A. Pipa, por librin e madh nuk e përmend fare, sepse ekzistenca e

kësaj vepre dhe parathënia e saj i hedhin në erë gjithë pohimet e A. Pipës. Për të plotësuar kureshtjen e lexuesit tonë, po përkthej pak rreshta të parathënies anglisht: “*Që nga Lufta e Dytë Botërore janë bërë mjaft përpjekje në Shqipëri - që kanë gjetur mbështetjen e folësve të shqipes edhe në vendet e tjera - për t’u marrë vesh për një variant të vetëm të gjuhës. që të shërbejë si gjuhë standard e vendit dhe këto përpjekje kanë pasur një sukses të shënuar, nëse gjykojmë nga përpjekjet e folësve të shqipes në Shqipëri dhe jashtë saj për t’i zbatuar normat e caktuara*”. (f. 6). Tërheqim vëmendjen e lexuesve, se për këtë parathënie lënda është marrë pikërisht nga punimi i P. Priftit, që e ka cituar A. Pipa, pra nuk mund të thuhet se nuk e njihete. Kështu, mungesa e përmendjes së librit të madh “Standard Albanian” nuk është e rastit, por e qëllimshme.

Sa për Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, në monografi thuhet se ai: “është rritur duke gëlltitur gegërishten letrare. Kjo dëshmi mund të përshkruhet si imperializëm gjuhësor i brendshëm”. (f. 93). Ne do të flasim më poshtë për këtë vepër, por po e citojmë autorin, që të dalë i plotë kuadri.

Ekspedita shkatërrimtare kundër GLN nuk do të ishte e plotë, pa i djegur bazat teorike të saj. Për këtë po marrim dy anë. E para, A. Pipa e quan këtë revolucion. “Reforma e GLN ka qenë në fakt një revolucion”. (f. 148). Autori i ka caktuar edhe afatet: “Ofensiva vendimtare kundër gegërishtes ndodhi gjatë revolucionit kulturor shqiptar (1966-1969). (f. XIII) dhe: “Periodha në të cilën gegërishtja letrare ‘u mund’ dhe u hodhën themelet e GLN zgjati rreth 5 vjet”. (f. 144). Kemi të bëjmë përsëri me një zbulim arshishkencor, që e ka përmirësuar linguistikën botërore.

E dyta, meqë përmendet një revolucion gjuhësor, doemos të shkon mendja te gjuhëtari sovjetik Nikolla Jakovleviç Marr dhe te polemika e J. V. Stalinit me të rreth tezës nëse ndodhin revolucione në gjuhë apo jo. Ne i kishim harruar këto gjëra, sepse janë vetëm një incident kureshtar për historinë e pasur të gjuhësisë botërore si shkencë. Megjithatë, të japin një kënaqësi të veçantë analizat e

thelluara marksiste që u bën tezave të Marrit e të Stalinit pikërisht A. Pipa, për të vërtetuar se gjuhësia marksiste shqiptare nuk është në rregull nga pikëpamja marksiste! Gjithë ky mundim me seriozitetin më të madh duhej për të arritur në një përfundim të thënë dy herë, në faqen 151: “Ne mund të përfundojmë duke thënë se GLN është një përzierje e teorive kontradiktore marriste dhe staliniste”, ndërsa në faqen 209: “GLN është një përzierje e paparë e dy teorive gjuhësore kontradiktore, një përzierje që është marriste në thelb, por e përgatitur në përputhje me një recetë staliniste”. Edhe ky përfundim është një çudi e paparë për shkencën gjuhësore. Një gjuhë që e flasin dhe e shkruajnë realisht njerëzit e një kombi ose popullsie nuk mund të jetë as një teori, as një përzierje teorish. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka qenë një gjuhëtar, i cili mbledhte gjithë punimet e shkruara nga profanët në këtë fushë. Nuk e di adresën e tij dhe as nëse e vijon më këtë punë, se me gjithë qejf do t’ia dërgoja monografinë e A. Pipës dhe le ta gjykonte ai.

3.

Përtej teorive janë kurdoherë njerëzit. I vetëdijshtëm për këtë, A. Pipa zgjedh me mjeshtëri cili duhet goditur. Emri që del më shpesh në libër e sidomos më shpesh nga të gjithë në titujt e nëntitujt e kapitujve është ai i profesor Androkli Kostallarit. Po ta shikosh nga jashtë, të krijohet përshtypja se kjo monografi është një sulm i ashpër personalisht kundër tij dhe kundër punimeve të tij. Çdo gjë që është negative, sipas Arshi Pipës, lidhet me emrin e A. Kostallarit. Ai na qenka “arkitekti i GLN” (f. 147), ndërsa “Duke mbajtur para sysh rolin udhëheqës të Kostallarit në reformën e GLN, ne mund të themi se ajo ka një vulë kostallariane” (f. 6); për autorin, F. 1980 është fjalori i Kostallarit. Po japim një citat të plotë për të mos u zgjatur: “Gjuhësia shqiptare për një çerek shekulli deri më sot ka qenë sunduar nga Kostallari. Ne mund të flasim për një grup kostallarian, meqë emërtimi shkolla e Kostallarit nuk është i përshtatshëm (nuk njihet që leksikografët të kenë krijuar shkolla)

dhe nxjerrim përfundim in e parë: grupi i Kostallarit si përfaqësues i GLN lidhet me trashëgiminë bizantine të Shqipërisë, duke e quajtur heshturazi gjuhën shqipe me origjinë trake e ndoshta nga Kaukazi, e quan se është gjuhë *satem*, sidoqoftë, në kundërvënje me përkatësinë *centum* të gjuhës, që mbrohet nga një orientim i shumicës, i cili lidhet me trashëgiminë iliro-romake të vendit”. (f. 207).

Para se të hyjmë në thelbin e problemit, le të qërojmë disa shtrembërime thjesht faktike. Duke iu përveshur referatit të A. Kostallarit mbajtur në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, autori thotë se ai: “as nuk e harxhon kot kohën për të përmendur vepra si *Saggio di grammatologia comparata della lingua albanese; Grammatik der Albanesischen Sprache, Laut und Formenlehre; An Albanian Historical Grammar* dhe vepra të tjera të këtij lloji”. (f. 110). Vepra e fundit është e S. Mannit dhe është botuar më 1977. Si mund ta përmendte A. Kostallari më 1972 një vepër që është botuar pesë vjet më vonë, më 1977?!

Duke u tallur me F. 1980 në një ndarje me titull “Shto ujë, shto miell, bëhet buka e madhe”, autori ynë merret kryesisht me dy fjalë e ndër të tjera thotë: “Fjalët e rralla janë miell, megjithatë disa krunde kanë kaluar nëpër sitë. Një shembull është *ith* “prapa” (Kristoforidhi ka *ith me jeje* prapa me jeje). E megjithatë Kostallari e rendit fjalën edhe si emër: “*ith*, -i pjesa e pasme”. A është *ith* një rast tjetër i aferezës si *ickël* nga *vickël*?” (f. 89). Jo, nuk është, sepse studimi i shqipes ka tashmë një traditë të gjatë dhe nuk ka mbetur në atë gjendje, sa Pipa e kushdo tjetër të lozë si të dojë me të. Jo vetëm që *ith* nuk është një aferezë nga *vithe*, por është e kundërta, siç e ka shpjeguar në tërësi këtë çerdhe fjalësh N. Jokli. Prof. E. Çabej për më tepër ka ndërtuar edhe etimologjinë e fjalës *bisht* nga kjo rrënjë: *\*(m)b-ith-sht*. Autori ynë vijon të këmbëngulë, se këto janë krunde, që i ka shtuar A. Kostallari dhe thotë në faqen tjetër: “A guxoj të hamendësoj se *ith* me kuptim in ‘ngrohtësia e nëndheshme’, ose siç e shpjegon Kostallari, ‘ngrohtësia e dheut’, është një fjalë e rreme, e shpikur nga një informues i zgjuar për t’u tallur me një mbledhës fjalësh të trashë, i cili paska rastisur edhe i mërzitshëm?... Informuesi duhet të ketë pasur ndër mend prapanicën, kur e ka shpjeguar *ith* si ‘ngrohtësi nga nëndheu’.” Prof. E. Çabej këtë *ith* të dytë e shpjegon si një rasë shumësi të



singularizuar, të lidhur me *ethe*. (Unë përdora fjalën “prapanicë” gjatë përkthimit të tekstit të A. Pipës, për të mos përdorur atë fjalën tjetër më shqeto, me të cilën e ka shkruar këtë tekst autori ynë). Por kryesorja është se këtë fjalë as e ka gjetur Kostallari dhe as e ka shpjeguar Kostallari. Ajo është në Fjalorin e botuar më 1954, në të cilin Kostallari nuk ka marrë pjesë fare, përkundrazi, e ka kritikuar më pas. Edhe diçka. A. Pipa pohon se A. Kostallari “është gjithashtu autori i ‘Gjuha letrare shqipe për të gjithë’” (f. 5), mirëpo nuk i përmend autorët e vërtetë E. Lafe, M. Totoni dhe N. Cikuli, në punën e të cilëve A. Kostallari ka ndërhyrë, siç bënte zakonisht, sepse ishte drejtor.

Duke e sulmuar në këtë mënyrë A. Kostallarin, në të vërtetë A. Pipa i ka bërë atij shërbimin më të madh. Për disa dhjetëra vjet me radhë A. Kostallari ka përdorur çdo mjet e çdo mënyrë për të ekspozuar veten se ai është krijuesi i gjuhës letrare shqipe, se ai i vetmi mund të shkruante për të, se ai është autori i Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe dhe i çdo vepre themelore për shqipen e sotme. Këtë dëshirë ia plotëson me bujari autori i monografisë.

Para së gjithash, është e nevojshme të bëjmë një saktësim terminologjik. Siç u pa, në librin e L. Njumarkut përdoret termi “gjuha shqipe standard”. A. Kostallari e ka kundërshtuar prerazi këtë: “Nuk është e drejtë që gjuha letrare kombëtare, e cila ka një pasuri e larm i kaq të madhe mjetesh leksikore e frazeologjike, gramatikore e stilistike, një shtrirje kaq të gjerë dhe një dinamizëm të tillë historik, pra ka mundësi të pakufizuara, të quhet ‘gjuhë standarde’, siç kanë filluar ta quajnë atë një varg autorësh, sidomos në këta njëzet-tridhjetë vjetët e fundit”. (Studime filologjike, 1982, nr. 2, f. 27). Megjithatë për gjuhën e njësuar unë do të parapëlqejë termin “gjuhë standard” (shkurtimisht këtu GS). Në vend të arsytimit të ndërlikuar, po sjell vetëm këtë argument. Në “Fjalorin e termave gjuhësorë” të autores së njohur sovjetike O.S. Ahmanova (Moskë, 1966) termi “Unifikim, njësim” jepet anglisht *standardization*, me përcaktimin: “vendosja e një gjuhe model, të

njëjtë si mjet komunikimi letrar, zyrtar, kulturor, të kultit etj.". Meqë e quajmë veten gjuhëtarë, e dimë se *standard* nga anglishtja do të thotë embleme, flamur, kështu që GS do të thotë gjuhë-flamur.

**Gjuha letrare e njësuar ose gjuha standard është një arritje e rëndësishme e kulturës shqiptare.** Atë as e ka konceptuar, as e ka krijuar një njeri. Është e vërtetë që në rrugën e saj kanë ndikuar edhe faktorë politikë, edhe njerëz të veçantë, janë ndeshur prirje e drejtime të ndryshme. Edhe sot, edhe në të ardhmen do të vijojnë të ndikojnë mbi të faktorë të ndryshëm, ashtu si për të gjitha dukuritë dhe institucionet sociale. Por rezultatja është vazhdimisht objektive, është një realitet i gjallë, është një produkt që i sjell shërbime të pazëvendësueshme kombit. Është e vërtetë, nga ana tjetër, se si diktatura moniste në Shqipëri, ashtu edhe përfaqësues të veçantë të saj, janë përpjekur të shfrytëzojnë për interesat e veta këtë fryt të çmueshëm. Por kjo është fatkeqësia që pësojnë djersa, mundi, përpjekjet, frytet e intelektit dhe të shpirtit të popullit nën diktaturë. Njerëz si Arshi Pipa nuk janë në gjendje të bëjnë këtë dallim thelbësor. Dihet se krahasimet kanë cene, megjithatë kjo është njësoj sikur të bombardosh hidrocentralet në Shqipëri, sepse ato u ndërtuan në kohën e diktaturës dhe morën emra të lidhur me ideologët e saj. Ende nuk ka studime të thelluara e të mirëfillta gjuhësore as për historinë e shqipes së shkruar dhe as të GS. Por ato, pa dyshim, do të provojnë shkencërisht se si në këtë rrymë të kulturës shqiptare kanë dhënë ndihmesë forcat më të mira të kombit dhe vepra e tyre nuk mund të flakët tej, duke e lidhur me një emër e duke e mistifikuar. Do të mjaftohem edhe për këtë duke u ndalur në nja dy anë.

Më lart pamë se si A. Pipa e lidhte Fjalorin Drejtshkrimor "të Kostallarit" me vitin 1976 e me ngjarje politike. E vërteta nuk është aspak kështu. Në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit ishte përcaktuar që "brenda vitit 1974 të hartohet 'Fjalori Drejtshkrimor

i gjuhës shqipe’.” Ne që kemi nënshkruar Rezolutën dhe që kemi punuar në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë jemi dëshmitarë, se si kjo punë u zvarrit për faj të A. Kostallarit. Jo vetëm kaq. Po të mos kishim punuar ne për Fjalorin e gjuhës shqipe, as që do të bëhej dot Fjalori Drejtshkrimor. A. Kostallari e mori të gatshme punën që kishim bërë për vëllimet e para të Fjalorit shumëvëllimësh dhe prandaj në pjesën tjetër Fjalori Drejtshkrimor ka disa gafa, sepse ne nuk kishim punuar ende për fjalësin e mëtejshëm dhe kjo pjesë e fjalësit u nxor nga skedueset prej Kartotekës së Leksikut të Shqipes të Sektorit të Leksikologjisë e të Leksikografisë. Këtë e kemi borxh t’ia themi publikut për A. Kostallarin. Por të rrimë shtrembër e të flasim drejt, ia kemi borxh t’ia themi edhe A. Pipës, se janë të gjitha gjepura ato që ai shkruan për Tregun e Përbashkët, për Kinën, për Titon, duke i lidhur me drejtshkrimin dhe me Kostallarin.

Kundër nocionit të standardit A. Kostallari është shprehur edhe në kritikën që i bën librit të Janet L. Byron *Selection among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian* (1976, editor J.A. Fishman). Ai e hedh poshtë gjithë librin në referatin “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, mbajtur në Konferencën shkencore të dhjetorit 1984. Do të përkthej më poshtë nga J. Byron pikërisht citatin sintetizues, që e ka dhënë vetë A. Pipa në monografinë e tij:

*“Toskërishtja ka qenë bërthama fillestare e shqipes standard. Kur udhëheqja toske mori pushtetin, ata e ngritën dialektin e tyre të shkolluar, por të gjitha modelet e shkruara të rëndësishme (në toskërishten letrare) ishin të shumëllojshme (kjo pjesërisht i detyrohej historisë së gjatë të përdorimit të toskërishtes letrare dhe pjesërisht prejardhjes së ndryshme të shkrimtarëve të toskërishtes letrare). Përpunimi i vetëdijshëm i këtij varianti letrar nën socializmin gradualisht i ngriti disa elementë të këtyre modeleve në plan të parë dhe njëkohësisht e transformoi dhe e unifiko*

*dialektin letrar. Si rezultat i lëvrimit, i zgjerimit të funksioneve (veçanërisht politike dhe ideologjike) dhe i ndryshimeve leksikore e gramatikore, bërthama letrare toske fitoi tipare, të cilat tani, pas tre dhjetëvjeçarëve ndryshimi të planifikuar, e bëjnë atë të dallueshme e njëkohësisht vazhdimësi të toskërishtes letrare, që shkruhej në prag të Çlirimit dhe gjatë viteve të para të qeverisë revolucionare". (f. 63).*

Diskutime dhe studime më të thelluara për këtë çështje kaq të rëndësishme ka dhe do të ketë edhe në të ardhmen. Por është e çuditshme se si A. Pipa jep këtë citim, i cili hedh poshtë të gjitha pohimet e tij për GLN si revolucion dhe si proces të pak vjetëve. Mund ta kundërshtosh J. Byron për mjaft gjëra, në shkencë ka edhe mendime të kundërta, por qoftë edhe nga ky paragraf i shkurtër duket mirë se në libër ka një përdorim të përpiktë të nocioneve e të termave e jo një pështjellim arshishkencor.

Përmbledhtazi, kemi përballë tri teza:

*A. Pipa:* GLN është një trillim artificial, i dështuar, një shfaqje e imperializmit kolonialist shtëpiak.

*A. Kostallari:* GLN është një koine sui generis, rezultat i konvergencës, i bashkëveprimit ndër-dialektor, ku elementët e dy dialekteve janë ndërthurur organikisht.

*J. Byron:* GS është rezultat i lëvrimit dhe i ngritjes në një cilësi tjetër të variantit letrar me histori të gjatë të toskërishtes.

Deri këtu u përpoqa të tregoj, se teza e A. Pipës jo vetëm është e gabuar (se njerëz jemi, edhe gabojmë), por është edhe tejet shqetësuese për kulturën kombëtare, e shpallur me një agresivitet të tillë. Tani të themi dy fjalë për tezën e A. Kostallarit. Po flas në numrin shumë, sepse ky ka qenë kurdoherë mendimi i shumicës dërrmuese të gjuhëtarëve shqiptarë.

Për ne ishte fare e qartë se si GS po ngrihej varianti letrar me bazë toskërishten, kjo ishte e qartë edhe për gjithë inteligjencien,

njerëzit e kulturës. të shkencës. të arsimit shqiptar. Por ne e dinim se në fund të fundit, në çdo vend të botës kur ngulitet GS. do të mbeten dialekte e variante letrare ose historike, që nuk do të rivalizojnë dot me GS. Ta zëmë për një çast, se në rolin e GS do të ishte ngritur një variant letrar gegë, a nuk do të ndodhte e njëjta gjë me variantin letrar toskë dhe me ndonjë tjetër? Kultura shqiptare dhe interesat mbarëkombëtare e kërkonin një GS. Këtë nevojë historike e shfrytëzoi udhëheqja moniste e diktaturës në Shqipëri për t'i shtuar vetes një "fitore tjetër të madhe". Dhe ashtu si në çdo fushë tjetër, kjo do të shoqërohej me një propagandë të veçantë. Zëdhënësi i pushtetshëm i kësaj propagande ishte A. Kostallari, i cili me një zell dhe zotësi për t'u admiruar ( e them pa ironi) e përçoi atë në referatet e tij të gjata publicistike. Vetëm në një pikë ka të drejtë A. Pipa, kur thotë: "A. Kostallari... shkruan rregullisht për zhvillimin e gjuhës letrare të njësuar, për të cilën është bërë praktikisht diktator". (f. 33). Për ne ishte e pamundur të botonim qoftë edhe një rresht në kundërshtim me versionin zyrtar. E megjithatë kryesore, e rëndësishme, parësore, vendimtare është që arritëm te GS. Ja, sot ka rënë ajo propagandë e ideologjizuar, kurse e kemi GS si një mjet të domosdoshëm për kulturën moderne shqiptare, që na shërben për të përballuar sfidën me të cilën do të ndeshemi duke u integruar në kulturën europiane.

Pikërisht kundër versionit zyrtar, të përfaqësuar në punimet e A. Kostallarit, drejtohet monografia e A. Pipës. Janë dy kordhëtarë në një mejdan irreal, të denjë për një tablo surrealistë. Janë që të dy njësoj, sepse nisen nga i njëjti paragjykim subjektiv: gjuhën e kulturës së një kombi mund ta bëjë një njeri, me një teori të vetën, pa vepra që të jenë gurë themeli në kulturën e kombit. Injorojnë një popull të tërë me inteligjencien e tij, një kulturë të tërë me një proces historik. Por ja që jemi edhe ne, të tjerët, të papërfillur, që dimë të këndojmë e të shkruajmë. Dhe për të qenë të drejtë, do të themi se

*edhe ata të dy bëjnë pjesë në këtë proces historik objektiv dhe nuk do të mungojmë t'u vëmë në dukje edhe meritat që, pa dyshim, i kanë në atë masë që i kanë.*

Të kalojmë te çështja e Fjalorit. “Më 1978, - shkruan A. Pipa, - Kina e shpalli publikisht prishjen e marrëdhënieve, duke ndërprerë çdo ndihmë ekonomike, teknike dhe ushtarake. Fjalori i GLN i botuar dy vjet më pas, dëshmon trysinë e vetizolimit të vendit në shkallën maksimale të normësimit të GLN, që tani shtrihet edhe mbi aparatit frazeologjik si tërësi. Sa më i madh është izolimi në politikë, aq më e madhe është shtrëngesa në ekonomi. Sa më e madhe është shtrëngesa në ekonomi, aq më i madh është normativiteti në gjuhë përmes toskëzimit maksimal, që do të thotë konformizëm maksimal”. (f. 113).

Historia e hartimit dhe e botimit të F. 1980 është kaq larg nga këto lidhje që vendos A. Pipa me marrëdhëniet shqiptaro-kineze, sa është larg vetë Shqipëria nga Kina. Ne kujtonim se vetëm në Shqipëri leninizëm-stalinizmi i ideologjizonte dhe i vulgarizonte në këtë mënyrë dukuritë shoqërore, por ja që kjo ndodhka edhe gjatë.

Për A. Pipën F. 1980 është vepër e A. Kostallarit. E vërteta është krejt ndryshe. **A. Kostallari ka qenë kundër hartimit të një fjalori me rreth 40.000 fjalë dhe e ka kundërshtuar atë sistem atikisht.** Mjafton të lexohen njoftimet në revistën “Studime filologjike” për ecurinë e fjalorit shumëvëllimësh gjatë një vargu vitesh dhe nuk mbetet asnjë dyshim. Më 8 gusht 1961 A. Kostallari ka botuar në “Zërin e popullit” një artikull: “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe do të ketë 60.000 fjalë*”. Në numrin 1 të vitit 1966, në “Studime filologjike” (SF), thuhet se për herë të parë nisi zgjedhja e glosarit (domethënë më 1965). Kemi punuar unë dhe A. Krajinë e P. Geci, më vonë janë përfshirë punonjës të tjerë. Më 1967 nisi hartimi i fjalëve, kemi punuar unë dhe J. Thomai, më vonë u përfshinë punonjës të tjerë. Në revistën “Ylli”, nr. 6, 1969, përsëri A. Kostallari ka botuar artikullin “*60 mijë fjalë të gjuhës amtare. Mbi fjalorin e ardhshëm të shqipes*”.

Sipas SF, 1971, nr. 2, gjatë vitit 1970 përfundoi hartimi dhe redaktimi i librit të parë me rreth 1000 faqe, më 1971 nisi puna për vëllimin II.

I gjithë opinioni e ndiqte me interes punën dhe ishte i shqetësuar për zvarritjet e saj. Duke e parë konkretisht se për 7 vjet ne nuk kishim dërguar dot për shtyp as një vëllim, në fillim të vitit 1972 unë kam thënë publikisht në një mbledhje të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë se kjo është shfaqje akademizmi dhe se duhet bërë një fjalor tjetër, me rreth 40.000 fjalë. Këto mendime nga kjo mbledhje janë botuar nga S. Çabej në një artikull të datës 14 prill 1972 në “Zërin e popullit”. Për fat të keq, ata që do të ishin më vonë së bashku redaktorë dhe autorë të F. 1980 i kundërshtuan këto mendime dhe përkrahën me këmbëngulje A. Kostallarin. Nuk ka vend këtu për të folur për pasojat personale për mua pas kësaj.

Në SF thuhet së më 1974 nisi puna edhe për vëllimin III, por çuditërisht thuhet edhe se u bë redaktimi përfundimtar i pjesës kryesore të shkronjës A për vëllimin I. Kjo ishte pasojë e tronditjes që solli famëkeqi Plenumi IV. Mjafton të shihet se si u hollua revista SF. Më pas aty del se vëllimi I më 1976 u diskutua në sektor dhe në Këshillin Shkencor, por asgjë nuk vajti në shtyp. U bënë 10 vjet dhe presioni i opinionit të gjerë e bëri efektin e vet. Asgjëkundi dhe asnjëherë nga A. Kostallari dhe përkrahësit e qëndrimit të tij nuk ishte folur për një fjalor me rreth 40.000 fjalë. Befas në SF, 1978, nr.1 lexojmë: “Gjatë vitit 1977 përfundoi hartimi e redaktimi i përgjithshëm i Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe me rreth 40.000 fjalë, duke konkretizuar kështu një punë të madhe shumëvjeçare, sidomos aksionin shkencor të ndërmarrë nga Sektori i leksikologjisë e i leksikografisë gjatë viteve 1976-1977”. Siç shihet, edhe ky njoftim është qepur me pe të bardhë. Për fjalorin shumëvëllimësh për herë të fundit flitet më 1981 dhe thuhet se ka vijuar puna për të. Befas në SF, 1984, nr. 3, lexojmë: “Do të fillojë mbi bazën e

studimeve të veçanta teorike dhe të një përvoje të re puna për hartimin e Fjalorit shpjegues të gjuhës shqipe në disa vëllime”. Ky njoftim vërteton se fjalori i ri shumëvëllimësh i ndërmarrë afër 20 vjet më parë dhe i reklamuar nga A. Kostallari që më 1961, dështoi përfundimisht. Sa për fjalorin “e ri” shumëvëllimësh (1984) mund të bëhet i njëjti parashikim, për deri sa që atëherë kanë kaluar 7 vjet dhe drejtimin e tij e mban ende A. Kostallari. Ai e ka futur sektorin në një aventurë të re me kompjuterizimin e Kartotekës së leksikut të shqipes.

Të gjitha këto fakte dëshmojnë se lidhjet që vendos A. Pipa ndërmjet F. 1980 dhe jetës politike në Shqipëri, janë fantazira. Më 1984 u botua një variant i shkurtuar me një titull të përdredhur “Fjalor i shqipes së sotme”. Në grupin e redaksisë dhe të autorëve mungon emri im, duke shkelur të drejtat elementare të autorit. Por edhe mënyra e paraqitjes së emrave të kryeredaktorit, të redaktorëve dhe të autorëve të F. 1980 është rezultat i një konflikti të ashpër që kemi pasur të gjithë ne me A. Kostallarin. Në librin e A. Pipës përmendet emri im si një gegë ndër tre toskë (në faqen 101), si një pasqyrim i drejtpërdrejtë i përpjesëtimit të toskëve dhe të gegëve në Byronë Politike tre me një. Mirë, po përse emri im nuk figuron në Treguesin e monografisë, që nis me emrin e norvegjezit Ivan Asen dhe përfundon me emrin e gjuhëtarit sovjetik V.M. Zhirmunski? A është ky libër për gjuhësinë shqiptare dhe a nuk ka të drejtë lexuesi të kërkojë më parë emrat e shqiptarëve në Tregues? *Që të dy e kanë fshirë emrin tim* dhe prandaj kam një arsye më tepër të them, se të dy janë njësoj. Nuk është e rastit që gjithashtu A. Pipa dhe A. Kostallari kanë folur kundër I. Kadaresë. Janë të dy njësoj.

Në Parathënien e F. 1980 citohen si parime teorike të tij “Parimet themelore për hartimin e ‘Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe’, botuar nga A. Kostallari në SF, 1968, nr. 2.” Vështrimi i



shkurtër i mësipërm na bind me fakte se ato parime kanë dështuar së bashku me fjalorin shumëvëllimësh. Megjithatë lexuesi le të ketë durim dhe të ndjekë një krahasim të Parimeve me F. 1980, krahasim që provon se nuk mund të bëhej sipas parimeve të A. Kostallarit një fjalor me 40.000 fjalë, kundër të cilit ka qenë A. Kostallari.

Parimet përmbajnë një numër jo të vogël fjalësh, të cilat sipas konceptit teorik duhej të përfshiheshin në fjalor. Këta shembuj ishin modele, në bazë të të cilave do të përfshiheshin dhjetëra mijëra fjalë të tjera. Mirëpo as këto modele vetë nuk kanë hyrë në F. 1980. Po kufizohem vetëm te shkronja B. Parimet kërkojnë që të pasqyroheshin nja 50 fjalë, shumica kompozita, të marra sidomos nga Fjalori i E. Giordanos; asnjë nga këto modele nuk është në Fjalor.

Në Parime thuhet se do të futeshin fjalë nga goja e popullit si: *bullashinë, bambull, buraçë, bligë, birkaçe, bigalac, bakërosje, bushurinë, bunak, bumth, bulok, bull, bllëckë, bllac, bishtak, bërkallë, bavë, batrac, ballje, ballan, barkalaq, bellofë, bagështor, briçkë, barkmullë, barkshembur, bultoj, brendoj, besërisht etj.* dhe asnjë nuk është në F. 1980.

Në Parime thuhet se do të jenë si model fjalë të tilla si: *zeamet, patric, areopag, ilot, akropol, trubadur, minezinger, falangë, to-reador, kastanjetë, kuli, mandarin, artritizëm, piramidon, ballast, ofort, heliogravyrë, pauperizëm, skreperist, gaubic, geishë, perlon, silon etj.*, dhe asnjë nuk është në Fjalor.

Në Parime thuhet se do të përfshihen gjerësisht: *parthinët, kaonët, japigët, trojanët, avarët, asirianët, ostrogotët, azerbaixhanët etj.*, dhe asnjë nga këto fjalë nuk është në Fjalor.

Në Parime thuhet se do të jenë shkurtimet si: NIL, NISH, NBSH, PTT dhe asnjë nuk është.

Në Parime thuhet se do të jenë pjesët e dyta të kompozitave: *-bërës, -ndreqës, -punues, -shitës, -matës, -skop, -fob, -graf, -log etj.*, dhe asnjë nuk është.

Përse nuk i ka F. 1980 këto modele dhe mijëra fjalë si ato? Sepse këto Parime nuk ishin hartuar për këtë Fjalor, por për një tjetër në shumë vëllime. Nga ana tjetër, këta shembuj tregojnë se kur ankohet A. Pipa në monografi për ndonjë fjalë që nuk e gjen në F. 1980, harron se jashtë rreth 40.000 fjalëve është krejt e natyrshme që do të mbeten me mijëra të tjera dhe prandaj kot i bie më qafë A. Kostallarit. Por ka edhe disa arsye të veçanta për çdo model të Parimeve, që mungon në F. 1980. Ja vetëm disa shembuj.

Në Parimet jepen *byqe* dhe *bakac*, që mungojnë në F. 1980. Fjalë të tilla nuk ka në gjuhën shqipe. Ato janë thjesht gabime shkrimi të skedueseve (si gafat e Fjalorit drejtshkrimor). E para është *bype*, ndërsa e dyta është *bakaje*, ato që mbeteshin të papaguara te bakalli. Punonjësit e Sektorit të Leksikologjisë e të Leksikografisë kishin mbledhur një sasi fjalësh nga ekspeditat dhe ishte planifikuar të botoheshin në një vëllim. A. Kostallari i mori ato arbitrarisht dhe i botoi te Parimet, por pa i verifikuar, ashtu siç i kishin bërë skedueset. Një pjesë të skedave as sot nuk i ka kthyer në Kartotekë. Një pjesë të mirë të tyre ne i verifikuam gjatë punës për hartimin e Fjalorit dhe na dolën ose variante krahinore, ose huazime periferike. Por modelet nga Parimet, që nuk janë në F. 1980, me domethënie të veçantë janë fjalët si: *krakoviak*, *gopak*, *bandurë*, *ashug*, *jurtë*. Janë marrë drejtpërdrejt nga materialet ruse, në të cilat u mbështet A. Kostallari për hartimin e Parimeve. Ai ndiqte kriteret e fjalorëve rusë, që për shembull emrat e popujve i japin në shumës. Kështu, në Parimet jepen *letonezë-t*, *lituanezë-t*, kurse në F. 1980 i kemi: *leton*, *-i*, *lituan*, *-i*. Për t'u bindur për këtë mjaftojnë këta shembuj: *finikasit*, *actekët*, *eskimosët*. Duke përkthyer nga rusishtja, A. Kostallari nuk ka vënë re se po shkruante shqip dhe në gjuhën shqipe thuhet *eskimez* e jo *eskimosët* si rusisht.

Në Parime thuhet se do të jepen frazeologji të modeleve si: *vajti në esfelt*, *dy shigjeta pendëzeza*, *si mosozot*, *barku i Shënmërisë etj.*, asnjë prej tyre nuk është në F. 1980, madje as fjala *pendëzi*.

Në Parime ka një kapitull të veçantë për citatet. Në F. 1980 nuk ka asnjë citat, sepse është tjetër tip fjalori.

Në Parime thuhet se “Fjalori për herë të parë në historinë e fjalorëve shpjegues të shqipes do të japë edhe njohuri mbi prejardhjen e fjalëve të shqipes” dhe ka një kapitull për etimologjinë. E ka vënë re edhe A. Pipa se etimologjitë mungojnë në F. 1980.

Në Parime ka modele se si do të jepeshin shënimet stilistike për fjalët, por as edhe vetë këto modele nuk janë trajtuar sipas parimeve. Ja disa shembuj. Thuhet se do të kenë shënimin si krahinore fjalët si: *plitë, qizgë, pepon, lylyver, kaçerr, kap, koras, skllap, i shtërmajtë*, por asnjë nga këto fjalë nuk është në F. 1980. Thuhet se do të kenë shënim si krahinore fjalët si: *spikth, shprohë, mollovitem*, por nuk e kanë. Thuhet se do të kenë shënimin si bisedore: *bëj durim, bëj be etj.*, por nuk e kanë. Thuhet se nuk do të vihen shënime për fjalë si: *kryeplak, tagrambledhës, dhjetar*, por ato i kanë në botim. Quhen të thjeshtligjërimit (term i kalkuar drejtpërdrejt nga rusishtja) përdorime të figurshme të fjalëve si: *ari, luan, dhelpër, qengj etj.*, por asnjë nuk e ka këtë shënim. Fjalët që quhen librore në Parime nuk e kanë këtë shënim në Fjalor në pjesën më të madhe.

Sidomos interesante janë konceptet teorike të Parimeve për shpjegimin e fjalëve. Aty jepen modele të plota për fjalë si *baobab*, që megjithatë janë shpjeguar ndryshe në F. 1980. Jepet si model shpjegimi *manikyriste* dhe *-log*, që nuk dalin fare në F. 1980. Dhe tani le të marrim dy modele tepër të rëndësishme: *marksizëm dhe leninizëm*. Parimet na mësojnë teorikisht se për këto “do të jepen si shpjegime pikërisht citatet nga veprat e klasikëve ose dokumentet”. Kjo nuk është zbatuar asgjëkundi në F. 1980. Përkufizimi që jep A. Kostallari për *marksizëm* si model është përkthim besnik dhe me cilësi të mirë i shpjegimit që ka “Fjalori i gjuhës ruse” në 4 vëllime, gjendet në vëllimin II, f. 313, botuar më 1958 në Moskë.

Si përfundim, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe i vitit 1980 nuk i ka zbatuar parimet teorike të vitit 1968, të përpunuara për një fjalor shumëvëllimësh, as për fjalësin, as për shpjegimet, as për citimet, as për etimologjitë, as për shënimet stilistike. Ato parime ndiqnin përvojën ruse, që hartonte fjalorë shumëvëllimësh. Unë kërkoja të bëhej si në vendet e tjera, ku ishte nisur me fjalorë më të vegjël dhe ishte ecur gradualisht në vepra më të mëdha. I tillë është rasti i fjalorit të njohur amerikan Webster. Edhe brezi më i vjetër i gjuhëtarëve, që kishin punuar me Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954, ishte i po këtij mendimi: të merrej ai si bazë dhe të bëhej një ripunim e plotësim i tij. Për këtë arsye A. Kostallari i mënjanoi ata tërësisht, duke pranuar madje që të përfshiheshin në këtë vepër të rëndësishme edhe forca të pakualifikuara, të cilat ai me vetëdije i pengoi edhe më pas që të rrisnin kualifikimin e tyre. Fjalori i vitit 1980 është rezultat i një pune të përbashkët shumëvjeçare, por edhe e një ndeshjeje të vazhdueshme me A. Kostallarin, ndeshje në të cilën patëm mbështetjen e opinionit të gjerë të njerëzve të kulturës dhe pa këtë as sot nuk do të kishte gjuha shqipe fjalorin e vet. Kjo është e vërteta, që i hedh poshtë emërtimet e A. Pipës për ne si “grupi Kostallarian”.

Nuk mund ta mbyll këtë pikë pa cituar dy pjesë të vogla nga “Parimet”.

“Mbi bazën e njësisë ekonomike, nën udhëheqjen e Partisë, është arritur një njësi e kompaktësi ideologjike e politike-shtetërore jo vetëm e paparë në historinë e Shqipërisë, por e rrallë edhe në historinë e zhvillimit të kombeve të tjera socialiste”.

“Roli i fjalës letrare të shkruar e të folur, si përçuese e teorisë dhe e praktikës sonë revolucionare, është rritur në mënyrë të pakrahasueshme me të kaluarën dhe ka marrë një karakter shoqëror të thelle, të gjerë e luftarak”.

Nuk i sjell këto citate për t’i krahasuar me realitetin në ditët e zhvillimeve të sotme të Shqipërisë, por për t’i krahasuar me citimet e shumta nga monografia e A. Pipës. Janë raste të njëjta dhe

shqetësuesë për kulturën shqiptare me politizimin dhe ideologjizimin e tyre të skajshëm.

4.

Gjatë shtjellimit deri këtu kemi vënë në dukje herë pas here se në monografinë e A. Pipës ka shumë gabime faktike. Sa herë që ai hyn në çështje konkrete gjuhësore, bën gabime. Do të ndalem te disa të tjera, që kanë interes.

Kreu i tretë mban titullin: “Pastrimi i leksikut gegë në GLN”. Nëntitulli i pikës 3 është edhe më i fortë: “Pastrimi i GLN nga gjuha e armikut të klasës: rasti i Fishtës”. Dhe pasi citohet vargu i Fishtës: “Qi na a vra e nuk ban za?”, vijon në faqen 41: “Kostallari nuk e ka përfshirë këtë idiomë, që është tipike geqe. Në të vërtetë jo vetëm idioma *ban za* nuk ekziston në toskërishten, por edhe toskëzimi i saj do të tingëllonte i çuditshëm”. Mirëpo hapeni Fjalorin në faqen 133, rreshti i dytë, kolona e dytë dhe do të lexoni: “*Nuk bën zë* nuk nxjerr asnjë zë, nuk ndihet”. Si i bëhet tani me gjuhën e armikut të klasës që na qenka në fjalor?

Na qorton A. Pipa, pse nuk kemi në F. 1980 fjalë si: *dhesk*, *dumbare*, *debojë*, *grreç*, *mec*. Përgjigja është e thjeshtë. *Dhesk* është trajta me metatezë e *dheks*, një huazim nga greqishtja. *Dumbare* do të thotë dyshe, nga turqishtja *dubara*, që e njohin të gjithë ata që luajnë tavëll tek ne. *Debojë* është gjithashtu një turqizëm, edhe korçarët e brezit të vjetër e njohin të gjithë, sepse ka qenë një vend në Korçë, që e thërrisnin me këtë emër që nga koha e Turqisë. *Grreç* është në F. 1980, vetëm se është *gërreç*. *Mec* gjithashtu është, po jo me këtë trajtë tepër lokale, është *mic*. Nuk e vlen të zgjatemi, sepse janë dhjetëra mijëra fjalë e variante të tilla, që nuk kishin se si të përfshiheshin në një fjalor me vetëm 40 mijë fjalë.

Emri i gjuhës sonë nuk është diçka pa rëndësi. Lidhur me të në monografi kemi këta rreshta: “Meqë emrat e gjuhëve të huaja zakonisht formohen duke i shtuar prapashtesën *-isht* emërtim it kombëtar: *anglisht*, *turqisht*,

*rusisht*, atëherë forma *shqip* pa prapashtesë duket si një përfjesë morfologjike, që thekson karakterin kombëtar unik". (f. 188). E gjitha kjo është e gabuar. Emrat e gjuhëve të huaja ne nuk i formojmë nga emërtimet kombëtare, por nga emrat e vendeve. Kështu, *spanjisht* lidhet me *Spanjë* dhe jo me *spanjoll*. Në një artikull të gjatë (*Formimi i emrave përmbledhës nga tema e shumësit*, SF, 1976, nr. 2) unë e kam trajtuar hollësisht këtë çështje dhe kam argumentuar se emërtimi i gjuhës sonë vjen nga ndajfolja *shqip*, ka vetëm një shekull që kjo ndajfolje është përdorur edhe si mbiemër *gjuha shqipe*, kurse emri i vendit *Shqipëria* është krijuar prej afër tre shekujsh dhe prandaj nuk është ndjekur rregulli si për gjuhët e tjera, që do të kërkonte një trajtë \**shqipërisht*. Ky është shpjegimi, të tjerat nuk kanë të bëjnë me gjuhësinë si shkencë.

Në faqen 90 të monografisë ndeshemi me këtë paragraf: "Nuk i kam numëruar fjalët e përbëra, të cilat vijnë si numër në radhë të dytë pas fjalëve ndërkombëtare. Ja disa shembuj: *felëshues* (nga *fe* dhe *lëshues*), një fjalë e përbërë të cilën, para se të lexoja përcaktimin, e mora për të përbërë nga *felë* dhe *shues* "vrasës", që mungon te fjalori, i cili ka në vend të saj *shuarës*; *ballukemënjane* (9 fjalë të përbëra me *balluke*); *i(e) drejtpërsëdrejtë* (22 fjalë të përbëra me *drejt*); *pesëgarësh* një fjalë, e cila po ta themi butë, mund të ngatërrohet me një fjalë tjetër, që do të përmbahemi ta përmendim..." Le t'i marrim një nga një.

*Felëshues* e kemi të dëshmuar në "Fjaluer i rii i shqypes", i botuar më 1908 nga Shoqëria "Bashkimi", të cilën e drejtonte abati i Mirditës Preng Doçi. A të nxjerrim edhe ne përfundimin, se A. Pipa është tallur me abatët katolikë?

*Ballukemënjane* është fjalë e folklorit, e krijimtarisë popullore. A të themi edhe ne, se autori është kundër krijimtarisë popullore?

*I(e) drejtpërsëdrejtë* nuk është në F. 1980. Çfarë të themi për këtë? Gënjeshtar?

*Pesëgarësh* është një fjalë që e përdor çdo sportist te ne. A. Pipa thotë po përmbahet të përmendë një fjalë të ndyrë. Po përse

thotë përmbahet. kur në faqen 78 e ka shkruar copë? Aty thotë se nuk ekzistoka në shqipen shprehja "më çohet (më ngrihet) mendja". por ekziston shprehja tjetër e ndyrë për ereksionin. Do të shtoj se ne kemi në F. 1980 edhe shprehjen "me mendje të ngritur". A ka shqiptar që nuk e di ose nuk e kupton atë? Qenka A. Pipa. Sa për arsyen përse atij i shkon ndër mend dhe e përmend atë shprehje të ndyrë. na duhet të analizojmë edhe një gabim tjetër të tij.

Kreu i parë i librit të njohur të S. Frojdit "Ligjërata hyrëse për psikanalizën" i kushtohet teorisë së gabimeve. Ajo është mbështetur në konceptin psikologjik të I. Pavllorit për vatrat e ndezura. Thelbi i saj është ky: kur një njeri gabon, ndonëse e di fare mirë se cila do të ishte shprehja e drejtë, këtë e bën nën ndikimin e një faktori turbullues. Gabime të tilla janë shembuj klasikë të psikanalizës. Kështu, një drejtues në Gjermani do të hapte një mbledhje, por ai tha: "Më lejoni ta mbyll këtë mbledhje". Ky gabim do të thotë se në mbledhje kishte diçka, që atij nuk i pëlqente fare, prandaj dëshironte ta mbyllte sa më parë. Kjo është arsyeja e thellë e gabimit, që me terma të tjerë quhet ndikimi i pavetëdijes. Tani le të kthehemi te monografia. Në faqen 210 kemi: "Mënyra se si dialekti gegë është trajtuar nga grupi i GLN mund të përshkruhet me saktësi si imperializëm kolonial gjuhësor vendës (përfundimi i katërt)". Mirëpo në të vërtetë ky është përfundimi i tretë. Si ka shpëtuar ky gabim?

*Psikanaliza frojdiane nuk të fal në këto raste dhe ndërton hipotezën, se cili faktor i pavetëdijes e ka shkaktuar këtë gabim. Gjatë monografisë disa herë autori ka ecur me metodën psikanalitike. Kemi edhe në të drejtë atëherë t'i kthehemi po me atë mënyrë. I gjithë libri i A. Pipës mund të shërbejë si një rast klasik për shqyrtimin frojidian. Ai flet pa pushim për imperializmin e Jugut ndaj Veriut, për kolonizimin e Veriut nga Jugu, për shfrytëzimin e Veriut nga Jugu, për pushtimin e Veriut nga Jugu, për shtypjen e Veriut nga Jugu. Tani, babai i A. Pipës ka qenë nga Jugu dhe nëna nga Veriu. Nuk ka provë më bindëse që problemi i*

pavetëdijes së tij është kompleksi i babait, që quhet ndryshe edhe kompleksi i Edipit. Ndërsa fjalët e ndyra të përmendura pak më lart, sipas metodës psikanalitike, shpjegohen me përpjekjen për kapërcimin e një kompleksi inferioriteti. që, për moshën e A. Pipës lidhen me një problem fiziologjik, me impotencën moshore.

Unë nuk jam pasues i psikanalizës, ndonëse e kam studiuar me interes të gjallë, duke kaluar edhe nëpër Adlerin, Jungun, Fromin, Lakənin etj. E ndiej shumë më të afërt dialektikën brilante të autorëve të sotëm si Jacques Derrida, Jean Baudrillard, Jean-François Lyotard dhe të disa post-strukturalistëve të tjerë. E shoh të drejtë, që të gjitha këto gabime në monografinë e A. Pipës t'i quaj si pasojë jo të faktorëve të pavetëdijes freudiane, por të vetëdijes tejet të politizuar dhe të impotencës shkencore.

## 5.

Në fund të vitit 1990 A. Pipa ka themeluar një revistë me titullin "Albanica". Ndër 16 shkrimet e numrit të parë 6 kanë autor A. Pipën, dy janë recensionet kushtuar librit të A. Pipës dhe një shkrim është i Fehime Pipës. Nga artikulli i A. Pipës "Bogdani dhe gjuha shqipe" po marrim një pohim tepër të fortë dhe të nënvizuar prej vetë autorit me kursiv: "*mund dhe thuhet se stalinizmi shqiptar zu fill me stalinizmin e gjuhës. Kush pranon 'gjuhën e njësuar' duhet ta dijë se pranimi i saj nënkupton pranimin e stalinizmit*". (f. 122). Këtu ka një gabim shtypi: "mund dhe thuhet", duhet të jetë për : "mund të thuhet". Po të lihet mënjanë ky gabim, i gjithë citimi i mësipërm është absolutisht sipas gjuhës së njësuar (vetëm një shenjë diakritike ka shtuar A. Pipa mbi fjalën "zu". Gjithë antistalinizmi na u katandis në një shenjë diakritike). Si e pranoka A. Pipa stalinizmin, kur shkruan vetë? Por kjo fjali në përmbajtjen e saj ka me të vërtetë kërcënime staliniste. Sipas kësaj, edhe toskët duhet të heqin dorë nga gjuha e njësuar, përndryshe do të jenë përjetësisht



stalinistë, edhe çdo gjë e botuar në Shqipëri e jashtë saj këta 30-40 vjetët e fundit duhet të digjet si staliniste, duke përfshirë edhe studimet e prof. E. Çabejt, edhe përkthimet e L. Poradecit, edhe shkrimet e R. Qoses, edhe gazetën “Dielli” në Amerikë e kështu me radhë, deri në ndalimin total të gjuhës së njësuar. Fjala e A. Pipës është tipike për diktaturën totalitare staliniste.

Janë tipike për mendësinë staliniste të gjitha vështrimet për historinë si luftë për pushtet, si luftë për hegjemoni, si luftë klasash, si luftë për sundim gjithnjë vetëm ndërmjet dy forcave, nga të cilat njëra doemos duhet të fitojë dhe të vendosë pushtetin absolut, diktatorial. Edhe për A. Pipën Lufta Nacionalçlirimtare ishte thjesht një luftë civile ndërmjet Jugut e Veriut, luftë në të cilën Jugu fitoi dhe e pushtoi Veriun, kështu u bë i mundur: “Toskëzimi i gegërishtes letrare pas pushtimit toskë të Shqipërisë së Veriut”. (f. 108). Në vend të një diskutimi të gjatë, mund të sillet një fakt i vetëm historik. Tre oficerë ndërlidhës britanikë, B. Mclean, D. Smiley dhe J. Amery, të cilët kanë qenë në Shqipëri gjatë Luftës dhe kanë shkruar për të më pas, në dhjetor 1943 kanë përgatitur në Kajro një raport të gjerë, ndoshta dokumenti më i plotë i kohës për gjendjen në Shqipëri. Që të tre kanë qenë dhe janë antikomunistë. Ky dokument është me aq interes, sa atij i kushton një kapitull më vete Reginald Hibbert në librin “Albania’s National Liberation Struggle. The Bitter Victory”, botuar në vjeshtë 1991 nga Pinter Publishers. Raporti shoqërohej me një hartë, e cila: “Tregon gjithashtu se sa jorealiste ishte pikëpamja thjeshtëzuese, se Jugu ishte i gjithë partizan dhe Veriu i gjithë nacionalist”. (f. 131). Edhe pikëpamjet e A. Pipës janë tejet thjeshtëzuese.

Që në faqen e parë të Parathënies së monografisë mësojmë se “shqipja, ashtu si serbokroatishtja, është një gjuhë dydialektëshe”. Po të përdorim termin epistemologji, në kuptimin e bazës teorike të metodës në një fushë të dijes, atëherë do të pohojmë se nga

pikëpamja epistemologjike libri i A. Pipës mbështetet në modelin jugosllav, në konfliktin ndërmjet kroatëve e serbëve dhe në perspektivën e tij si luftë me armë. Këtë A. Pipa e thotë të formuluar qartë si përfundimi i tetë: “Tendenca separatiste në trajtën e ndarjes gjuhësore nuk kanë ekzistuar asnjëherë në Shqipëri. Por kjo megjithatë nuk e përjashton mundësinë e një reagimi gegë, kur gegët të sensibilizohen për hegjemoninë politike të toskëve nëpërmjet institucionalizimit të hegjemonisë gjuhësore toske. Paralelizmi ndërmjet serbo-kroatishtes dydialektëshe dhe shqipes dydialektëshe na sugjeron që Shqipëria herët a vonë mund të provojë atë, që tashmë ka pësuar Jugosllavia”. (f. 220).

Modeli jugosllav do të thotë përçarje, separatizëm, luftë civile. Që nga fillimi e deri në fund A. Pipa flet për këtë mundësi, ose më mirë, thërret për këtë mundësi, e kërkon të bëhet realitet. Shqiptarët, sipas Parathënies së monografisë, “Mund të ndeshen në një të ardhme jo aq të largët me një problem gjuhësor, i cili rrezikon (meqë zemërimi i shtypur priret të shpërthejë) ta përçajë kombin”. (f. XIV). Në mes të monografisë pohohet: “Hegjemonia gjuhësore e toskëve, që sjell vasalizim in e gegëve, do të ushqejë zemërimin. Në një periudhë të gjatë ajo mund të sjellë në turbullira civile serioze; kombi mund të përçahet sipas ndarjeve krahinore”. (f. 97). Dhe në pjesën e fundit: “Jo vetëm që nuk i mënjanon dallimet krahinore, siç pretendon GLN, por i nxit duke rivendosur një ndarje klasore gjatë kufijve krahinorë. Ajo krijon një problem të madh atje, ku nuk ka pasur. Ajo ngjall fantazmën e separatizmit”. (f. 228). Do të ishte tashmë e lodhshme për lexuesin, që të ndiqte arsyetime të tjera gjuhësore për të kundërshtuar vizionin e A. Pipës për gjuhën letrare, për marrëdhëniet e saj me variantet e tjera dhe me dialektet, për ecurinë e këtyre marrëdhënieve gjatë historisë. Çdo libër për historinë e gjuhëve letrare si gjermanishtja, frëngjishtja, spanjishtja, italishtja etj., do të mjaftonte për t’u bindur se probleme të së njëjtës natyrë kanë pasur edhe ato, deri në gjendjen e sotme, duke na dalë në pah se sa larg së vërtetës historike e shkencore janë rropatjet e A. Pipës.

Përpara se ta përfundojmë, e vlen të shtrojmë një pyetje të drejtpërdrejtë, thjesht njerëzore: Përse e ka bërë këtë A. Pipa? Do të përpiqem të jap një përgjigje gjithashtu me fjali sa më të thjeshta.

A. Pipa është një antikomunist. Synimi i tij, që nisej edhe nga faktorë vetjakë, ishte të gjendej një mjet për të goditur regjimin komunist në Shqipëri, për t'i shtyrë njerëzit të ngrihen kundër tij. Si pykë për këtë ai ka zgjedhur çështjen e gjuhës. Me këtë ka bërë një varg gabimesh të thella e fatale. Tregova se kështu ka krijuar shqetësime të pashembullta për kulturën shqiptare. Por po ta marrim përsëri anën epistemologjike, na del në pah se i gjithë konstruksioni i tij ngrihet mbi një parashikim katastrofik. Sipas tij, regjimi diktatorial në Shqipëri do të vijonte të paktën edhe për një brez, domethënë edhe nja dy dhjetëvjeçarë të shekullit të ardhshëm.

Sipas fjalëve të tij, "Duke u nisur nga hipoteza që nuk mund të përjashtohet, se shteti shqiptar stalinist do të mbahet më këmbë edhe një brezni tjetër, në një shtet ku individit duhet t'i përshtatet diktatit të partisë me qëllim që të ecë përpara e madje që të mbijetojë, ka rrezik që GLN do ta mbushë e ndoshta nivelizojë gjuhën e folur, për kënaqësinë e nomenklaturës staliniste shqiptare, për të cilën toskëzimi i kombit është garancia më e sigurtë e monopolizimit të vazhduar të pushtetit nga ana e tyre. Nuk ka nevojë të jesh profet për të parashikuar, se çfarë do të ndodhë me popullsinë e Shqipërisë që flet gegërisht". (f. 99).

Pikërisht më 1989, kur doli libri i A. Pipës, në Europë u rrëzua muri i Berlinit. Të gjithë jemi dëshmitarë se si sot edhe Shqipëria ka hyrë në rrugën e mundimshme të demokracisë, si rruga reale historike për t'i dhënë fund diktaturës staliniste, për ta renditur Shqipërinë me vendet e tjera të qytetëruara. A. Pipa nuk ka menduar asnjëherë gjatë kohës që punonte për monografinë, se edhe në Shqipëri është e mundshme demokracia, si një luftë e gjithë popullit shqiptar kundër monizmit enverist.

Alternativa e tij ishte një luftë vëllavrasëse, kundër toskëve si minoritet. Kjo mendësi është e prapambetur përballë përmbysjeve që po ndodhin në vendin tonë. Por ajo është e rrezikshme, sepse e

zhvendos në një plan tjetër luftën për demokraci, e ndërlikon atë me momentet e përçarjes. Është tepër e rrezikshme, sepse idetë e tij po i shohim konkretisht të përqafohen nga disa njerëz te ne dhe jashtë vendit. Një alternativë e tillë e dëmton demokracinë, i kundërvihet pajtimit kombëtar, ripropozon frymën enveriste të larjes së hesapeve me armiqtë.

Pas kësaj polemike, që mund të zgjatej shumë më tepër, është e drejtë të shtrohet kërkesa: **si do të ishte zgjidhja pozitive në kushtet e demokracisë e të pluralizmit?** Premisa themelore për ta kuptuar këtë zgjidhje është të pranohet me bindje fakti, se nën turqit ose nën sllavët, nën perandori të huaja ose nën diktatura vendëse, populli shqiptar e ka zhvilluar kulturën kombëtare si mjet për interesat dhe aspiratat e veta thelbësore kombëtare. Gjuha shqipe standard i shërben kësaj kulture dhe nuk ka përse të flaket bashkë me diktaturën. Duhet flakur trajtimi që i bënte asaj diktatura.

Në çdo vend të botës, në rrethanat e një kulture demokratike, gjuha standard nuk e përjashton larminë e pluralizmin. Për shkak se ka një GS në Itali, askush nuk ka vepruar me variantin napolitan si pushtetmbajtës monist. **Ky është modeli më i afërt edhe për shqipen.** Askush nuk ka të drejtë të ndalojë që në të folurën ose në variantin shkodran të shkruhen poezi, të këndohen këngë, të bëhen filma, të jepen shfaqje teatrale. Kjo vlen njësoj si për Shkodrën, edhe për Dibrën, si për Gjirokastrën, edhe për Prishtinën. Ndërkaq GS do të vijojë t'i shërbejë kulturës kombëtare në tërësi. Dialektika e unitetit dhe e diversitetit, e njësisë dhe e ndryshueshmërisë është e pranishme sot në gjithë diskutimin e madh për Europën e Bashkuar. Prej shumë vitesh, duke punuar për stilistikën e shqipes, unë jam përpjekur të vërtetoj se lulëzimi i plotë i një gjuhe mbështetet në dialektikën e normës dhe të variacionit. Lidhur me një perspektivë më të largët historike, kështu nuk i mbyllet dera madje as edhe një ndryshimi, që do të nxirrte në krye një variant

tjetër me bazë më të gjerë popullore. Kështu ka ndodhur me dhimotiqinë greke ndaj katharevusës (kurse krahasimi që bën A. Pipa edhe për këtë është i gabuar shkencërisht), ose me gjuhën letrare të sotme ruse, kundrejt variantit të disa shekujve më parë, të mbështetur në sllavishten e vjetër kishtare.

Demokracia na bën t'i shohim gjërat në një optikë tjetër. Asaj do t'i shërbente shumë heqja dorë nga pozitat dhe pikëpamjet e mëparshme, që provohen të prapambetura ose të gabuara. Kjo vlen edhe për ato që kemi shkruar ne, edhe për ato që ka shkruar A. Pipa. Kultura shqiptare do të shpëtonte nga disa shqetësime të rënda, ajo do të lulëzonte më e shëndetshme, duke iu shtuar forcat që përqafojnë mendësinë demokratike.

Nëntor 1991

*Botuar në revistën "SOT", 1991, nr. 5-6, f. 5-29.*

*Ribotuar me vijim në gazetën "Bujku" të Prishtinës më 4, 6, 7, 8 dhe 9 shkurt 1992.*

*Ribotuar me vijim në revistën "The Voice of Truth", Ridgefield, New Jersey, USA, 1993, vëll. 6, nr. 1, qershor, f. 1-14.*

## VARIACIONI DHE NORMA DREJTSHKRIMORE

Gjuha letrare shqipe është një arritje e shënuar e kulturës shqiptare. Ajo përfaqëson një mjet të pazëvendësueshëm për mishërimin e aspiratave dhe të interesave të kombit, duke përfshirë edhe gjithë shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve të Republikës.

Pas një procesi historik të gjatë e të ndërlikuar, në gjysmën e dytë të shekullit tonë u poqën rrethanat, që shqipja e lëvruar të kthehej në një gjuhë standard të përgjithshme. Kjo përkoi me periudhën kur në vend sundonte një regjim totalitar. Ideologjia moniste sunduese depërtonte në çdo shfaqje të jetës politike, ekonomike e shoqërore, as gjuhësia nuk mund të përbente një përjashtim. Kërkesa e partisë-shtet për të standardizuar gjithçka në përputhje me ideologjinë e saj, ndikonte drejtpërdrejt edhe në politikën gjuhësore. Kështu, duhet të pranojmë se pati një bashkëpërkim të dy prirjeve. Nga njëra anë, ishte zhvillimi i brendshëm i gjuhës letrare. Nga ana tjetër, njësimi i shqipes i përshtatej vijës së përgjithshme ideologjike e kulturore të regjimit në fuqi. Por kjo nuk do të thotë se shqipen standard e ka konceptuar, e ka krijuar dhe e ka imponuar ai regjim. E vërteta është se në rrugën e saj janë ndeshur prirje e drejtime të ndryshme, kanë ndikuar faktorë politikë e shoqërorë, njerëz të veçantë dhe grupime kulturore e krahinore. Edhe sot, edhe në të ardhmen do të vijojnë të ndikojnë mbi të faktorë të ndryshëm, ashtu si për të gjitha dukuritë dhe institucionet sociale. Ndërsa rezultatja është vazhdimisht

objektive, është një realitet i gjallë, një produkt që u shërben kërkesave thelbësore të kombit.

Prandaj e quaj shkencërisht të përligjur, që në diskutimin e sotëm t'i dallojmë mirë dy anë.

1. E para, *politika gjuhësore zyrtare*. Ajo është përfaqësuar më së miri në punimet e të ndjerit profesor A. Kostallari. Ai ka ngulmuar vazhdimisht për njësimin, normëzimin, kodifikimin. Këtë e kërkonte koha, vetëm se nuk u la asnjë hapësirë për pikëpamje të tjera, nuk u dha mundësia për të studiuar proceset e dukuritë, të cilat detyrimisht shoqërojnë kalimin në një nivel të ri për gjithë një kulturë kombëtare. Nuk është për t'u çuditur, që një qëndrim i tillë ka çuar edhe në pohime të skajshme.

Duke folur për bazën shoqërore, prof. A. Kostallari ka shkruar më 1968: "Mbi bazën e njësisë ekonomike, nën udhëheqjen e Paritsë, është arritur një njësi e kompaktësi ideologjike e politiko-shoqërore jo vetëm e paparë në historinë e Shqipërisë, por e rrallë edhe në historinë e zhvillimit të kombeve të tjera socialiste".

(1). Në referatin për Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, ndërmjet të tjerash ai ka pohuar se: "Procesi i thellë i 'qytetarizimit' të fshatit ia ka ndërruar atij fytyrën dhe e ka lidhur *drejtpërdrejt* me jetën e shumanshme të gjithë vendit, duke e bërë edhe atë një qelizë të organizimit të madh shoqëror e kulturor, që përpunon e përhap normën letrare". (2). Dhe së fundi, më 1984 ai arriti në përfundimin se: "*Njësimi e normëzimi* (i ashtuquajtur "standardizim") në një shkallë e në një shtrirje të tillë, që e bën shqipen një nga gjuhët letrare më të njësuara të Europës". (3).

2. E dyta, *gjendja e brendshme e vetë gjuhës*. Siç e kanë treguar më së miri ngjarjet e tre vjetëve të fundit, "njësia e kompaktësi ideologjike e politiko-shoqërore e paparë" ka qenë vetëm një trillim i shumë dëshiruar. Nuk i gjejmë dot ata fshatra, ku përpunohej e përhapej norma letrare. Ndërsa fjalët e mëdha nuk mund ta provojnë dot, se shqipja është një nga gjuhët letrare më të njësuara të Europës!

E vërteta është se shqipja ka po ato probleme, siç i kanë edhe gjuhët e tjera europiane, dhe kjo jo vetëm nuk ia ul vlerat, por shënon

një sukses të sajin që e ka arritur këtë shkallë, në të cilën ka edhe po ato probleme.

Njëzet vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit ne mund të pohojmë, se zgjidhja e pranuar e ka përligjur plotësisht veten. Ndërkaq, kjo nuk na bën t'i mbyllim sytë përballë ndërlikimeve si të rrugës historike, ashtu edhe të gjendjes së sotme. Mirëpo duke i mëshuar këtij aspekti, kohët e fundit është shfaqur një qëndrim, që kapërcen në skajin e kundërt. Ai përfaqësohet në mënyrën më të hapur nga libri "Politika gjuhësore në Shqipërinë Socialiste" (4) i Arshi Pipës. Sipas këtij qëndrimi, jo vetëm që duhet hedhur poshtë gjuha letrare e përbashkët, por edhe duhet kaluar në dy gjuhë letrare, me dy norma të ndryshme. Edhe këtu ndeshemi përsëri me pohime të skajshme, po njësoj të politizuara. Është e vërtetë që diktatura moniste dhe përfaqësues të veçantë të saj u përpoqën ta shfrytëzonin për interesat e veta këtë arritje të çmueshme, por në rrjedhën e kulturës shqiptare, që solli të shqipja standard, kanë dhënë ndihmesë forcat më të mira të kombit dhe vepra e tyre nuk mund të flaket tej, duke e lidhur me një emër a duke e mistifikuar. Pa u zgatur më tej, megjithatë nuk mund të mos vë në dukje se një qëndrim i tillë çon ujë në mullirin e përçarjes kombëtare dhe të konflikteve etnokulturore e shoqërore. (5).

Përballë këtyre dy poleve, monizmit dhe dualizmit, të përfutur njësoj nga pikënisje politike jashtëgjuhësore, mendoj se ka një trajtim tjetër, që u kundërvihet sepse ka një pikënisje kryesisht brendagjuhësore. Duke punuar në fushën e stilistikës së shqipes, jam përpjekur të vërtetoj se *lulëzimi i një gjuhe mbështetet në dialektikën e normës dhe të variacionit*. (6). Njësia e gjuhës sipas një norme standarde është e domosdoshme, që ajo të luajë rolin shoqëror e kulturor në shkallë gjithëkombëtare dhe të sigurojë trashëgiminë e pandërprerë, pa krijuar shkëputje të ndjeshme ndërmjet brezave, shtresave dhe ndarjeve të popullsisë. Variacioni është i pranishëm dhe i nevojshëm për vetë ekzistencën e gjuhës në jetën e gjatë e të



shumanshme të popullit. *Një shoqëri e përparuar ka një shumësi mënyrash përdorimi të gjuhës, të përvijuara historikisht.* Madje as një bashkësi folësish dhe as një njeri i zakonshëm nuk e kufizon repertorin e vet me një mënyrë të vetme gjuhësore, që nuk do t'i lejonte të shprehte me gjallërinë e thellësinë njerëzore gjendjet e qëndrimet, interesat e parapëlqimet, veçantinë e prirjet krijuese. Bashkëpunimi dhe ndeshja e këtyre dy prirjeve, njësisë dhe ndryshueshmërisë, është forcë lëvizëse e zhvillimit dhe e lëvrimit të gjuhës.

Duke iu përmbajtur këtij trajtimi, mund të shihen në një dritë tjetër çështjet që lidhen jo thjesht me drejtshkrimin, por me gjithë aspektet që bart ai si ngulitje e profilit të gjuhës letrare. Me aq sa e lejojnë caqet e një kumtese, do të ndalem në disa pika, që kanë interes edhe për praktikën e përditshme.

1. Norma standard asnjëherë nuk ushtrohet dot automatikisht mbi gjithçka që shkruhet dhe aq më pak mbi të folurit. Deri më sot në letërsinë artistike dhe në publicistikë, për qëllime të ndryshme stilistike janë pranuar fragmente e sidomos dialogë në variante të gjuhës së folur, me trajta krahinore ose të vjetruara. Por sot pyetja shtrohet drejtpërdrejt kështu: A biem ndesh me gjuhën standard, duke botuar poezi, romane, tregime, artikuj si tekst i plotë në një variant të ndryshëm nga gjuha letrare e njësuar?

Përgjigja për mendimin tim do të ishte kjo:

Gjuha standard i shërben gjithë kulturës gjuhësore shqiptare. Ajo nuk ka përse të mënjanohet pa përgjegjësi e pa nevojë në çdo rast, po ashtu siç nuk ishte nevoja të diktohej pa përgjegjësi e pa nevojë në çdo rast. Në çdo vend të botës, në rrethanat e një kulture demokratike, gjuha standard nuk e përjashton larminë e pluralizmin. Modeli më i afërt për ne nga shumë pikëpamje do të ishte italishtja. Deri në Luftën I Botërore italishten standard e zotëronte vetëm 2,5 % e popullsisë, pas viteve 50 ajo u shtri në mbi dy të tretat e popullsisë. Ndërkaq,

askush nuk ka vepruar mbi variantin krahinor napolitan me mjetet e pushtetit dhe të ndalonte këngët, pjesët teatrale, prozën e humorin napolitan me shprehjen e vet gjuhësore karakteristike. Njësoj e padrejtë do të ishte në një mënyrë a në një tjetër të ndalohej që në të folmen ose në variantin shkodran të shkruhen poezi, të këndohen këngë, të bëhen filma, të jepen shfaqje në skenë. Kjo vlen njësoj si për Shkodrën edhe për Dibrën, si për Gjirokastrën edhe për Prishtinën. Auditorin e tij secili e zgjedh vetë, më të gjerë a më të kufizuar. Ndërsa gjuha standard vijon t'i shërbejë auditorit të kulturës kombëtare në tërësi.

Jo vetëm kaq, por edhe ideja për të përpunuar një gegërishte të përbashkët letrare do të ndeshej përsëri po me këtë problematikë. Si e mendojnë përkrahësit e kësaj ideje punën, a do t'i ndalojnë ata pastaj shkodranët që ta bëjnë humorin e tyre dhe t'i këndojnë këngët në variantin e vet; ose tiranasit që ta bëjnë humorin e tyre dhe këngët t'i këndojnë në variantin e vet? Dëshiroj ta parashtoj përgjigjen në mënyrë ballore: *unë jam kundër asaj, që në nivelin kombëtar ta copëtojmë auditorin kombëtar*. Kurse në nivelin individual, të krijimtarisë, të oratorisë, të publicistikës, kushdo le të zgjedhë se me cilin variant do të komunikojë dhe le të shohë se sa do t'i leverdisë.

Do të shtoja nga një këndvështrim tjetër, se edhe në gjithë diskutimin e madh sot për Europën e Bashkuar është e pranishme ndërlidhja e unitetit me diversitetin, e njësisë dhe ndryshueshmërisë. Le ta ndjekim atë përvojë, që tashmë e ka treguar veten.

Së fundi, edhe lidhur me një perspektivë më të largët historike, kështu nuk do t'u mbyllej dera edhe atyre ndryshimeve, që do të çonin drejt një varianti me bazë popullore gjithnjë e më të gjerë. Të mos i paragjykojmë sot zgjidhjet, por të njohim më mirë edhe historinë e gjuhëve të tjera.

2. Norma standard e sotme e ka ndërlikuar punën për ribotimin e trashëgimisë. (7). Nuk është vendi këtu për të rrahur çështjen teorike,

nëse ana formale e veshjes gjuhësore të veprës letrare është pjesë e pandarë nga vlerat e saj artistike, apo është diçka e jashtme, që edhe mund të ndryshohet me lehtësi. Më mirë të kufizohemi me vështrimin e gjendjes reale në praktikë. Në pjesën më të madhe ribotimet janë bërë me ndryshime, ndërsa shkalla e cenimit të tekstit origjinal dhe kriteret luhaten mjaft nga një botim në tjetrin.

Është e dobishme të dallohen tre lloje botimesh:

a. Botimet shkencore ose akademike. Ato duhet t'i përmbahen origjinalit në botimin e parë, në gjallje të autorit, ose dorëshkrimit të tij, kur nuk është botuar nga vetë autori.

b. Botimet shkollore të nivelit universitar do t'i përmbahen po këtij kriteri. Ndërsa për nivelet e tjera të shkollës është e nevojshme që një komisin i posaçëm me gjuhëtarë, letrarë, kritikë e tekstologë të diskutojë e të përcaktojë kriteret, që t'u përshtaten kërkesave shkollore e pedagogjike, por pa i cenuar e deformuar veprat arbitrarisht.

c. Botimet masive këtej e tutje do të jenë fushë e shtëpive botuese të pavarura. U takon atyre të zgjedhin se cilit auditor i drejtohen dhe si e shohin më të përshtatshme të kënaqin kërkesat e tij. Vetëm se lexuesit (sipas së drejtës së autorit) duhet t'i tregojnë se çfarë varianti të tekstit i paraqesin.

Shqetësuese nga kjo pikëpamje është gjendja me botimin e folklorit. Folkloristët në disa raste me zell të tepruar, duke kujtuar se ende jemi në kohën e J. G. Hahnit dhe të Reinholdit, i kanë paraqitur krijimet folklorike me çfarëdo hollësie dialektore. Mirëpo folkloristika nuk është një degë ndihmëse e dialektologjisë. Edhe në vendet e tjera folklori nuk i paraqitet me këtë mënyrë publikut. Madje botimet e zakonshme nuk u përgjigjen dot kërkesave të dialektologjisë, ndërsa edhe po të ishte e mundur, vlen vetëm për një numër tepër të vogël specialistësh. Neve na duhen botime masive të folklorit, që fëmijët tanë t'i lexojnë me lehtësi e me ëndje këngët e përrallat popullore.

Si përfundim, këtu ka vend për një orientim të ri tërësor.

3. Vetë norma standard nuk i përjashton në disa raste variantet. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” të vitit 1980 gjejmë dy trajta: *perduh* dhe *përduf*. Edhe nëse e pranojmë se ky është një gabim, ai atëherë ka rrjedhur nga fakti se vetë gjuhëtarët e specializuar nuk e kanë pasur në vetëdijen e tyre të zgjidhur çështjen, se cili variant duhej pranuar si normë.

Por më me interes janë raste të tjera, ndër të cilat po zgjedh dy shembuj. I pari është parafjala *kundër* dhe përdorimi i saj si pjesë fjalëformuese. Ndonëse norma pranon vetëm trajtën *kundër*, në përdorimin e përditshëm del gjerësisht varianti *kundra*. Drejtshkrimi ka vendosur si normë trajtën *Evropë*. Mirëpo të gjithë shkruajnë *eurokomunizëm*, *Euratom*, *eurosocialistët*, *europoli*, *eurodeputet* edhe njëzet vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit. “Fjalori” i vitit 1980 në mënyrë të hapur u është shmangur rregullave të drejtshkrimit, p.sh., duke shkruar *atëvrasës* në vend të *atvrasës* të Fjalorit drejtshkrimor. A nuk kemi dy variante gjithashtu, kur Fjalori i vitit 1980 ka pranuar edhe *amtar*, edhe *amënor*, *amësor*?

U del për detyrë gjuhëtarëve ta ndjekin këtë dukuri, duke mos e quajtur çdo gjë tashmë të përfunduar dhe jashtë diskutimit.

4. Marrëdhëniet e gjera me jetën politike e kulturore të vendeve të tjera na e rishtrajnë çështjen e drejtshkrimit të emrave të përveçëm.(8). Për një varg arsyes, lexuesit shpesh i duhet edhe trajta e përpiktë e emrit në përdorimin ndërkombëtar. Në praktikën e kohëve të fundit ndeshim disa zgjidhje. Një rrugë e pranueshme do të ishte kjo: kur në tekst përmendet për herë të parë një emër i huaj, të jepet me drejtshkrimin e shqipes dhe në kllapa të vihet trajta origjinale. Do të ishte e pranueshme edhe e anasjellta: kur përdoret për herë të parë emri i huaj në trajtën origjinale, të vihej në kllapa leximi shqip.

Po kështu, në tekstet shqip përmenden emërtimet e gazetave, të organizatave etj. të vendeve të huaja. Ka raste kur tashmë tradita ka

ngulitur trajtën e përkthyer, p.sh. *OKB* për Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Mirëpo kemi edhe raste, kur shkruajmë e lexojmë një shkurtime në gjuhë të huaj, p.sh. *NATO*. Është e qartë se për këto emërtime nuk mund të ketë normë të drejtshkrimit të shqipes. Prandaj vërehet një farë pështjellimi. Kështu, e kemi gjetur emërtimin anglisht të revistave në tri trajta: *xhërnëll*, *xhornël*, *xhornal*. Më duket se kjo është tërësisht e papranueshme. Zgjidhja e drejtë do të ishte: ose të ruhet trajta e origjinalit, ose e gjithë shprehja të përkthehet. P.sh. praktika që shohim, duke shkruar "*Dhi Ikonomist*" është një gjë pa kuptim dhe e shëmtuar për gjuhën shqipe. Ose do ta lëmë anglisht "*The Economist*", ose do ta përkthejmë "*Ekonomisti*". Për të ndihmuar lexuesin e specializuar, në rastin e dytë do të vihej në kllapa trajta e anglishtes. Drejtshkrimi i shqipes nuk ka për detyrë të na mësojë si lexohen gjuhët e botës, aq më keq kur kjo bëhet sipas mendjes së njërit ose të tjetrit. Për gjuhët me alfabet jo latin ka një standard ndërkombëtar transkriptimi me shkronja latine.

5. Duke e quajtur purizmin si një pengesë, të përftuar nga politika e izolimit, të ndjekur nga regjimi i kaluar, në këto vitet e fundit i është hapur dera një vërshimi të papenguar të huazimeve në gjuhën shqipe. Kontaktet e drejtpërdrejta me botën e jashtme dhe ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv po krijojnë një *gjendje cilësisht të re në marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e huaja. Shumë shpejt dygjuhësia do të jetë dukuri e zakonshme për çdo shqiptar*. Unë besoj se ky është një argument plotësues me peshë në diskutimin me atë prirje, e cila kërkon të lëkundë gjuhën letrare kombëtare (shih fillimin e kësaj kumtese). **Ndodhemi përballë problemeve të reja, që na kërkojnë përpjekje të reja dhe mendime të pjekura kundrejt sfidave të panjohura, e jo të trondisim edhe atë që kemi arritur.**

Një nga pasojat e kësaj gjendjeje të re do të jetë shtimi i varianteve. Mjafton të lexojmë literaturën fetare shqip, që është vënë në qarkullim tani, për t'u bindur. Madje edhe qëndrimi kundrejt një pjese të

orientalizmave do të ketë zhvillime të tjera. Shumë nga huazimet e ditëve të fundit i ndeshim me trajta nga më të papriturat. Deri edhe një fjalë e njohur, si *alibi* po përdoret shpesh gabim në publicistikë e deri në parlament (vetë kjo fjalë e fundit sot përdoret alternativisht për Kuvendin Popullor, diçka e pazakonshme më parë). Kriteret që i kemi përpunuar jo gjithnjë na japin përgjigje të gatshme për zgjidhje praktike të menjëhershme. Edhe variacioni, përtej disa kufijve të pranueshëm, kthehet në një lëngatë për kulturën e gjuhës.

Në këto rrethana, e quaj për detyrë të tërheq vëmendjen jo vetëm të gjuhëtarëve e të punonjësve të arsimit dhe të botimeve, por të gjithë atyre që e ndiejnë në shpirt se janë shqiptarë, sepse janë mburjtur me pasurinë, me bukurinë dhe me frymën origjinale të shqipes, që të bëhen të vetëdijshëm se nuk është momenti për ta braktisur kujdesin për gjuhën amëtare, por përkundrazi, na duhet ta shtojmë atë, me një nivel më të lartë shkencor, me ide të reja, me njohjen e pamanipuluar të proceseve reale dhe me një tolerancë demokratike si në diskutimin e çështjeve, ashtu edhe në përpjekjet për ngulitjen e normës, e cila është në thelb një shtrëngesë sociale. Dhe këtu duhet mbyllur, sepse çështja do të rikthehej përsëri te **dialektika e lirisë me shtrëngesën, ose të variacionit me normën.**

## SHËNIMET

1. KOSTALLARI, A., *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, në: "Studime filologjike", 1968, nr. 2, f. 50.
2. KOSTALLARI, A., *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, në: "Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, 20-25 nëntor 1872", vëll. I, Tiranë, 1973, f. 76.
3. KOSTALLARI, A., *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*. në: "Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë", Tiranë, 1988, f. 34.
4. PIPA, A., *The Politics of Language in Socialist Albania*, Columbia University Press, New York, 1989, 283 f.

5. Shih më hollësisht për këtë: XH. LLOSHI, *Kultura shqiptare përpara shqetësimesh të reja*. në: "SOT", 1991, nr. 5-6, f. 5-29.
6. LLOSHI, XH., *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1987, f. 131-134; ribotuar nga "Rilindja", Prishtinë, 1988.
7. LLOSHI, XH., *Ribotimi i trashëgimisë dhe çështje të gjuhësisë*, në: "Drita", 14 maj 1978.
8. LLOSHI, XH., *Një çështje drejtshkrimi*, në: "Drita", 28 qershor 1987.

*Mbajtur si kumtesë në Konferencën shkencore  
"Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare  
sot", Tiranë, 20-21 nëntor 1992  
Botuar në "Gjuha jonë", 1995, nr. 1-4.*

## NËNSTANDARDI I SHQIPES DHE MARRËDHËNIET E TIJ ME SHQIPEN STANDARD

Çfarë është “nënstandardi” i gjuhës shqipe?

Duke përcaktuar një term të tillë, dëshiroj ta bëj të qartë që në fillim, se nuk është fjala thjesht për një tip gjuhe, që nuk përputhet me një trajtë standard. Meqë ai lidhet kryesisht me ato, që mund të quhen shtresa të pashkolluara me themel në shoqërinë shqiptare, dhe nuk është thjesht një aspekt i dialekteve, besoj se është i nevojshëm një qëndrim sociolinguistik për ta kapur kuptimin e tij. Për më tepër, duke mbajtur para sysh ngjarjet e pështjelluara që janë shpalosur në Shqipëri gjatë viteve të fundit, do të mendoja se çfarëdo studimi sociolinguistik nuk mund t’i shmanget cekjes së situatave politike, që po kalon Shqipëria e sotme.

Gjatë 45 vjetëve shqiptarët kanë jetuar nën një regjim totalitar. Ideologjia moniste e tij depërtonte në çdo aspekt të jetës. Nuk mund të përbënte përjashtim fusha e gjuhësisë. Kërkesa e partisë-shtet për të standardizuar gjithçka përcaktonte edhe politikën gjuhësore. Regjimi i vuri vetes si synim që të arrinte njësimin e shqipes dhe ky synim u bë pjesë përbërëse e vijës së përgjithshme ideologjike e kulturore.

Pavarësisht nga qëndrimi ynë miratues ose ironizues, kjo kërkesë e regjimit për standardizimin përkoi me momentin, kur zhvillimet e brendshme të shqipes letrare po arrinin për vete një pikë kthese ose periudhën e kristalizimit. Pas një procesi historik



të gjatë e të ndërlikuar ishin pjekur rrethanat për atë që mund të quhet “shqipja e lëvruar” për t’u bërë një gjuhë standard. Duke u përfutuar nga ky përkim, atë që e quajmë shqipja standard, u bë një realitet.

Shqipja standard është një produkt i rëndësishëm i kulturës shqiptare. Për shumicën ajo përfaqëson një mjet të pazëvendësueshëm për mishërimin e aspiratave dhe të interesave të kombit shqiptar, duke përfshirë edhe gjithë shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve të Republikës.

Kjo hyrje e shkurtër është e nevojshme për të pohuar qartë cila është gjendja dhe që të dallohen mirë dy anë të medaljes.

Në njërën anë kemi politikën zyrtare.

Nga ana tjetër kemi një zhvillim objektiv të brendshëm të vetë gjuhës.

1. Politika zyrtare në fushën e gjuhës përfaqësohet më së miri në punimet e të ndjerit profesor Androkli Kostallari. Ishin fjalët e tij, që ndikonin në mënyrë vendimtare se çfarë mund të botohej për këtë çështje.

Profesor Kostallari ka ngulmuar vazhdimisht për njësimin, normëzimin, kodifikimin. Nuk u la asnjë hapësirë për pikëpamje të tjera, për procese ose rryma të tjera. Nuk është për t’u çuditur, që një qëndrim i tillë ka çuar edhe në mjaft pohime të skajshme.

Për shembull, duke folur për “bazën shoqërore”, prof. A. Kostallari ka shkruar më 1968:

“Mbi bazën e njësisë ekonomike, nën udhëheqjen e Partisë, është arritur një njësi e kompaktësi ideologjike e politiko-shoqërore jo vetëm e paparë në historinë e Shqipërisë, por e rrallë edhe në historinë e zhvillimit të kombeve socialiste”. (1).

Në referatin për Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, ndërmjet të tjerash ai ka pohuar se:

“Procesi i thellë i ‘qytetarizimit’ të fshatit ia ka ndërruar atij fytyrën dhe e ka lidhur drejtpërdrejt me jetën e shumanshme të gjithë vendit, duke e bërë

edhe atë një qelizë të organizmit të madh shoqëror e kulturor, që përpunon e përhap normën letrare”. (2).

Dhe së fundi, më 1984 ai arriti në përfundimin se:

“*Njësimi e normëzimi* (i ashtuquajtur “standardizim”) në një shkallë e në një shtrirje të tillë, që e bën shqipen një nga gjuhët letrare më të njësuara të Evropës”. (3).

Këto deklarata me të vërtetë militante kanë pasur një efekt dëmtes të fortë mbi variantet nënstandard të shqipes. Mjaft elementë që i përkasin nënstandardit u ndaluan të përdreshin në rrethanat e komunikimit publik, jo vetëm në gjuhën e zyrave, në arsim dhe në mjetet e komunikimit masiv, por edhe në letërsi, kinema etj. Natyrisht, asnjë studiues ose student nuk nxitej për të bërë hulumtime në një fushë të tillë.

Është e qartë, se marrëdhëniet midis shqipes standard dhe nënstandard u deformuan.

Përse ndodhi kështu? Një studim sociolinguistik i paanshëm i shqipes nënstandard do të tregonte se *ekzistonin* shtresa të ndryshme në shoqërinë tonë, me nivele shumë të ndryshme të arsimit dhe të kulturës. Madje, do të thosha, edhe pjesë, ku strehoheshin prirje opozitare kundrejt ideologjisë sunduese dhe sistemit shoqëror. Do të sjell vetëm një shembull të vogël. Sipas direktivave shtetërore, të gjithë fshatarët duhej të punonin në kooperativat bujqësore. Termi që përdorej për të shprehur vlerën e punës ishte “ditë-puna”. Por në Shqipërinë Jug-Lindore unë kam gjetur për të fjalën “argat”, që ruante kuptimin e dikurshëm të njeriut të marrë në punë me mëditje të një çifligar a pronar. Ajo ka edhe një konotacion si fshatar i marrë në punë të detyruar.

Rrjedhimisht, do të dilte se ditë-puna në kooperativë për një fshatar nga juglindja ishte punë për një pronar të huaj ose punë e detyruar. Kooperativa nuk shihej si “e tyrja” dhe as si pronë kolektive.

2. Duke vështruar zhvillimin e brendshëm objektiv të vetë gjuhës, na del se gjendja ishte mjaft e ndryshme.

Siç e kanë treguar më së miri ngjarjet e dy vjetëve të fundit. “njësia e kompaktësia ideologjike e politiko-shoqërore e paparë” ka qenë vetëm një trillim i shumëdëshiruar. Nuk i gjejmë dot ato fshatra, ku përpunohej e përhapej norma letrare. Ndërsa fjalët e mëdha nuk mund ta provojnë dot se shqipja është një nga gjuhët letrare më të njësuar të Europës.

Po t’i lëmë mënjanë deformimet e dukshme, që i përmenda më sipër në marrëdhëniet ndërmjet shqipes standard dhe nënstandard, lidhjet e tyre kanë qenë si ato që i ndeshim në vendet e tjera kudo në botë.

Unë jam përpjekur ta trajtoj këtë çështje, duke u nisur nga vështrimi i marrëdhënieve ndërmjet normës dhe variacionit ose unitetit dhe diversitetit. (4). Nëse do ta pranojmë stilin si një përmasë të variacionit gjuhësor (5), do ta përfshijmë nënstandardin në skemën e përgjithshme të tipave të ligjërimit si variante stilistike. (6).

Ekzistencën e nënstandardit e përcaktojnë dy grupe faktorësh sociolinguistikë.

I. Grupe të ndryshme folësisë, për arsye të ndryshme nuk arrijnë të përvetësojnë një nivel të caktuar arsimit dhe kulture, prandaj në ligjërimitin e tyre nuk orientohen drejt normës letrare. Një shembull tipik për grupe të tilla na e japin mjediset e qendrave të reja të banimit (si ato të ngritura për minierat, industrinë dhe bujqësinë), të cilat janë me një përzierje të ndjeshme të popullsisë.

Dialektet në qendra të tilla ndeshen midis tyre dhe shumë shpejt del se nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat e jetës qytetare të sotme. Nga ana tjetër, këto grupe, ashtu si e gjithë popullsia, i nënshtrohen trysnisë së normës letrare. Krijohet një brez i gjerë fermentimi gjuhësor.

II. Ka një prirje për t’iu shmangur shtrëngesave të standardit edhe në grupe të tjera ose individë të ndryshëm. Përgjithësisht, si prirje, kjo del me përdorimin e shprehjeve të rënda dhe nën nivelin

e mirësjelljes. si dhe me një shkallë të tepruar intimiteti apo agresiviteti në marrëdhëniet. Në thelb një shkëputje e tillë e grupit është një shfaqje e dëshirës për intimitet të theksuar brenda grupit. Synimi për të bërë përshtypje të fortë dhe për ta mbajtur të gjallë vëmendjen e të tjerëve sjell një kapërcim të vetëdijshëm të standardit.

Tipari kryesor i nënstandardit të shqipes është mungesa e normës letrare si sistem: kjo është një përzierje e trajtave të ndryshme letrare e krahinore dhe e shoqëruar me përdorimin si të fjalëve të vjetruara, ashtu edhe të sapokrijuara. Ky është një tip ligjërimi i paqëndrueshëm dhe me ndryshime relativisht të shpejta. Të gjitha karakteristikat dalluese të ligjëritimit bisedor dalin këtu me shfaqje të skajshme.

Nga ana fonetike shumë fjalë shtrembërohen ose gjymtohen. Mund të provohet fare mirë kjo me shembullin e disave prej huazimeve të kohëve të fundit nga gjuhët e tjera.

Për anglishten “cowboy” ne kemi në shqipen e sotme *kaubois*, një përdorim i shumësit për njëjësin. E njëjta gjë ndodh me fjalën *tank*, e cila ndonëse gjendet me këtë trajtë në shqipen standard, na del *tanks* në nënstandard, e po kështu *fans*, *skorpions* etj.

Shprehja italiane “alla rinfusa” është shndërruar në *rifuxho*, që është një fjalë e njohur prej kohësh në shqipen, por me kuptimin e një vendi strehimi. Fjala gjermane “plexiglass” është shtrembëruar në dy mënyra: *peciglas*, *peçiglas*. Unë kam mjaft dyshim nëse dikush te ne mund të thotë me bindje se cila është forma e drejtë e kësaj fjale! Ka edhe shumë e shumë shembuj të tjerë, që mund të sillja si vërtetim.

Ndërmjet formave të cinguara do të përmendja *nar* për *katundar*, që do të thotë fshatar, por me konotacion keqësues. E të njëjtit tip ka qenë *ot* për *otoman*, e cila përdorej nga katolikët në qytetin e Shkodrës në fillim të këtij shekulli për të thirrur turqit osmanë me përbuzje.

Në fushën e morfologjisë vërehet një përzierje e çuditshme e trajtave të ndryshme dhe e risive nga ndërthurja e trajtave dialektore, shfrytëzimi i parregullt i analogjisë dhe keqkuptimet e hiperkorrektesës.

Një shembull tipik të qartë na e jep ndajfolja *ashtu*. Ajo mund të përdoret si emër: *Më jep dy ashtu*.

si mbiemër: *Sa ashtu që bëhesh!*

si folje: *Ma ashtu pak fustanin*.

Një konversion i tillë është i papërfytyrueshëm në shqipen standard. Madje nga kjo ndajfolje ka edhe një folje të formësuar: *ashtus*, duke shkelur gjithë rregullat e normës.

Fjalëformimi është i rastit, i paqëndrueshëm dhe shpesh përftohet nga keqpërdorimi i modeleve të standardit, p.sh. *barkollogji, çorbos, qymyrepsem, numraxhi, bioqyl*. Do të ishte e pamundur të gjendeshin përkthime adekuate të tyre në gjuhë të tjera. Asnjë prej fjalëve të përmendura më sipër nuk ndeshen në asnjë fjalor të botuar të shqipes.

Porse shmangiet më të rëndësishme nga shqipja standard ndeshen në sintaksë, leksik dhe semantikë.

Në ndërtimin tërësor të teksteve të këtij ligjërimi vërehet ndikimi i plotë i dialogut. Njeriu i pashkolluar, ose një folës nën një përshtypje të fortë emocionale, e shndërron rrëfimin në dialog. Teksti formësohet në ligjëratë të drejtë, me mungesë të plotë të ligjëratës së zhdrejtë, të formave të përbëra foljore dhe të fjalive të varura të nënrenditura. Përgjithësisht fjalitë shkurtohen dhe komunikimi zhvillohet me mjete të artikulluara të kufizuara, ndërsa shoqërohet gjerësisht me elementë parajuhësorë.

Togfjalëshat ndërtohen shpesh duke shkelur sintaksën standard ose rregullat e semantikës. Për shembull: *Sa çudi që bëhesh! Bëj tifo. Qiraja e dritave*.

Pjesa më e madhe e orientalizmave të vjetruar sot ka zbritur në shqipen nënstandard. Ja pak shembuj: *allahile, allahversën, jahu, jarebi, kasaballi*.

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit ka ndodhur një dukuri mjaft interesante. Meqë mjaft "realia" të jetesës orientale dhe elementë të asaj që mund të quhet psikologji orientale pak nga pak janë zhdukur nga jeta e përditshme, brezi më i ri ka bërë një ri-interpretim të disa fjalëve (si: *garip, abdes*), duke u dhënë kuptime të tjera të reja e mjaft të rastit (e para nga shembujt për një njeri që shquhet, i zoti, e dyta për freskimin).

Më lart përmenda fjalët e gjymtuara dhe formimet e prejardhura e të paqëndrueshme. Përdoren mjaft dendur pjesëzat e pasthirrat, madje fjalë dhe togfjalësha të tërë shndërrohen në pasthirra. P.sh. *Bota! I madh! Person! Hallall!* Fjalë, si këto që përmenda si shembull, përdoren dendur për një periudhë kohe dhe për një rreth të gjerë situatash, duke aktualizuar në radhë të parë konotacionet e tyre emocionale, por njëkohësisht zbrazen nga kuptimi i drejtpërdrejtë. Për ta konkretizuar këtë do të sillja fjalën *dreq*, në modelet e përdorimit *ky dreq x*, ku *x* do të thotë çfarëdo objekt që meriton të shahet për diçka që del gabim ose të padëshirueshme.

Fjalët e nënstandardit kanë një karakter tepër të figurshëm. Për qëllimet e tij shfrytëzohen lidhjet asociative të papritura, që shpesh janë të papajtueshme me natyrën e shtratit figurativ tradicional të gjuhës shqipe. Ato bëjnë efekt të fortë mbi dëgjuesin për shkak të mënyrës së paartikulluar dhe difuze, me të cilën janë konceptuar, të ndryshme nga fjalët e zakonshme. Shndërrime të tilla u bien ndesh modeleve të zakonshme të gjuhës dhe pasqyrojnë një kundërvënie me mendësinë dhe moralin shoqëror mbizotërues. Shembuj mjaft kureshtarë për këtë mund të gjenden në mikrotoponiminë e disa qyteteve, si në kryeqytet, në Tiranë: *Birrari aspirina, Zogu i zi, Kafene Gjirokastra, Tajvani*. Shembuj nga

qytetet e tjera: *Kuzlala, Kuzçaça, Klubi i zagarëve (për: i gjuetarëve), Dyqani i Demo Demës (për: i mallrave të demoduara)*. Shembulli më i fundit janë pikat e krahut të lirë të punës nëpër qytete, të cilat sipas shembullit të emigrantëve të Athinës, quhen të gjitha *Omonia*. Disa folje janë më të parapëlqyerat për të dhënë kuptimet intensive: *vras, rruaj, këpus, fus, fshij*.

Të gjitha këto sjellin te një leksikalizim i lartë i togfjalëshave dhe te ndryshime semantike në kuptimet e fjalëve. Një pjesë e madhe e komunikimit në nënstandard përbëhet nga fjalë-fjali, nga togfjalësha dhe shprehje idiomatike. Po sjell disa shembuj, që e konkretizojnë këtë grafikiisht:

- *tenxhere me presion, macja e zezë, kanceri* (për vjehrrën).
- *cigare me tapë, me pambuk, bythëpambuke* (cigare me filtër).
- *rimorkioja* (gruaja).
- *peshkop, i peshkoposur* (student i zellshëm).
- *sapun me rahat* (sapun tualeti).
- *në diskut* (me këmbët zbathur).
- *mylle radien* (hesht).

Shkallën më të fundit, nëse do të bënim një renditje, e përbëjnë fjalët, të cilat praktikisht është e pamundur të përcaktohen nga kuptimi edhe prej vetë atyre që i përdorin. Unë kam regjistruar në Durrës, porti më i rëndësishëm i Shqipërisë në perëndim të Tiranës, fjalë si: *shapshell, zhallgavesh, kariskaq, panxhivill*, të cilat duhet ta kenë një prejardhje normale, por askush nuk qe në gjendje të më jepte një shpjegim të pranueshëm për to.

\*

\*

\*

Gjatë këtyre tre vjetëve të fundit të përmbyseje të thella politike dhe shoqërore në Shqipëri shumë gjëra kanë ndryshuar për mirë dhe për keq. Edhe gjuha nuk ishte e imunizuar nga ndikimi i ngjarjeve. Vendosija e demokracisë rishtroi disa nga problemet

themelore. Nga shumë veta demokracia perceptohet në radhë të parë si sigurimi i lirisë së fjalës dhe mbrojtja e saj. Ka ndodhur një shpërthim kundër gjithë shtrëngesave të mëparshme, që i vishen regjimit të mëparshëm totalitar. Unë besoj se shumë shfaqje mund të përdoren si një material jashtëzakonisht interesant për studime psikanalitike.

Veprimtaritë publike, manifestimet politike dhe demonstratat e dhunshme u shoqëruan nga një dëshirë e papërmbajtur për të shkatërruar gjuhën e fosilizuar dhe të kontrolluar rreptësisht të ideologjisë së vjetër komuniste. Për herë të parë tashti njerëzit gëzojnë një shtyp të lirë. Por do të thosha se ndoshta ky është një nga shtypet më agresive në Europë. Ai në të vërtetë nuk kursen askënd dhe asgjë, shpesh duke shkelur rregullat më elementare të etikës. Gjatë fushatës elektorale për herë të parë me sa mbahet mend u shfaqën nëpër muret e rrugëve shkrimet e quajtura grafite, shpesh me fjalë të ndyra dhe sharëse. Për shembull, edhe sot mund të lexosh të shkruar mbi një mur në Tiranë "mutist", një shpikje tipike e nënstandardit me konotacione të hapura skav <sup>symposion</sup> <sub>steurof</sub> e. Nisën të botohen për herë të parë shkrime pornografike. <sup>B.a.p.</sup> Dhe duhet mbajtur para sysh, se kjo po ndodh në një shoqëri <sup>in</sup>, ka pasur rrënjë të thella të mendësisë patriarkale.

Në këtë klimë u vu në pikëpyetje vetë ekzistenca e shqipes së njësuar. Sulmet kundër shqipes standard gjetën një mbështetje në librin e Arshi Pipës "Politika gjuhësore në Shqipërinë socialiste" (7). Në një polemikë të gjatë me këtë libër (8) unë jam përpjekur të tregoj se sa të pabazuara janë përpjekjet e tij për të krijuar rishtas dy shqipe standard. Opinioni i përgjithshëm në Shqipëri gjithashtu ka reaguar në mënyrë negative kundrejt këtij rreziku serioz për frymën kombëtare.

Por, pa dyshim, ka disa rrethana që krijojnë pengesat kryesore në rrugën e mëtejshme të shqipes standard. Me keqardhje mund të



konstatojmë, se analfabetizmi do të rishfaqet në Shqipëri. Tani për tani duket se askush nuk po shfaq ndonjë kujdes të veçantë, që në botimet e ndryshme të përdoret gjuha e rregullt. Krahas botimeve komerciale dhe me cilësi të dobët, po dalin mjaft përkthime të këqija. Fjalori i fëlliqur po fiton të drejta civile edhe midis fëmijëve. Parulla "E duam Shqipërinë si gjithë Europa" ka hapur portat për huazime të pakontrolluara dhe, në pjesën më të madhe të panevojshme. Purizmi është flakur si pjesë e politikës së mëparshme të izolimit. Ndërmjet politikanëve të tipit të ri që dolën në skenë, ka njerëz pothuaj pa asnjë shkollim të nevojshëm gjuhësor. Ringjallja e stilit fetar do të japë një ndihmesë për të ndërprerë degradimin e stilit fetar në gjuhën shqipe, por të paktën me aq sa shohim, shumica e botimeve fetare lënë shumë për të dëshiruar. Në disa libra, që merren me islamizmin, shqipja është përzier keq me huazime arabizma. Do të shtroja pyetjen a shënon kjo një etapë të re në jetën e huazimeve orientale në gjuhën shqipe?

Duke i përmbledhur së bashku të gjitha këto anë, mund të pohoj se shqipja <sup>(me kë...</sup> nuk është më në pozitën e fitores triumfale. Marrëdhëniet <sup>(he...</sup> me shqipen e nënstandardit dhe jashtë standardit po bëhen gjithë <sup>në t...</sup> e më komplekse dhe problematike. Nuk është punë e gjuhëtari të bëjë parashikime dhe profeci, por një gjë është e sigurtë. Ka rëndësi jetike që të nisë studimi serioz i shqipes nënstandard mbi baza shkencore bashkëkohore.

## SHËNIMET

1. KOSTALLARI, A., *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, në: "Studime filologjike", 1968, nr. 2, f. 50.
2. KOSTALLARI, A., *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, në: "Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, 20-25 nëntor 1972", vëll. I, Tiranë, 1973, f. 76.
3. KOSTALLARI, A., *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, në: "Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë", Tiranë, 1988, f. 34.

4. LLOSHI, XH., *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1987, f. 131-134; ribotuar nga "Rilindja" në Prishtinë, 1988. Në këtë libër unë kam përdorur termin *ligjërim i shkujdesur*, në kuptimin e nënstandardit, duke mos e pranuar kalkimin e bërë nga A. Kostallari *thjeshtligjërim* sipas fjalës përkatëse të rusishtes, sepse është në kundërshtim me semantikën e shqipes.
5. HARTMANN, R.R.K., *Style values: Linguistic Approaches and Lexicographical Practice*, volume II, no 3, Autumn 1981, f. 263-273.
6. LLOSHI, XH., *po aty*, f. 156-161.
7. PIPA, A., *The Politics of Language in Socialist Albania*, Columbia University Press, New York 1989, 283 f.
8. LLOSHI, XH., *Kultura shqiptare përpara shqetësimesh të reja*, në: "SOT", 1991, nr. 5-6, f. 5-29.

*Mbajtur si kumtesë në Simpoziumin "Standardi gjuhësor dhe nënstandardi në Europën Jugore dhe Lindore", Berlin, 12-16 tetor 1992.*

*Botuar anglisht me titullin Substandard Albanian and its Relations to Standard Albanian, në: Sprachlicher Standard und Substandard in Südosteuropa und Osteuropa. Beiträge zum Symposium vom 12.-16. Oktober 1992 in Berlin". Osteuropa-Institut der Freien Universität Berlin. Balkanologische Veröffentlichungen. Band 25. Berlin, 1994, f. 184-194.*

## SHQIPJA: NGRITJA E NJË GJUHE NË NIVELIN E STANDARDIT KOMBËTAR

1. Gjuha shqipe është pranuar nga shumica e studiuesve si pasardhësja deri në kohët e reja e ilirishtes, një gjuhe të folur në lashtësi në Ballkanin jugperëndimor, porse shqipja është e dokumentuar mjaft vonë. Për këtë arsye është bërë një gjë e zakonshme të pyetet, se “Kur është shkruar për herë të parë shqipja?” Mirëpo unë do të kërkoja që të shtrohet pyetja nga ana tjetër: “Përse do të shkruhej shqipja?” Që të jepet një përgjigje me peshë, është e nevojshme të jepet një periodizim i historisë së gjuhës shqipe (Lloshi, 1984; Demiraj, 1986:58). Vetë emërtimet që i janë dhënë gjuhës sonë kanë një domethënie vendimtare për historinë e saj.

I. *Shqipja e vjetër* - afërsisht deri në shek. 8-9 të erës sonë. Përmes evoluimit gradual të ilirishtes, në një periudhë ndërmjet fazës së fundit të ndikimit intensiv të latinishtes mbi ilirishten dhe vendosjes së përhershme të sllavëve në Ballkan, u formua shqipja si një gjuhë më vete.(1). Nuk ka ndonjë gjasë që të kemi nga kjo periudhë ndonjë dokument të shkruar të shqipes.

II. *Shqipja e mesme* - afërsisht deri nga fundi i shek. 17, periudhë në të cilën ajo thirrej *arbërishte* dhe populli që e fliste *arbën-arbër, arbënesh-arbëresh*. Duke nisur nga shek. 11 emri *arbënesh-arbëresh* u përhap gradualisht mbi gjithë arealin e shqipes. Në përputhje me tronditjen e Perandorisë Bizantine në shek. 12, u ngrit si forcë politike klasa e feudalëve arbëreshë dhe u krijuan

principatat e Arbërisë. Pikërisht në këto rrethana të shteteve feudale, kur populli i zakonshëm dhe klasa sunduese ishin nga po ajo popullsi vendëse, lindi kërkesa historike për ta shkruar gjuhën shqipe. Është e kuptueshme, se shkrimet e para ishin në fushën e ekonomisë, tregtisë, administratës dhe fesë, të hartuara nga klerikë të ulët.

Faza e fundit e arbërishtes (shek. 15-17) është koha e proceseve, që çuan në shqipen e re dhe njëherazi koha e ngjarjeve të rëndësishme historike dhe kulturore.

Pas 25 vjet luftë të Skënderbeut, sulltanët më në fund e pushtuan edhe këtë pjesë të Ballkanit. Ishte hera e tretë që këto treva përfshiheshin në një prandori universale, me të gjitha pasojat që sjell kjo me vete. Për shkak të ndeshjes në të gjithë vijën të sferave politike, shoqërore, ekonomike, fetare dhe kulturore me - në fillim - një botë totalisht të huaj të osmanëve, midis shqiptarëve u përftua një vetëdije e re e bashkësisë kombëtare. Kësaj iu përgjigj edhe një vetëdije e re dhe më e përgjithësuar gjuhësore, që e dallonte këtë bashkësi njerëzish, të cilët e kuptonin njëri-tjetrin qartë, domethënë që e kuptonin njëri-tjetrin *shqip*.

U bë e mprehtë kërkesa për ta përpunuar shqipen si një gjuhë të shkruar tashti, që asaj i dilte detyrë të shërbente si mjet për të mbrojtur kulturën vendëse. Të gjithë autorët me rëndësi të letërsisë së vjetër shqipe flasim me terma të qartë për nevojën që të mbrohet shqipja dhe puna e tyre e shquar, nga ana e vet, i shërbente këtij qëllimi.

III. *Shqipja e re* - deri në ditët tona. Duke e lënë pas shekullin 17, shqiptarët e quajnë veten *shqiptarë* dhe gjuhën e tyre *shqipe*. Për këtë periudhë tashmë nuk e shtron më njeri pyetjen e dokumentimit të parë të shqipes. Nis të zhvillohet një letërsi e vërtetë, veçanërisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Që nga kjo kohë e këtej del si problem qendror përpunimi dhe konsolidimi i shqipes së shkruar, njëkohësisht edhe evoluimi i përgjithshëm

varet prej tij. Por ajo do të ballafaqohej me një faktor shumë të rëndësishëm: për shkak të mosvazhdimit të gjatë të kontakteve të dendura midis tyre, dy dialektet kryesore në trajtën e tyre të folur po ndiqnin një evoluim të veçuar.

2. Shqipja e shkruar e shekujve 18-19 nuk ishte një vazhdim i thjeshtë i traditës së mëparshme. Të gjitha problemet e saj në një mënyrë ose në një tjetër do të ritrajtoheshin, madje në rrethana shumë të pafavorshme deri më 1912. Sunduesit osmanë bënë përpjekje të egra për ta shtypur shqipen dhe mësimi i shqipes ishte bërë një veprim që dënohej me ligj. Gjuha shqipe e shkruar ka bërë një betejë të gjatë për të fituar të gjitha fushat e përdorimit të saj, që e bëjnë një mjet shumëfunksional, të aftë për të qenë shprehje e kulturës shqiptare si tërësi. Futja e shqipes në shërbesat fetare u quajt si një hap drejt identitetit kulturor kombëtar. Që nga shek. 18 vëmë re shqipja nis të përdoret në veprimtaritë ekonomike e tregtare. Në gjysmën e dytë të shek. 19 dalin për herë të parë gazeta shqip, në fillim në diasporën shqiptare. U bënë hapa përpara në gjuhën e shkencës, në lidhje me nevojat e shkollës dhe të botimeve filologjike. Lidhja Shqiptare e Prizrenit paraqiti kërkesa të përcaktuara për gjuhën e administratës dhe të gjyqeve.

Çështja e gjuhës zinte një vend qendror në programin e Rilindjes Kombëtare. Por nuk ishin pjekur kushtet që të pretendohesh për një gjuhë standard të përbashkët, aq më tepër në një vend ku deri në fund të shek. 19 nuk kishte as qendra të botimeve dhe të shtypit. Si rrjedhim, mbi bazën e dy dialekteve kryesore të shqipes lindën dy variante letrare. Brenda tyre kishte gjithashtu ndryshime, kurse disa autorë i përzienin dhe madje u bënë përpjekje për një variant të tretë, të ndërmjetëm, të mbështetur në të folmen e qytetit të Elbasanit. Në prag të pavarësisë më 1912 ishte tashmë e dukshme ndarja midis variantit të shkruar verior ose gegë dhe variantit jugor ose toskë. Autori i parë që e ndoqi në mënyrë të qëndrueshme këtë

ndarje ka qenë Kristoforidhi (1827-1895), i cili i botoi përkthimet e veta të Biblës njëkohësisht në të dy variantet.

Vetëm më 1908, në Kongresin e Manastirit, u arrit te alfabeti i shqipes në trajtën e sotme, pas një periudhe pranije të një shumësie alfabetesh, që përdoreshin në përputhje me orientimet kulturore e politike të autorëve përkatës. Siç e ka shprehur poeti i njohur Gjergj Fishta (1871-1940): “Shqipja u kthye nga Perëndimi”.

Shpallja e Pavarësisë më 1912 nuk e gjeti shqipen të papërgatitur për funksionet e reja që duhej të kryente në shtetin shqiptar. Por pikërisht kur u krijuan kushtet, që shqipja të zhvillohej si gjuha e një shteti kombëtar, areali i kësaj gjuhe u copëtua dhe pjesë të mëdha ranë në situata krejt të ndryshme.

Brenda shtetit të sapokrijuar ideja e një gjuhe shqipe letrare kombëtare u bë një domosdoshmëri urgjente. Paradoksalisht, përpjekja e parë për ta arritur këtë synim u bë në vitet e Luftës I Botërore, por në këtë paraqitje shumë të ngjeshur unë nuk mund të hyj në hollësitë e këtij problemi dhe të shumë të tjerëve. Në Shkodër u ngrit një Komisi Letrare në vitet 1916-1917, që mori një varg vendimesh lidhur me drejtshkrimin e shqipes. Që nga ky moment drejtshkrimi dhe gjuha letrare u bënë sinonime. Vendimet i afruan gegërishten dhe toskërishten e shkruar. Shpresohej se me këtë rrugë, përmes një procesi të ngadaltë konvergjence, të dy variantet kryesore do të shkriheshin në një shqipe letrare të njësuar. Komisia e Shkodrës shënon një etapë të re për shqipen e re: periudhën e *shqipes së sotme*.

3. Hullitë e hapura në Shkodër u pranuan nga Kongresi i Lushnjes më 1920. Në nëntor 1921 Konferenca e Ambasadorëve në Paris e njohu Shqipërinë si një shtet të pavarur sovran. Shqiptarët, ende të frymëzuar nga idealet e periudhës së Rilindjes, pranuan një kompromis. Me një dekret të vitit 1923 u shpall “shqipja zyrtare”, domethënë dialekti i Elbasanit, duke ruajtur sa më shumë të ishte e

mundur gjithçka të përbashkët për variantet e ndryshme letrare të shqipes, u miratua si baza e gjuhës së re të standardizuar.

Gjatë 20 vjetëve që pasuan praktikisht nuk u zbatua ndonjë politikë e shprehur gjuhësore. Por ne duhet të pranojmë se problemi tashti shtruhej në rrethana të reja. Rilindja Kombëtare ishte një orientim i përcaktuar kulturor, që e vendoste *unitetin kombëtar* si faktorin kryesor veprues. Në kulturën shqiptare përgjithësisht kjo periudhë përkon me mbizotërimin e romantizmit.

Pas Pavarësisë faktorët e brendshëm shoqërorë-politikë fituan gjithnjë e më shumë rëndësi. Tani nisi të kuptohej se zgjedhja e variantit standard nuk mbështetet thjesht në kritere gjuhësore ose estetike, por edhe në kritere politike, sociale dhe kulturore. Paralelisht me idenë e vjetër të konvergencës së varianteve letrare, lindi opsioni për ta ruajtur gjendjen dhe madje për t'i shtuar ndryshimet ndërmjet dy varianteve kryesore. Kjo ishte një përpjekje për t'i shndërruar dy variantet në dy orientime të ndryshme kulturore, të mbështetura në ndryshimet gjeografike, etnografike, dialektore, fetare dhe të tjera, madje duke vënë në pikëpyetje edhe vetë unitetin kombëtar. Një shprehje e përqendruar e kësaj ishte edhe parulla: shqipes dykrenore në flamurin e Shqipërisë i përgjigjet edhe gjuha shqipe dydialektëshe.

Diskutimi rreth gjuhës letrare kombëtare u ndërpre nga Lufta e Dytë Botërore.

4. Kur Musolini pushtoi Shqipërinë në prill 1939, atij as që mund t'i shkonte ndër mend se si pasojë do të kishte Luftën Nacionalçlirimtare dhe se kjo luftë do të përfundonte me fitoren e komunistëve. Enver Hoxha shumë shpejt e ktheu atë nga një luftë nacionalçlirimtare në një revolucion komunist. Tashmë pak a shumë gjithkush di diçka rreth natyrës së vërtetë të diktaturës në Shqipëri. Ndikimi i diktaturës mbi gjithë jetën e këtij kombi është një temë e gjerë dhe e ndërlikuar. Me një përgjithësim shumë të gjerë, unë do të vija në dukje dy anët e çështjes gjuhësore.

Nga njëra anë, kishte një politikë zyrtare, që rridhte nga ideologjia sunduese, e cila depërtonte në çdo aspekt të orientimeve kulturore. Kërkesa gjithëpërfshirëse e partisë-shtet për ta standardizuar jetën përcaktoi edhe synimin, që u vendos nga regjimi, për ta njësuar shqipen.

Nga ana tjetër, ka pasur një zhvillim të brendshëm objektiv të vetë gjuhës, që i përgjigjej evoulimit të kohëve moderne. Do të ishte një mendjelehtësi të injoroheshin kërkesat e një shteti të përqendruar në kohën tonë dhe të një kulture në sfondin e mjeteve të komunikimit masiv, të lëvizjeve demografike masive, të telekomunikimeve masive, të propagandës masive e kështu me radhë. Pas një procesi historik të gjatë e të ndërlikuar ishte pjekur koha që njëra nga format e “shqipes së lëvruar” të shndërrohej në gjuhën standard.

Do të rendis më poshtë ngjarjet kryesore që janë piketa në rrugën e këtij procesi.

Pas Luftës II varianti jugor mbizotëroi në botimet zyrtare dhe gjysmëzyrtare. Që më 1951 pati një urdhër administrativ për ta përdorur variantin jugor në librat shkollorë, duke nisur me abetaren.

Dy konferenca më 1952 u përqendruan në çështjen e gjuhës letrare kombëtare.

Pas një konference për ortografinë më 1953, me botimin më 1956 të *Ortografisë së gjuhës shqipe* u bë një hap përpara në standardizimin e dy varianteve letrare, që ende ishin në përdorim në atë kohë.

Rregullat e para të drejtshkrimit, që synonin të paraqisnin një gjuhë të njësuar kombëtare u botuan më 1967: *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes*.

Edhe në Kosovë u organizuan tri konferenca: më 1952, 1957 dhe 1963. *Ortografia* e botuar më 1964 ishte kodifikimi më i avancuar i variantit gegë, duke përfshirë elementë të rinj të konvergjencës.



Një pikë kthese ka qenë Konsulta gjuhësore e Prishtinës më 1968, e cila miratoi gjuhën letrare në përdorim në Shqipëri, duke hequr dorë nga standardi gegë. Ishte hapur rruga për Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 në Tiranë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Shqipëria dhe jashtë Shqipërisë.

*Kongresi i Manastirit më 1908, puna e Komisionit Letraro të Shkodrës më 1916-1917 dhe Kongresi i Drejtshkrimit janë tri ngjarjet kulmore në historinë e shqipes së sotme.*

5. Pas Kongresit të Drejtshkrimit përdorimi i variantit standard të njëzuar u bë i detyrueshëm dhe nuk u botuan më tekste të reja letrare në variantin e gegërishtes. Kosovaret, të cilët e përdorin shqipen letrare në mënyrë të vetëdijshme, e futën variantin standard në veprimtaritë zyrtare dhe në letërsi, duke treguar zellin më të lavdërueshëm.

Tablonë e një gjuhe kombëtare të lëvruar dhe të kristalizuar e plotësuan botime të rëndësishme akademike: Rregullat e drejtshkrimit më 1973 dhe Fjalori drejtshkrimor më 1976, Gramatika më 1976, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe më 1980. Për kujdesin ndaj gjuhës (Sprachpflege) u krijuan dy revista të reja: "Gjuha jonë" më 1981 në Tiranë dhe "Gjuha shqipe" më 1984 në Prishtinë.

U mbajt një seminar për problemet e gjuhës letrare në Prishtinë më 1980 (punimet janë botuar më 1983). Një konferencë tjetër e gjerë me temë "Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë" u organizua me tone triumfuese më 1984 në Tiranë. Këtë radhë u vendos një synim i ri: të ecet më tej në standardizimin e gjuhës së folur. Madje edhe librat për gramatikën e shqipes të përgatitur nga autorët e huaj tashmë mbështeten në variantin e njëzuar letrar. Do të citoja një prej tyre: "Efektet e të gjithë hapave drejt standardizimit tashmë janë të dukshme në gjithë botën shqipfolëse". (Newmark, 1982:8). Edhe emisionet në radiostacionet e huaja për Shqipërinë e pranuan formën standard.

6. Ndryshimet e mëdha në Europën Lindore më 1989 e tronditën edhe regjimin e ngurtë totalitar në Shqipëri. Nga fundi i vitit 1990 nisi formimi i partive politike opozitare dhe në mars 1991 u mbajtën të parat zgjedhje demokratike. Një vit më pas zgjedhjet e reja sollën fitoren e Partisë Demokratike. Qeveria e re nisi një program reformash dhe ngritjen e ekonomisë së tregut të lirë.

Që në fillimet e tij “revolucioni demokratik” në Shqipëri u shoqërua nga një komponente e fortë gjuhësore. Shkatërrimi i modelit autoritar dhe tejet të centralizuar të regjimit të vjetër u mor nga disa njerëz si diçka që duhej zbatuar edhe në fushën e gjuhës e, në mënyrë më të përgjithshme, në çdo aspekt të kulturës. Nisi të frynte një erë e tipit të “Proletkultit” të Rusisë. Në këtë atmosferë u sulmua edhe shqipja letrare e njësuar. Por duhet të themi se nuk ishte hera e parë që dëgjoheshin zëra kundërshtues ndaj shqipes letrare të njësuar.

Që më 1952 A. Xhuvani dhe E. Çabej ishin kundërvënë ndaj një zgjidhjeje të shpejtë në favor të dialektit jugor ose toskërishtes. Jashtë vendit, Max Lambertz i Universitetit të Lajpcigut ngrinte lart poezinë epike të Veriut dhe gjuhën e Gjergj Fishtës. Mjaft gjuhëtarë shqiptarë, duke e pranuar nevojën e një gjuhe standard, nuk pajtoheshin me interpretimet e imponuara nga A. Kostallari.(2). Pikërisht A. Kostallari kishte kritikuar J. Byron (1976) për një interpretim tjetër të shqipes letrare të njësuar (Kostallari, 1984).

Por shkatërrimtari më i spikatur i shqipes letrare (Prifti, 1990) u bë Arshi Pipa. Libri i tij “The Politics of Language in Socialist Albania” (1989) është jo vetëm përmbledhja më gjithëpërfshirëse, por edhe burimi i gjithë çështjeve, që janë vënë në diskutim gjatë katër vjetëve të fundit. Dhe më duhet të them se si pasojë e tij, diskutimi u shndërrua në një debat politik lakuriq dhe mjaft agresiv.

Të më lejohet të vë në dukje disa nga pikat më të debatueshme.

a. Emërtimi. - A. Kostallari ngulte këmbë për “gjuhën shqipe letrare të njësuar”. Ky është një vijim i idesë romantike për një

komb të njësuar, që është formuluar me terma të qartë nga atdhetarë të njohur shqiptarë si S. Frashëri dhe F. Konica. Po kjo atmosferë në Kosovë përftoi parullën “Një komb - një gjuhë”.

Unë i përmbahem mendimit se, në kuptimin e rreptë shkencor, duhet të përdorim termin “shqipja standard” (SHS). Me këtë do të shmangnim mjaft diskutime të kota dhe në veçanti politizimin e tyre të dëmshëm.(3). Pas librit të J. Byron, një numër studiuesish shqiptarë e kanë pranuar këtë emërtim: Lloshi 1984; Ismajli 1992; Altimari 1992; Prifti 1992; por edhe të tjerë (Newmark 1982).

Në këtë mënyrë, fakti që SHS mbështetet në fonologjinë e toskërishtes, e humbet gjithë ngarkesën polemike: përpjekjet e A. Kostallarit për të vërtetuar se kjo është një “gjuhë letrare e njësuar koine sui generis”, ashtu si dhe sulmet e A. Pipës kundër SHS si një “mashttrim kolosal”, si “stratagjemë politike”, bien poshtë.(4)

b. Karakterizimi. - Shumica dërrmuese e autorëve e pranojnë shqipen letrare po me ato cilësime, që i kanë përdorur gjatë njëzet vjetëve të fundit:

- një mjet i njësisë rreth idesë kombëtare, që ndihmon për forcimin e vetëdijes kombëtare; një arritje dhe fitore e kulturës kombëtare për të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarët; një kërkesë këmbëngulëse e zhvillimit kulturor, pa të cilën kombi nuk do të mund të përfshihej në rrjedhat moderne e kështu me radhë (Domi-Ajeti, 1992; Çeliku, 1992; Lafe, 1992; Kelmendi, 1992). (5).

Një varg shkrimtarësh të sotëm janë shprehur drejtpërdrejt në mbrojtje të gjuhës letrare (I. Kadare, R. Qosja, D. Agolli, M. Isaku). (6).

Një grup studiuesish, duke e cilësuar atë si gjuhë standard dhe jo një produkt të konvergjencës së dy dialekteve, nënvizojnë rëndësinë e SHS si shumë të nevojshme dhe të pazëvendësueshme për kombin në kohën tonë (Newmark, 1982; Prifti, 1990; Lloshi, 1991; Ismajli; 1992; Altimari; 1992; Agalliu, 1993, Olberg, 1992; Vehbiu, 1992). (7).

Madje edhe njerëz që kanë qëndrim shumë kritik ndaj aspekteve të tjera të konsolidimit të standardit letrar, nuk e hedhin poshtë vetë standardin (Beci. 1992: Luka. 1993). (8).

Grupi i kryesuar nga A. Pipa e sulmon shqipen letrare në të gjitha aspektet. Për të (Pipa, 1989) GLN është:

- një dukuri e kolonializmit gjuhësor të brendshëm: një çorbë doktrinash të ndryshme; një dështim gjuhësor; një gjuhë e trilluar me djallëzi, që synon të vrasë binjakun e vet; një stratagemë politike, e përpunuar për të bërë të përhershme hegjemoninë kulturore të një pjese në minoritet të kombit mbi pjesën tjetër; një zgjidhje aneksioniste; ajo ka si funksion të sigurojë hegjemoninë toske mbi gegët për brezat që do të vijnë, e kështu më tej. Dhe mallkimi më përbuzës për të është që të quhet “gjuhë kostallariane” (Pipa, 1994).

Sipas S. Repishtit (1992:16), GLN: “u ka shkaktuar dëme të mëdha talenteve të shkrimtarëve dhe poetëve të Shqipërisë së Veriut dhe të Kosovës, që janë të familjarizuar me dialektin gegë”.

Pasuesit e Pipës madje kanë vënë në pikëpyetje parullën “Një komb - një gjuhë”. (9).

c. E kaluara. - Në debatin e tanishëm procesi historik deri më 1944 preket vetëm shkarazi. Veprimtarët e Rilindjes lëvdohen për bëmat e tyre, por periudha e regjimit të mbretit Zog kalohet në heshtje (Domi-Ajeti, 1992). Diçka ndryshon, kur është fjala për Komisinë Letrare të Shkodrës.

Disa autorë parapëlqejnë të nënvizojnë se ndihmesën më të madhe e kanë dhënë përfaqësuesit e Shkodrës. (10).

Por është përsëri A. Pipa, që ngre një kundërshtim: “Duke i bërë këto lëshime toskërishtes, Komisia Letrare në fakt e shkatërroi parimin fonetik themelor për projektin e reformës së saj. Me fjalë të tjera, zelli patriotik doli mbi rreptësinë shkencore”. (Pipa, 1989:3; 1994:35).

d. Përpunimi dhe zbatimi. - Në këta katër vjet të fundit disa studiues shqiptarë nuk kanë shprehur ndonjë qëndrim kritik kundër rrugës, përmes së cilës standardi letrar u përpunua dhe u vu në zbatim. (Domi-Ajeti, 1992). Por edhe njerëz, që e mbështesin plotësisht SHS, janë për një rishikim mbi baza më objektive dhe jo tendencioze të procesit historik. Këtu dalin disa pika për diskutim: interpretimi teorik, Kongresi i Drejtshkrimit, ndalimi i variantit verior në letërsinë e re, shtypja e diskutimit të lirë, politizimi i skajshëm, këmbëngulja e tepruar në normëzimin, qëndrimi dhe roli i shqiptarëve të Kosovës. (11).

A. Pipa ka një qëndrim negativ në të gjithë vijën, ose siç e thotë Prifti më 1990 : “Pipa nuk druhet të përdorë edhe fjalë fyese në këtë libër, dhe as që ka ndonjë dyshim se ndofta përdorimi i fjalëve të tilla i kalon kufijtë e diskutimit akademik”

Nga ana tjetër, unë do të thosha se debati i tanishëm drejtohet kundër shumë pohimeve të A. Kostallarit në artikujt e tij të shumtë, sepse gjatë një periudhe jo të shkurtër çfarëdo kundërshtimi i tyre do të etiketohej politikisht.

Ka një pikë, e cila më duket mjaft e veçantë. A. Pipa (1989:255) ngulmon se “Zbatimi i GLN nga kosovarët ka dalë një dështim i plotë... Pranimi i gjuhës zyrtare të Tiranës ka qenë pasojë e presionit të madh nga ana e studentëve... disa prej të cilëve simpatizantë dhe disa ndoshta agjentë të regjimit të Tiranës”. Në recensionin tim për librin (Lloshi, 1991:9) kam nënvizuar faktin, se kërcënimi nga ana e serbëve për të “shpikur” një gjuhë tjetër shqipe, të quajtur “Shiftarski jezik” ka qenë një faktor me rëndësi për organizimin e Kongresit të Drejtshkrimit. Tani A. Haxhi (1993:75) na e quan këtë pohim timin si “naiv dhe krejt të pabesueshëm”. E po mirë, pikërisht A. Pipa ka botuar një recension të librit të M. Dogos (1992:195). Kurse M. Dogo pothuaj njëkohësisht me artikullin tim ka shkruar, se kosovarët e hodhën poshtë nofkën “shiftar”, ndërsa revolta e

tyre nisi me protestën gjuhësore dhe ata pranuan variantin toskë të gjuhës. sepse kërkonin që të identifikoheshin me shqiptarët e atdheut mëmë. Ky është një fakt historik. ndonëse për ca njerëz fare i pabesueshëm.

7. Vitet e fundit gjithashtu ka pasur disa ngjarje me rëndësi.

Në dimrin e vitit 1990 nisi botimin revista "Albanica". e përgatitur nga Pipa dhe një grup shkodranësh, me qëllimin që "të mos lihet gegërishtja letrare të vdesë, ashtu siç e kishte dekretuar qeveria shqiptare staliniste".

Për këtë qëllim u bë një diskutim rreth tryezës në Shkodër më 26 qershor 1992 dhe u botua një Deklaratë e gjuhëtarëve të Shkodrës (Deklaratë...1992). A. Pipa mori pjesë në këtë mbledhje dhe e ka nënshkruar i pari Deklaratën.

Më 20-21 nëntor 1992, për të përkujtuar përvjetorin e njëzetë të Kongresit të Drejtshkrimit, u mbajt një Konferencë në Tiranë: "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot". Punimet e kësaj konference nuk u botuan, me përjashtim të disa kumtesave në shtypin e përditshëm. Shumica e pjesëmarrësve, duke përfshirë shqiptarët nga Kosova dhe diaspora, e mbështetën standardin kombëtar. Vërejtjet e tyre për çështje të veçanta tashmë i kam përmendur. Por pati edhe reagime negative ndaj tij. (12).

Ndërkaq, pasi botoi një numër artikujsh politikë, duke e nxirë gjendjen në shkencën gjuhësore gjatë regjimit komunist, B. Beci (1993) na u caktua drejtor i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë. Me nismën e Institutit më 8 tetor 1993 u thirr në Tiranë një Konsultë për studimet në fushën e gjuhësisë shqiptare. Këtë radhë reagimi në shtyp ishte i nxehtë dhe tejet i politizuar nga të dy krahët. (13).

Duke nisur nga viti 1991 disa trajta të variantit letrar të gegërishtes kanë nisur të përdoren jo vetëm në veprat letrare, por edhe në shtypin e përditshëm. Ka disa revista, sidomos me orientim katolik, që botohen në variantin e Shkodrës. A. Pipa në bashkëpunim

më A. Klosin po boton gazeta, revista dhe periodikë që jetojnë vetëm tre numra, si edhe antologji, që riprodhojnë intensivisht pjesë të librit të A. Pipës dhe letra të tij. Por vitin e fundit nuk u jepet më publicitet vizitave të A. Pipës në Shqipëri.(14). Përgjithësisht, në momentin e tanishëm, në Shqipërinë pluraliste po duken shenja të një rigjallërimi të interesit për të shkruar në variantin e gegërishtes.

8. Era e ndryshimeve në gjuhësinë shqiptare dhe në gjuhën shqipe shtrun çështjen e së ardhmes.

Shumica e njerëzve që janë përfshirë në këtë debat mbështesin SHS dhe janë kundër policentrizmit gjuhësor. Të ardhmen ata e shohin në një lëvrim të pandërprerë të SHS.

Vetëm A. Pipa, i ndjekur nga një grup i vogël përkrahësish, ngulmon që të bëhet një përmbysje, të flaket SHS dhe të ringjallet gegërishtja letrare ("Albanica", nr. 3-4, dimër 1992, f. 7). Por nga gjithë shkrimet e tij është e qartë, se A. Pipa po lufton jo për gegërishten, por për një shqipe standard, të bazuar në të folmen e Shkodrës.(15).

Deklarata e Gjuhëtarëve të Shkodrës është konfuze lidhur me SHS (16), por në thelb kjo Deklaratë e mbështet idenë e dy standardeve letrare paralele. Me terma të mjegullt problemi është formuluar edhe nga S. Repishti (17), por në thelb ai pajtohet me dy variante të lira, mjaft të ngjashme por jo identike.

Zgjidhja më realiste, në përputhje me praktikën tashmë të ngulitur, duket se është zhvillimi i mëtejshëm i SHS dhe përdorimi i lirë i variantit verior (si edhe i varianteve të tjera më të kufizuara) në letërsi, në shfaqjet artistike dhe në gazetari ose oratori.(18).

Janë paraqitur propozime për një farë "kombinimi", duke nënkuptuar integrimin e disa elementëve strukturorë të dialektit gegë në SHS (19), por kjo është kundërshtuar me forcë si jo realiste dhe jo shkencore. (20).

9. Si përfundim, mund të them se ngritja e shqipes në nivelin e standardit kombëtar mund të ndiqet drejtpërdrejt si një realitet i

gjallë dhe dinamik. prandaj është me interes edhe për teorinë gjuhësore. Diskutimi i përtërirë rreth saj vetëm mund të përshëndetet.

Ka disa zëra, që po kërkojnë një kongres gjuhësor të ri, të tretë. Domethënia e kësaj është që të sanksionohet një politikë e re gjuhësore në Shqipëri. Por një ide e tillë jo vetëm është kundërshtuar, por unë nuk shoh asnjë mundësi reale në të ardhmen e afërt për ta zbatuar praktikisht. Dhe besoj se tani për tani politika më e mirë do të ishte të mos përcaktohej një politikë gjuhësore në Shqipëri.

## SHËNIMET

1. Ky pohim ka pasoja jo të vogla për një trajtim të drejtë historik në të gjitha punimet tona gjuhësore. Kështu, p.sh., vepra madhore e prof. E. Çabejt "Studime etimologjike në fushë të shqipes" ose duhet të ndryshojë titullin e të quhet: në fushë të shqipes e të ilirishtes. ose studiuesit tanë në të ardhmen duhet të nxjerrin prej saj dy vepra, duke vënë në dukje kontributet e Çabejt për etimologjinë e ilirishtes. Etimologjia e shqipes vjen deri te ilirishtja, ashtu si etimologjia e italishtes vjen deri te latinishtja.
2. Tani po shkruhet edhe në shtyp për këto rezerva të studiuesve, që nuk gjenin mundësi të shpreheshin në mjetet publike (Agalliu, 1993).
3. "Preferoj ta konsideroj më të përshtatshme dhe më adekuat realitetit togfjalëshin 'gjuha letrare standarde'... pa futur në të asnjë vlerësim 'jashtëgjuhësor' të tipit ideologjizues dhe deri diku mistifikues, siç mund të duket anasjelltas shprehja 'gjuha letrare e njësuar'." (Altimari, 1992). Madje edhe vetë A. Pipa (1994:123) e pranon tërthorazi: "Le ta zamë thashë, se na duhet një gjuhë standarde... Gegënishtja i ka kartat në rregull me qenë ajo dialekti i preferuem për ate qellim".
4. Recensionet për librin e A. Pipës janë përgjithësisht negativë: Lloshi, 1991; Prifti, 1990, botuar 1992; Nuhui, 1992; Hetzer, 1992, me ndonjë përjashtim, si Logoreci, 1990; Ternaku, 1992.
5. "Një arritje e madhe e kombit tonë... Ajo është kodifikuar në gjithë hallkat e saj, është kristalizuar e pasuruar, ka fituar aftësi të reja shprehëse, është bërë një gjuhë e përpunuar, e pasur, e njësuar, me mundësi të mëdha zhvillimi të mëtejshëm. Normat e saj janë përvetësuar nga masat e gjera si në Shqipëri edhe nga shqiptarët e ish Jugosllavisë. Gjuha letrare shqipe e njësuar po e zgjeron gjithnjë sferën e përdorimit të saj edhe në diasporën shqiptare, te Arbëreshët e Italisë e gjetkë". (Domi, 1992).



“Gjuha letrare kombëtare e njësuar është arritje e madhe e kombit shqiptar, është fryt i përpjekjeve historike të patriotëve, shkrimtarëve, gazetarëve, politikanëve, gjuhëtarëve. është fryt i përpjekjeve që nisën shumë më herët se 1944-a dhe jo thjesht fryt i një akti të vetëm administrativ, siç është Kongresi i Drejtshkrimit. Gjuha jonë letrare kombëtare është një arritje e rëndësishme 1. në rrafshin historik...2. në rrafshin kombëtar...3. në rrafshin shoqëror...4. në rrafshin kulturor”. (Çeliku, 1992). “U njësuara gjuha jonë letrare dhe u sendërtua edhe në këtë mënyrë ideali i bashkimit gjithëkombëtar... Nuk flet pak e dhëna, madje është shumë domethënëse, se në mbarë periodikun shqiptar të Kosovës nuk gjendet as edhe një shkrim i vetëm polemist a tjetërfare, që të jetë ngritur kundër gjuhës sonë të përbashkët letrare, kundër njësimin të saj për gjithë shqiptarët kudo që jetojnë”. (Kelmendi, 1992).

6. “Fitorja më e madhe, që arriti vendi gjatë 40-vjetëve të udhëheqjes së vendit nga sistemi komunist ishte përkujdesja ndaj gjuhës shqipe”. (Kadare, 1994). “Për tezat se gjuha letrare kombëtare do çbërë për t’u ribërë... s’ka gjë më të keqe. Në tubimin e gjuhëtarëve shqiptarë të gjithë pjesëmarrësit pa kurrfarë përjashtimi u deklaruan për gjuhën e sotme shqipe. Fati i gjuhës së sotme shqipe është vulosur një herë e përgjithmonë”. (Isaku, 1994).

7. “Since the Second World War, numerous attempts have been made in Albania - and supported by Albanian speakers in other countries - to agree on a single variety of the language to serve as a standard language for the country, and those attempts have a considerable amount of success”. (Newmark, 1982:6).

“Gjuha letrare e njësuar ose gjuha standard është një arritje e rëndësishme e kulturës shqiptare... është një realitet i gjallë, është një produkt që i sjell shërbim të pazëvendësueshme kombit”. (Lloshi, 1991:20).

“Një gjuhë standard duhet të kemi dhe ajo nuk ndryshon çdo ditë.

Çfarëdo që të jetë gjuha standarde, ajo do nxënë si mjet kulture, mjet artificial, do nxënë nga gegët e toskët.

Nevoja për fleksibilitet, nga ana tjetër, nuk do të thotë se duhet të hidhet i tërë projekti, pavarësisht se si është ndërtuar. Gjuha standarde ka jetë më të gjatë se sistemet shoqërore apo pushtetet dhe, çka është më e rëndësishme, ritme të tjera zhvillimi e ndryshimi”. (Ismajli, 1992).

“Kemi detyrë si komb ta ruajmë dhe ta fuqizojmë përmes edhe një gjuhe të përbashkët dhe standarde unitetin tonë etnik, që është sot më shumë se dje një trashëgim i vyer dhe i pazëvendësueshëm, një kusht i domosdoshëm për të përballuar rreziqet e çintegritetit dhe sulmet që na sjellin ata, që gjatë historisë bënë çmos për të na ndarë njëri nga tjetri dhe për të na sunduar. Të vësh në

diskutim nevojën e një gjuhe letrare kombëtare të përbashkët d.m.th. të vësh në diskutim vetë unitetin kombëtar”. (Altimari, 1992).

8. “Pavarësisht nga rruga që u ndoq për kristalizimin e saj, përbën një vlerë kombëtare”. (Beci, 1992).

“Që Kongresi i Drejtshkrimit vendosi në bazën e gjuhës letrare të njësuar toskërishten letrare, kjo nuk përbën delikt, mbasi toskërishtja është dialekt i gjuhës shqipe, të cilën edhe ne, autorët shkodranë, po e shkruajmë tash 20 vjet pa u ankuar”. (Luka, 1993).

9. “Që nga 1968, në Konsultën e Prishtinës e deri sot, përherë e më shpesh po ndeshemi me slloganin ‘një komb - një gjuhë’, i cili çon në rrjedhoja të tejskajshme, që mohojnë vlerat e një dialekti (në rastin tonë, të gegërishtes)”. (Haxhi, 1993:76).

“A koma dhe sot, për të ruajtur veprat, titujt e privilegjet, krijesat e Institutit (totalitar) të studimeve të gjuhës dhe letërsisë bëjnë konferenca spektakolare, mbajnë kumtesa ‘Gjuha letrare - arritje kombëtare’, ku lakojnë parullën ‘një gjuhë - një komb’.” (Matraxhiu, 1994: 44).

10. “Kompetenca dhe toleranca e personaliteteve të shquara, do ta theksoj, shumica dërrmuese e të cilëve ishte nga Shqipëria e Veriut”. (Beci, 1992).

“Përpyekjet e autorëve gegë për mbrojtjen dhe lëvrimin e gjuhës amëtare, për ta ngritur atë në shkallën e një gjuhe letrare të përbashkët, nuk reshtën asnjëherë që nga Bogdani e deri te Komisia Letrare e Shkodrës.

Autorët shkodranë... dhanë shembullin e parë të një tolerance në dobi të afrimit të dy dialekteve bazë të shqipes”. (Deklaratë, 1992).

11. M. Çeliku (1992) i kundërvihet njëres prej tezave themelore të A. Kostallarit: “Ruga e formimit të gjuhës sonë letrare kombëtare nuk është aspak ‘sui generis’. Në bazë të saj është vënë varianti letrar tosk, kryesisht në sistemin fonetik e gramatikor”.

F. Altimari (1992), pasi e vlerëson Kongresin e Drejtshkrimit si kurorëzim të një procesi historik të gjatë dhe si ngjarjen më të rëndësishme në historinë kulturore të kombit, bën dy vërejtje kryesore: a. “Kalimi nga të dy ish variantet letrare dialektore në një gjuhë letrare të njësuar mbidialektore në të vërtetë nuk ishte dhe nuk është kryesor, si përkundrazi u pohua në të kaluarën akademike edhe nga disa që kishin interes ta mbulonin diellin me shoshë”. b. “... një normëzim i tepruar dhe i rreptë, që e tejkaloi ndoshta nevojën e një norme për t’u bërë shpesh diktat i padiskutueshëm”.

Sipas “Deklaratës” (1992): “Me marrjen e pushtetit nga komunistët, nën udhëheqjen e partisë, nis ‘politika gjuhësore’ e komunistëve shqiptarë, në bazën

e së cilës nuk qe aidheu, por ideologjia marksiste-leniniste. Këtu zunë fill të gjitha të këqijat". Ndërsa "Delikti i Kongresit të Drejtshkrimit qe ndalimi i plotë i gegërishtes letrare".

Fjalët e Deklaratës janë përsëritur në disa raste pikë për pikë nga D. Luka (1993). Sipas tij. "Është Kongresi i Drejtshkrimit ai që zbatoi një më një politikat gjuhësore të partisë dhe jo anasjelltas. Për këtë do të mjaftonin pohimet pa përjashtim të gjithë titullarëve të Institutit të Gjuhësisë, që përmblihen në thënieën tepër të qartë të A. Kostallarit, se 'Frymëzuesi dhe ideatori i Kongresit të Drejtshkrimit është sh. Enver Hoxha'." (f. 68).

Për A. Haxhin (1993): "Duhet të pranojmë se në këto vite u bë një revolucion në gjuhë, një përmbyse e madhe". (f. 74), prandaj edhe Kongresi i Drejtshkrimit u shndërrua në të kundërtën e vet: "Pse kaq ngut në organizimin e këtij kongresi? A nuk ishte i parakohshëm?" (f. 75).

Megjithatë, duke e njohur këtë deklaratë, gjuhëtari H. Olberg (1993) ndër të tjera ka shkruar: "Duke e ndjekur me vëmendje zhvillimin e gjuhës së njësuar gjatë tri dekadave, kam krijuar përshtypjen se gjuha e njësuar është akceptuar si normë... Më në fund dua të theksoj se një gjuhë letrare e njësuar kurrë nuk zhvillohet 'organikisht', por gjithmonë urdhërohet e caktohet nga sipër". (f. 23).

A. Vehbiu, pasi dënon politikën zyrtare: "L'intervento dello stato totalitario nei processi evolutivi della lingua è stato ovviamente parte integrante di un vasto programma culturale che mirava all'omogenizzazione, cioè all'eliminazione delle diversità...", nuk sheh të mundur një mdryshim të pasojave: "Il ghego letterario è ormai ridotto in un modello, un paradigma, e come tale non può essere inserito direttamente nel circuito della comunicazione culturale". (Vehbiu, 1992:167).

B. Beci (1992), duke mos gjetur ndonjë argumentim të vetin, u rikthehet kundërshtimeve të dikurshme më 1952 dhe kërkon një rivlerësim të Kongresit të Drejtshkrimit, Rezolutën e të cilit e ka nënshkruar, sepse: "... ishte përfundim logjik i politikës gjuhësore të ndjekur nga partia-shtet që më 1945 për të vendosur në bazë të gjuhës letrare kombëtare toskërishten letrare dhe për të mënjeluar gegërishten letrare". Mirëpo pikërisht në atë Kongres B. Beci pati mbajtur edhe një kumtesë, të cilën e ka nisur, duke i quajtur rregullat e drejtshkrimit: "... një etapë të re në luftën për stabilizimin dhe njësimin e normës drejtshkrimore të gjuhës letrare kombëtare.

"Rregullat e drejtshkrimit të shqipes" (projekt) kanë përvetësuar gjithshka pozitive që është krijuar në sajë të përpjekjeve të disa breza lëvruesish e studjuesish, në luftën për unifikimin e normës drejtshkrimore të shqipes, duke zhvilluar dhe çuar më tej traditën e shkrimit të gjuhës sonë".

Kurse e ka përfunduar kumtesën e vet B. Beci: "Në këtë mënyrë gjuha letrare shqipe do të funksionojë si një mjet edhe më i fuqishëm për zhvillimin e kombit tonë socialist". Rekomandimi më i mirë në këto raste është që rivlerësimi të fillojë nga vetvetja. Edhe unë kam mbajtur një kumtesë në atë Kongres, por nuk kam folur për kombin socialist.

*Kolegët tanë nga Kosova, që kanë marrë pjesë në Kongresin e Drejtshkrimin dhe të tjerë, u janë përmbajtur me bindje qëndrimeve të tyre. Merita e tyre e madhe për thirrjen e atij Kongresi, të cilën unë e kam vënë në dukje (Lloshi, 1991), bëhet dyfish më e madhe me qëndrimin e tyre të sotëm.*

12. "Konferenca 'Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot' u zhvillua me qëllim për të çimentuar politikën gjuhësore të vjetër dhe rezultatet e saj". (Quku, 1993).

13. "Tryeza e rumbullakët dënoi rreptësisht politikën gjuhësore komuniste dhe afirmoi politikën e re antikomuniste, sipas së cilës duhet rivlerësuar baza dialektore e gjuhës letrare kombëtare dhe duhen ndryshuar raportet midis dialekteve në favor të gegërishtes". (Politikë e re... 1993).

"Zotërinj trumbetierë të politikës së vjetër gjuhësore, ne nuk kërkojmë ta ndryshojmë bazën dialektore të gjuhës së njësuar, siç thoni me dashakeqësi në shkrimin tuaj. Ju sulmoni tryezën e rumbullakët të Tiranës (nëntor 1993), vetëm e vetëm sepse ato janë shprehje e përpjekjeve për të ndërtuar një politikë të re gjuhësore të shqipes". (Quku, 1993).

"David Luka nga Shkodra në fjalën e tij kritikoi qëndrimet e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në të kaluarën, qëndrime që rridhnin nga disponimi i tij politik, tha ai. Por këto qëndrime në Institut vazhdojnë edhe sot. Luka bëri edhe disa insinuata ndaj disa studiuesve të gjuhësisë dhe të letërsisë shqiptare". (Konsultë... 1993).

"Korrespondenti i 'Zërit të Popullit' e ka keqpërdorur në mënyrë të palejueshme diskutimin tim, nga i cili ka marrë disa pjesë të tekstit, të cilave u ka dhënë kuptime të tjera". (Raka, 1993).

"Ata të cilët kërkojnë rishqyrtimin e Kongresit të Drejtshkrimin bëjnë politikën neofashiste të Serbisë së sotme". (Manaj, 1993).

14. "Duket se opinionet radikale të A. Pipës nuk u pëlqejnë krerëve të sotëm të politikës shqiptare, pasi një afrim i tillë, veç të tjerave, do të dëshmonte për një 'kalim nga e djathta'." ("Koha jonë", 3 korrik 1994, f. 9).

15. "Shkodra has been the Albanian center of the Illyrian-Roman civilization... The center of gravity of the Albanian nation from Scanderbeg's time to the proclamation of independence is to be sought in Northern Albania". (Pipa, 1989:198,199).

“Nuk mund ta dij a do të ketë një evolim të dy dialekteve kah një synkrezë e ardhshme. Por kjo perspektivë e mundshme nuk do të më gëzonte fort”. (Pipa, 1994:35).

“Po të shkonim pas Pipës, shqiptarët tani do ta përdornin demokracinë për të zhdukur ‘kostallarizmin’ menjëherë dhe për të shkruar në gegërishten shkodrane. Tashmë e ka bërë për këtë një hap të parë një revistë kulturore e re me titullin ‘Albanica’.” (Hetzler, 1991).

16. “Problemi i qendror më duket të jetë gjuha standarde, gjuha zyrtare e administratës, e shkollës, shtypit, radios etj. Për këtë çështje parimi i Deklaratës kërkon në mënyrë të paqartë që të bëhet rishikimi, për t’u realizuar njësimi, për t’u bërë më i pranueshëm për të gjithë... Një ‘bashkëjetesë organike’ e të dy varianteve (gege e toske) në një të ardhme të largët është një iluzion, është e pamundshme”. (Olberg, 1993:22,23).

17. “Perhaps the most remarkable achievement will be the work of those scholars engaged in bringing the Albanian language to new and enviable heights, and through scientific work which excludes political interference, succeed in giving its unified form to be used by *all Albanians*, and suited to express man’s innermost thought and dreams in the most elaborate literary styles”. (Repishti, 1992:16).

18 “Askush nuk ka të drejtë të ndalojë që në të folurën ose në variantin shkodran të shkruhen poezi, të këndohen këngë, të bëhen filma, të jepen shfaqje teatrale. Kjo vlen njësoj si për Shkodrën, edhe për Dibrën, si për Gjirokastrën, edhe për Prishtinën. Ndërkaq GS do të vijojë t’i shërbejë kulturës kombëtare në tërësi”. (Lloshi, 1991:29).

“Njerëzit duhet të lihen të lirë të shkruajnë edhe gegërishten letrare, sidomos kur është fjala për vepra letrare, por edhe publicistike”. (Beci, 1992).

“Ne nuk jemi për ta prishur gjuhën e normëzuar ekzistuese, por për të grisur atë tabu që mbështille me qëllim çështjen e gjuhës së njësuar dhe vënien në diskutim të problemit të saj.

Gjithashtu kërkojmë që t’i krijohet hapësirë jetike gegërishtes letrare e kulturës që ajo përfaqëson”. (Quku, 1993). E vërteta është, se kur janë shkruar këto fjalë nga Quku nuk kishte asnjë lloj tabuje dhe asnjë pengesë për hapësirat e gegërishtes. Prandaj thënie të tilla pas vitit 1991 kanë prapa gjithnjë qëllime të tjera tinëzare.

“Rezistenca e gjuhës letrare do të varet edhe nga lëvrimi i saj dhe raportet që do të vendosë me letrarishten dialektore. Trysnia dhe rezistenca e secilës prej tyre do të kushtëzohen nga disa faktorë”. (Brokaj, 1994).

“Deklarata e gjuhëtarëve kërkon në mënyrë objektive dhe të matur njohjen e kësaj tradite të gegërishtes letrare. Përdorim i i gegërishtes letrare sipas parimit 2 të Deklaratës më duket se mund të realizohet pa vështirësi”. (Olberg, 1992).

19. “Gjuha duhet të ruhet kjo qi asht, të pasurohet sintaksa me forma të gegënishtes, qi asht neglizhuhet në bazë të një platforme thjesht politike...”

Në qoftë se do të integrohen në gjuhën letrare kombëtare elementet e rotacizmit dhe paskajores... atëherë besoj se nuk lind nevoja për me krijuje një letërsi në dialekt, gja qi do t'ngushtoj spektrin e lexuesve dhe do ta baj tepër lokale ket letërsi”. (Jashtë dyerve... 1992).

“Dal punto di vista linguistico il più grande vantaggio sembra essere la disponibilità delle strutture dell'albanese unificato ad accogliere elementi e strutture del ghego letterario e dialettale”. (Vehbiu, 1992:168).

20. “Kërkesa e disa njerëzve, që nuk janë ekspertë në fushën e gjuhësisë për të integruar në gjuhën letrare, që ka për bazë toskërishten, elementë ose kategori morfologjike të gegërishtes është jo vetëm e gabuar, por praktikisht edhe e pamundur”. (Agalliu, 1993).

## REFERIMET

- AGALLIU, F. (1993). *Një problem me rëndësi kombëtare: çështja e gjuhës letrare të njësuar*. “Balli i kombit”, 18.11.1993.
- ALTIMARI, F. (1992). *Gjuha letrare shqipe në dritën e zhvillimeve të reja politike dhe kulturore në botën shqiptare*. “Zëri i popullit”, 26.11.1992.
- BECI, B. (1991). *Plagët e monizmit janë të hapura edhe në shkencën shqiptare*. “Rilindja demokratike”, 7.9.1991.
- BECI, B. (1992). *Një pyetje për Akademinë tonë të Shkencave*. “Rilindja demokratike”, 8.4.1992.
- BECI, B. (1992). *Probleme të formimit të gjuhës së sotme letrare shqipe*. “Rilindja demokratike”, 8.12.1992.
- BYRON, J. (1976). *Selection among Alternatives in Language Standardization: The Case of Albanian*. Mouton, The Hague and Paris, 1976.
- CAMAJ, M. (1992). *Çështje të pazgjidhuna të shqipes. (Rreth librit të A. Pipës)*. “Besa”, 28.10.1991.
- ÇELIKU, M. (1992). *Gjuha e sotme letrare shqipe - arritje e rëndësishme kombëtare*. “Republika”, 24, 27.12. 1992.
- (1992). *Deklaratë e gjuhëtarëve të Shkodrës*. “Besa”, nr. 27 1992; “Shkodra”, 6.8.1992; “Libertas”, nr. 3, 1992.

- DEMIRAJ, SH. (1986). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1986.
- DODA, A. (1993). *Prokat e hekurta të Kongresit të drejtshkrim it*. "Lajmëtar", 17.7.1993.
- DOGO, M. (1992). *Kosovo - Albanesi e Serbi: le radici del conflitto*. Lungro, 1992.
- DOMI, M. - AJETI, I. (1992). *Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot*. "Zëri i popullit", 21, 22.11.1992.
- GOKAJ, N. (1993). *Rreth planifikimit gjuhësor të shqipes së sotme letrare*. "Rilindja", 23.1.1993.
- HAXHI, A. (1993). *Çështje të gjuhës letrare kombëtare shqipe*. "Hylli i dritës", nr. 2-3, 1993.
- HETZER, A. (1991). *Për librin e A. Pipës 'Politika gjuhësore në Shqipërinë Socialiste'*. Balkan Archiv, Neue Folge, Band 16, 1991; përkthyer shqip prej meje në "Shqip", nr. 26, tetor 1993.
- ISAKU, M. (1994). *Kam bërë të vetmin faj, pse i jam kushtuar letërsisë shqiptare*. "Koha jonë", 25.9.1994.
- ISMAJLI, R. (1992). *Mos u kthefshin më kurrë shtrëngesat*. "Drita", 10.5.1992.
- (1992). *Jashtë dyerve të një konference*. "Zëri i rinisë", 28.11.1992.
- KOSTALLARI, A. (1968). *Sur le traits principaux de l'albanais littéraire contemporain*. "Actes du Premier Congrès International des Etudes balkaniques et Sud-Est-Européennes", VI, Sofia, 1968.
- KOSTALLARI, A. (1970). *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*. "Studime filologjike", nr. 2, 1970.
- KOSTALLARI, A. (1970). *La langue littéraire albanaise dans la période de l'edification du socialisme*. "Studia Albanica", nr. 1, 1970.
- KOSTALLARI, A. (1972). *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrim it të saj*. "Kongresi i Drejtshkrim it të gjuhës shqipe", Tiranë, 1973.
- KOSTALLARI, A. (1982). *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*. "Studime filologjike", nr. 2, 1982.
- KOSTALLARI, A. (1984). *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*. "Studime filologjike", nr. 4, 1984.
- KADARE, I. (1994). *Fitorja më e madhe e vendit - përkujdesja ndaj gjuhës*. "Dita informacion", 17.2.1994.
- KELMENDI, R. (1992). *Gjuha shqipe dhe polemikat rreth saj në letrat shqipe*. "Zëri i popullit", 28.11.1992.
- (1992). *Konfirmim i vlerave të gjuhës letrare kombëtare*. "Zëri i popullit",

- 21.11.1992.
- (1993). *Konsultë për studimet e gjuhës shqipe*. "Zëri i popullit", 9.10.1993.
- LAFE, E. (1992). *Konferenca shkencore "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot"*. "Rilindja demokratike", 18.11.1992.
- LOGORECI, A. (1990). *Review of "The Politics of Language in Socialist Albania" by A. Pipa*. "Albanica", nr. 1, 1990.
- LUKA, D. (1993). *Përse ihtarët e Kongresit të Drejtshkrimnit nuk e pranojnë debatin shkencor?* "Hylli i dritës", nr. 2-3, 1993.
- LUKA, D. (1993). *E vërteta mbi Konferencën shkencore "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot"*. "Kumtari", nr. 6, 1993.
- LLOSHI, XH. (1984). *Modern Albanian in different cultural contexts*. "Studia Albanica", nr. 2, 1992.
- LLOSHI, XH. (1991). *Kultura shqiptare përpara shqetësimesh të reja*. "SOT", nr. 5-6, 1991; ribotuar në Prishtinë, "Bujku", 4,6,7,8,9.2.1992; ribotuar në "The Voice of Truth", vol 6, no 1, 1993.
- MANAJ, K. (1993). *Postscriptum mbi një konsultë të gjuhës shqipe*. "Bota shqiptare", nr. 2, dhjetor 1992.
- MATRAXHIU, B. (1994). *Njësimi i shqipes si vizion oruellian*. "Hylli i dritës", nr. 1-2, 1994.
- NEWMARK, L. - HUBBARD, PH. - PRIFTI, P. (1982). *Standard Albanian. A Reference Grammar for Students*. Stanford University Press, California, 1982.
- NIKA, M. (1992). *Pse i bien në qafë Presidentit?* "Finoku", nr. 13, dhjetor 1992.
- NUHIU, V. (1992). *Arshi Pipa: "Politika e gjuhës në Shqipërinë Socialiste" (vështrim)*. "Gjurmime Albanologjike", Seria e Shkencave Filologjike, 21, 1991, Prishtinë, 1992.
- OLBERG, H. (1993). *Disa mendime rreth "Gjuhës së njësuar"*. Quo vadis, Shqipëri?, Tiranë, 1993.
- PIPA, A. (1986). *Mbi t'ashtuqajturën "gjuhë të njësuar"*. "Koha e jonë", nr. 10, 11, 12, 1986.; "Kosova", nr. 5,6, qershor 1993, nr. 7, korrik 1993; "Mbas teje", nr. 2,3, 1994.
- PIPA, A. (1989). *The Politics of Language in Socialist Albania*. Columbia University Press, New York, 1989.
- PIPA, A. (1992). *Mbi "gjuhën e njësuar"*. *Stalini, Marri dhe kazani i shtrigave*. "Libertas", mars 1992.
- PIPA, A. (1992). *Géopolitique de la langue albanaise: la fraude de l'ULLA*. "Albanica", nr. 3-4, winter 1992.



- PIPA, A. (1992). *M. Dogo: Kosovo - Albanesi e Serbi: le radici del conflitto*. "Albanica", nr. 3-4, 1992.
- PIPA, A. (1993). *Përse nuk publikohet kjo letër? Letër për B. Becin*. "Zëri i rinisë", 12, 19.11.1993.
- PIPA, A. (1993). *Dy letra të prof. Arshi Pipës*. "Hylli i dritës", nr. 4, 1993.
- (1993). *Politikë e re në vend të politikës së vjetër*. "Shqip", nr. 26, 1993.
- PRIFTI, P. (1990). *A Commentary on Prof. Pipa's Critique of Unified Literary Albanian*. "The South Slav Journal, fall-winter 1990 (doli nga shtypi me vonesë në vjeshtë 1992); përkthyer shqip *Gjuha letrare është organizëm i gjallë*, "Arbëria", nr. 11, shtator 1993.
- QUKU, M. (1993). *Komunistët mbeten komunistë*. "Balli i kombit", 9.12.1993.
- RAKA, F. (1993). *Informacion jo i saktë i lexuesve të "Zërit të popullit" rreth konsultës për studimet e gjuhës shqipe*. "Rilindja demokratike", 16.10.1993.
- REPISHTI, S. (1992). *Albania in brief*. New York, 1992.
- RROKAJ, SH. (1993). *Kriza e gjuhësisë shqiptare dhe mendimi shkencor*. "Zëri i rinisë", 17.12.1993.
- RROKAJ, SH. (1994). *Gjuhë letrare e unifikuar apo shqipe standard?* "Dardania", nr. 43, prill 1994.
- TERNAKU, T. (1992). *Pas leximit të një studimi të profesor Arshi Pipës*. "Mbas teje", nr. 9, 1992.
- TOPALLI, P. (1993). *Rreth konsultës për studimin e gjuhës shqipe*. "Lajmëtari", 28.10.1993.
- VEHBIU, A. (1992). *Albanese standard: peccato originale e redenzione*. "Katundi ynë", nr. 81, 1992/3, ribotuar në "Albanica", nr. 3-4, winter 1992.
- VINCA, A. (1992). *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe konteksti socio-kulturor shqiptar*. "Zëri i popullit", 22.11.1992.
- ZEQO, M. (1993). *Gjuha e njësuar letrare - emblemë e njësisë së kombit*. "Kombi", 23.3.1993.

*Mbajtur si kumtesë në konferencën shkencore "Gjuha dhe politika: - gjuhët e Ballkanit në të kaluarën dhe sot". Tutzing, 10-14 tetor 1994.*

*Botuar anglisht (pa shënimet) me titullin "Albanian: The Rise of a Language to a National Standard" në: Sprache und Politik: Die Balkansprachen in Vergangenheit und Gegenwart. Herausgegeben von H. Schaller. Südosteuropa-Jahrbuch 27. Südosteuropa-Gesellschaft, München 1996, f. 309-322.*

## SHQIPJA E SOTME NË KONTEKSTE TË NDRYSHME KULTURORE

Termi *gjuha e sotme shqipe* nënkupton një periodizim të etapave në evoluimin e saj. Studiuesit shqiptarë e kanë bërë periodizimin duke u nisur nga kritere historike dhe për periudhat e fundit ka shërbyer si kufi edhe shfaqja e shkrimeve të para.(1). Ndërkaq, po të merret shqipja në tërësi, do të vëmë re se vetë emërtimet kanë një domethënie për historinë e saj. Siç dihet, deri në shekullin XVII kjo gjuhë quhet *arbëneshe-arbëreshe*, ashtu si bartësit e saj *arbër-arbën (arbëneshtë-arbëreshë)* (2), prej nga i kanë marrë emërtimet që përdorin deri më sot gjuhët e huaja. Por që nga ai shekull vendësit e quajnë gjuhën e tyre *shqipe* dhe veten e tyre *shqiptarë*.(3). Ky ndryshim ka një paralele semantike mjaft të afërt me emërtimin *Deutsche* për gjermanishten dhe gjermanët. Në rast se periudhën e fundit do ta quajmë shqipen e re dhe arbërishten shqipen e mesme, atëherë do të kishim një periodizim të tillë:

1. Gjuha shqipe e vjetër - deri në shek. VIII-IX të erës së re.
2. Gjuha shqipe e mesme ose arbërishtja - deri në shek. XVII.
3. Gjuha shqipe e re ose shqipja - nga shek. XVIII deri në ditët tona.

Me gjithë mungesën e dokumenteve të shkruara, me punën e një vargu gjuhëtarësh, ndër ta mjaft albanologë të njohur, po sidomos me studimet e shumanshme të prof. E. Çabej (4), tani kemi një përfytyrim të përafërt për *shqipen e vjetër*. Na duket me interes

të theksojmë dy-tri çështje. Në këtë pjesë perëndimore të Ballkanit deri në shekujt e parë të erës së re shtriheshin ato dialekte të ilirishtes, të cilat mund të identifikohen me shqipen e vjetër. Kjo gjuhë ka reaguar me një sistem fonomorfologjik mjaft të ngulitur kundrejt kontakteve me greqishten e vjetër e latinishten dhe njëkohësisht në mënyrë mjaft të diferencuar. Huazimet nga greqishtja e vjetër janë të pakëta, ndërsa huazimet latine janë në një numër të madh. Shpjegimi është te sundimi i gjatë romak, vendosja e një administrate të fortë politike e ushtarake, e kampeve ushtarake (castra), e veteranëve, e kolonistëve, hapja e rrugëve në thellësi etj. Nga pikëpamja gjuhësore kjo do të thotë se, përveç presionit të gjuhës zyrtare, të kulturës e më vonë edhe të kishës, ishin kushtet edhe për një bilinguizëm të përhapur me latinishten vulgare, gjë që nuk mund të thuhet për greqishten e vjetër po në këtë shkallë, aq më tepër kur njihet edhe trajtimi nga grekët e vjetër i të huajve si “barbarë”. Rezultati kryesor i kësaj periudhe është përcaktimi i *arealit të gjuhës së vjetër shqipe*, e cila pësoi mjaft ndryshime, por nuk u romanizua. Nga ana tjetër, në rast se lidhur me periudhën parahistorike flasim për shqipen si një gjuhë indoeuropiane, shqipja e vjetër mund të quhet tashmë edhe një gjuhë ballkanike.

*Arbërishtja ose shqipja e mesme* në etapën e parë të saj - deri në shek. X lidhet me problemin e etnogjenezës së popullit shqiptar. Nga ana gjuhësore vlejné të përmenden disa rrethana e faktorë historike. Në radhë të parë, tani mund të shtrohet problemi i dialekteve. Mjafton për këtë të përmendet një tipar i rëndësishëm, siç është rotacizmi. Është vënë në dukje prej kohësh që huazimet sllave, italiane e greke të reja në përgjithësi nuk marrin pjesë në këtë ndërrim, gjë që do të thotë se të folmet, të cilat i quajmë sot toskërishte, tashmë veçohen në një sistem fonologjik dialektor me vlerë për kundërvëniet e brendshme. Në kontaktet e jashtme ka gjithashtu ndryshime me rëndësi, që lidhen me një fakt të

përgjithshëm: gjuha shqipe për shumë shekuj është në kontakt jo vetëm me disa gjuhë të ndryshme, por edhe me fazat e ndryshme historike të disa gjuhëve e me evolucionin e tyre. Kështu, latinishtja u ruajt si gjuhë e administratës deri në shek VII dhe më pas u zëvendësua nga greqishtja (ndonëse janë përdorur edhe krahas në një vijë të përafërt Durrës - Shkup). Por në komunikimin e përditshëm dhe aq më tepër në kushte bilinguizmi, nuk mund të flitet më për latinishte. Klasa e vjetër skllavopronare latine italike ose vendëse e romanizuar u likuidua dhe procesi i romanizimit u ndërpre. Tashmë do të flitet për marrëdhëniet e shqipes me italishten e më saktë, në këtë periudhë sidomos me dialektin venecian.

Po në këtë shekull të shtatë, ndonëse areali i gjuhës shqipe kishte dy shekuj që ishte përfshirë në kontekstin e Perandorisë Bizantine, mund të thuhet se kontakti është me greqishten e mesme. Situata është mjaft e ndryshme nga ajo për greqishten e vjetër, pasi tashti ka mbështetjen e pushtetit politik, administrativ e ushtarak, e gjithashtu të depërtimit kulturor e në jetën materiale. Baza ideologjike e kësaj perandorie ishte feja ortodokse. Por terminologjia kishtare më e vjetër dhe më e përgjithshme e shqipes është me prejardhje nga latinishtja, kështu që depërton një shtresë më e re dhe më e kufizuar. Në këto rrethana zë fill edhe bilinguizmi në jug të arealit të shqipes, i mbështetur më vonë sidomos nga tregtia.

Një faktor i ri e bën veten plotësisht të pranishëm po në këtë kohë. Me valë të ndryshme dhe me formacione shtetërore karakteristike për mesjetën e hershme depërtojnë në arealin e shqipes sllavët. Nuk është detyra jonë të merremi me aspektin e historisë politike edhe për këtë rast, por vetëm të shënojmë rezultatin gjuhësor. Lindi një bilinguizëm shqip-sllavisht në nivelin e gjuhës së komunikimit të përditshëm, që dëshmohet me huazimet sllave të shqipes dhe me toponimet sllave në arealin e shqipes. Po ndërkaq

këto toponime bashkëjetojnë me makro- e mikrotoponime vendëse, në disa raste janë përkthime sllavisht të emërtimeve të dikurshme shqip, ndërsa emrat antikë të disa qyteteve, maleve e lumenjve kanë kaluar në gjuhët sllave pikërisht në trajtën që i ka sjellë evolucioni fonetik i gjuhës shqipe. Arsyeya e asimilimit të këtyre masave fshatare sllave, të cilat jetonin në bashkësi jo shumë të ndryshme nga bashkësitë fshatare ilire, është, siç e kanë argumentuar historianët, se popullsia e dyndur nuk arriti në këtë etapë të krijonte një kulturë tërësore më vete, por përkundrazi, gjeti një popullsi vendëse të lashtë, trashëguese të një kulture provinciale, që kishte mbijetuar edhe pas ndikimit të fortë greko-romak e që kishte edhe një qytetërim urbanistik të zhvilluar. Nga pikëpamja e rezultatit përfundimtar të bilinguizmit, ky proces asimilimi dëshmon për një popullsi konsistente folëse të arbërishtes dhe që çoi në shpërnguljen e bilinguizmit në periferinë e arealit të vet, duke i dhënë fund brenda disa shekujve simbiozës së brendshme. Por nga ana tjetër, përveç huazimeve, ashtu si në rastet e tjera të mëparshme, ky proces sidoqoftë çoi pjesërisht edhe në një ngushtim gjeografik të arbërishtes.

Që në shekullin XI emri *Arbëri* u shtri gradualisht për të gjithë arealin e shqipes. Burimet historike greke, perëndimore dhe sllave dëshmojnë njësinë e kësaj treve, pavarësisht se këto ishin dialekte e krahina të ndryshme etnografike, sipas komplikimeve historike bënë pjesë në formacione politike, madje edhe në komunitete fetare të ndryshme. Siç e ka theksuar edhe prof. Aleks Buda, edhe në ndërgjegjen e popujve të huaj, që ranë në kontakt me arbëreshët, u pasqyrua kështu pa ndonjë hezitim njësia e gjuhës në këtë trevë, si shprehje e njësisë etnike, e bashkësisë së kulturës materiale dhe e ideologjisë, të mishëruara në kulturën shpirtërore të masave popullore. Është pikërisht në këtë kohë, që me lëkundjen e Perandorisë Bizantine, ku dhanë kontribut edhe kryengritjet e

arbëreshëve. del si forcë politike klasa feudale arbëreshe dhe krijohen principatat e Arbërit.

Nga pikëpamja gjuhësore ka rëndësi të përmenden këto fakte. Gjuhët sllave kishin tashmë edhe shkrimin e tyre. Nëse veprimtaria e Naumit dhe e Klementit të Ohrit nuk pati sukses për përhapjen e gjuhës kishtare sllave si gjuhë shkrimi në arealin Lindor e Juglindor të arbërishtes, dy shekuj më vonë kemi një kancelari serbisht në Shkodër. Po nga shek. XII vërehet një ripërhapje e kulturës latine kishtare, ndërsa kultura greke bizantine pëson një lëkundje edhe në Shqipërinë e Mesme e deri në Vlorë dhe bashkë me të vetë greqishtja. Kështu, në rrafshin e gjuhës së shkruar vërehet një plurilinguizëm. Prof. E. Çabej shkruan: "Aristokracia e vendit nuk përdornin gjuhën amtare në korrespondencë, po këtë e mbanin sipas krahinave e rrethanave latinisht, greqisht e sllavisht; ndërkaq popullsia flisnin gjuhën e vendit si dhe sot". (5).

Pikërisht në këto rrethana të formacioneve shtetërore feudale ku edhe popullsia, edhe klasa drejtuese ishin vendëse, *lindi kërkesa historike edhe për shkrimin e gjuhës shqipe*. Është e kuptueshme që këto ishin në fillim shkrime të lidhura me nevojat ekonomike, tregtare, administrative e fetare, që plotësoheshin nga klerikë të ulët, pasi shkruesit, noterët, leteratët në përgjithësi ishin klerikë. Në Raguzë, p.sh., në shek. XIV kleri në një pjesë të mirë ishte me origjinë shqiptare.(6). Siç e kërkonte gjithë tradita europiane, edhe feudalët arbëreshë kanë pasur kronika e gjenealogji të vetat dhe kujtesën për to do ta lexojmë edhe një-dy shekuj më pas. Nga ana tjetër, edhe shkruesit e dokumenteve në gjuhët e tjera detyrohen gjithnjë e më tepër të transkribojnë emrat e shqiptarëve e të viseve shqiptare sa më afër shqiptimit origjinal, të arbërishtes.

Një ngjarje me rëndësi, që e vëmë re në këtë periudhë, është fillimi i shtegtimeve masive të arbëreshëve jashtë arealit të tyre. Vala e parë i përket shekullit XIV, e lidhur me shfrytëzimin e rëndë,

me masat ndëshkimore e me rrethana të tjera historike.(7). Ajo u drejtua në Jug, nga Thesalia arriti deri në Atikë e Peloponcz. Që nga kjo kohë mund të flitet për *diasporën shqiptare*, pra edhe për gjuhën shqipe të diasporës, për probleme të reja në kontekste kulturore tepër të ndryshme.

Etapa e fundit e arbërishtes (shek. XV-XVII), në të cilën u zhvilluan ato procese që çuan në shqipen e re, është njëkohësisht edhe një etapë ngjarjesh të mëdha historike e kulturore.

Pas luftës njëzetvjeçare të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, pothuaj njëqind vjet pas betejës së Kosovës, më në fund sulltanët mundën ta pushtojnë përfundimisht këtë pjesë të Ballkanit. Për të tretën herë këto vise u përfshinë në kuadrin e një perandorie universale, duke pësuar pasojat që ato sjellin me vete. Megjithatë kushtet historike shoqërore këtë radhë ishin mjaft të ndryshme. Në aspektin që na intereson, dëshirojmë të vëmë në dukje se bashkë me garnizonet dhe administratën osmane vinte një kulturë tërësisht e huaj, e mbështetur në një fe tjetër dhe e shprehur në një gjuhë që nuk ishte as indoeuropiane. Siç e ka vënë në dukje prof. E. Çabej, ndryshe nga pushtimi romak, sundimi i Perandorisë Bizantine e Osmane nuk u shoqërua me kolonizimin e vendeve të pushtuara. Madje, do të shtonim, se tani u krijuan kushtet për një *lëvizje të madhe të popullsisë vendëse*. Siç dihet, Skënderbeu i bashkoi të gjithë shqiptarët në luftën për liri, duke lëvizur me ushtritë e tij në të gjitha krahinat. Ndonëse kjo qe një periudhë e shkurtër, ajo luajti një rol të madh historik për gjithë shekujt e mëvonshëm, duke u bërë bazë e vetëdijes për unitetin kombëtar. Për t'u shpëtuar raprezaljeve masive osmane, një pjesë e popullsisë u shpërngul edhe në Itali, me këtë diaspora e shqipes bëri një zgjerim të ndjeshëm. Shpërnguljet vijuan edhe për në Greqi. Vetë Perandoria Osmane tërhiqte sidomos ushtarë. Për shkak të dëmtimit të ekonomisë bujqësore të vendit, u përhap fenomeni i argatëve stinorë,

që shkonin deri në Trakë e Anadoll, si dhe i zanatçinje shtegtues.(8). U ndalëm në këtë pikë, pasi me të lidhen ndër të tjera edhe dy probleme gjuhësore.

E para, në këtë lëvizje ka rëndësi të dallohet *areali i gjuhës shqipe dhe diaspora e saj*. Nuk ka të dhëna historike-gjuhësore për zgjerimin e arealit. Kështu p.sh., teza se në trojet VL të Rrafshit të Dukagjinit e të Fushës së Kosovës, përpara fundit të shek. XVII shqipja nuk ishte e pranishme, niset nga një traditë gojore e regjistruar tani vonë.(9). Studimet e bëra nga historiani Selami Pulaha (10), duke u mbështetur gjerësisht në onomastikë, kanë provuar madje se aparati shtetëror osman, institucionet fetare dhe baza ekonomike feudale e mirieve u bënë pengesë për sllavizimin e mëtejshëm në këtë zonë, ku vërtet popullsia sllave ishte në pakicë, por ajo kishte në dorë institucionet shtetërore e fetare sunduese dhe mbështetej edhe në një bashkësi, ndonëse të pjesshme, fetare e kulturore me shqiptarët. Edhe në disa studime gjuhësore të albanologëve të sotëm, duke e ngatërruar arealin me diasporën, pra lëvizjen e brendshme të popullsisë shqiptare me shpërnguljet e saj, mbetet nga ana epistemologjike mendimi për një zgjerim të arealit të shqipes. Që të mbështetej ky mendim, do të duhej të pranohej se në shek. XV-XVII ka pasur një bum demografik shqiptar, diçka që historikisht nuk ka asnjë forcë bindëse.

E dyta, këto lëvizje janë një nga arsyet që dallimet dialektore të gjuhës shqipe të kësaj kohe janë më të pakëta, se në periudhën e mëpasme.

Duke munguar kolonizimi osman, ndikimi kulturor e gjuhësor ishte në fillim i fortë në qytete e prej andej u përhap në fshat, kështu që nuk u zhvillua një bilinguizëm i nivelit të komunikimit të përditshëm.(11). Ky është një nga faktorët, që shpjegon praninë e një sasive të madhe huazimesh të njëjta orientale në gjuhët e ndryshme të Ballkanit, ndërsa ndryshimet ndërmjet tyre lidhen



sidomos me shkallën e islamizimit. Me këtë lidhet, me sa duket edhe prania e shumë huazimeve arabe e perse. të marra nëpërmjet turqishtes, pasi ato dilnin në plan të parë në vetë osmanishten fetare, administrative, gjyqësore etj. Vetë islamizmi në fillim u përhap në shtresat e larta të popullsisë, në shek. XVI përfshinte vetëm 10 % të popullsisë (në shek. XVII kapërceu mbi 50 %). Është interesante të shënohet, se me islamizmin u bënë tri fe të pranishme, bashkë me luftën ndërmjet tyre. Në leksikun e shqipes kjo mund të ndiqet si kuriozitet. P. sh. për *parajsë*, që është sot termi standard në gjuhën letrare, kemi edhe *parriz*, *paradhis*, *xhenet* ( e para e traditës katolike, e dyta ortodokse dhe e treta myslimane). Po kështu ka qenë gjendja me emrat e personave, p.sh., ndeshen *Pjetër*, *Petro* bashkë me shqipen *Guri*, madje për shkak të sinkretizmit fetar kishte krahina ku përdorej një emër në familje dhe një emër tjetër mysliman për marrëdhëniet publike.

Cili ishte reagimi i gjuhës shqipe kundrejt kësaj gjendjeje të re, të krijuar mjaft shpejt e me dhunë? Pa dyshim, hyri një numër i madh huazimesh orientale. Por ka rëndësi të vëmë në dukje se tashmë në këtë reagim *do të merrte pjesë edhe kultura reflekse*. Të gjithë autorët e asaj që quhet letërsia e vjetër shqiptare flasin qartë për nevojën që të ruhet gjuha shqipe dhe me veprën e tyre i shërbyen këtij qëllimi. Rezultati i këtyre proceseve komplekse ishte se përsëri gjuha shqipe e ruajti rolin e saj si gjuhë themelore e kësaj popullsie, madje u bë më e mprehtë nevoja për përpunimin e saj në trajtën e shkruar, që gjuha nga ana e vet të ishte mjet për ruajtjen e kulturës. Vetëdijes për njësinë kombëtare, që u ngrit në një shkallë më tej për shkak të ndeshjes në gjithë vijën - politike, shoqërore, ekonomike, fetare, kulturore etj. me një botë tjetër të huaj, iu përgjigj edhe një vetëdije e re gjuhësore më përgjithësuese e atyre njerëzve që, përballë të huajve, dalloheshin si bashkësi e atyre që kuptoheshin qartë ndërmjet tyre, që merreshin vesh *shqip*.

Në periudhën e *shqipes së re* në këtë mënyrë nuk shtrohen më probleme për të si sistem gjuhësor në tërësi, madje edhe çështja e huazimeve bëhet gjithnjë e më tepër aspekt i orientimeve kulturore. Problem qendror del përpunimi i një gjuhe letrare të shkruar dhe në varësi të tij përcaktohet edhe evoluimi i përgjithshëm.

Sidomos me punimet e A. Kostallarit ne kemi sot një njohje më të mirë të procesit që lidhet me zhvillimin e gjuhës letrare shqipe në periudhën parakombëtare e kombëtare e në veçanti të kristalizimit të gjuhës letrare, që u arrit në vitet pas Çlirimit. Duke bërë një përpjekje për të mos përsëritur prof. A. Kostallarin, do të prekim ato anë që lidhen me temën tonë dhe, brenda mundësive, do të ruajmë vijën e trajtimit të deritanishëm.

Me termin *diaspora* zakonisht janë quajtur të gjitha ngulimet shqiptare, që nuk lidhen drejtpërdrejt me arealin e shqipes. Na duket megjithatë se këtu ka nevojë për një dallim historik. Duke filluar nga shek. XVIII shqiptarët vendosen në vende të huaja, duke qenë tashmë *bartës të shqipes së re*. Sidomos nga mesi i shek. XIX arsyeja themelore është emigrimi ekonomik, i cili u ndërpre nga Shqipëria 40 vjet më parë, por ka vijuar nga një pjesë e arealit të saj. Është përdorur për këtë rastin e fundit termi *kolonitë shqiptare* dhe ne mund ta pranojmë një diferencim termash ndërmjet diasporës dhe kolonive, duke arritur kështu te dallimet: shqipja e arealit, shqipja e diasporës dhe shqipja e kolonive.

Për dialektet e shqipes së re është vënë në dukje se dallimet kanë ecur përpara, por me këtë ndryshim, se toskërishtja në këtë periudhë është treguar më konservative, ndërsa të folmet e gegërishtes kanë evoluuar më shumë. Krahas kësaj kanë marrë rëndësi gjithnjë e më të madhe format e gjuhës së folur për marrëdhëniet publike, që janë ngritur deri në nivelin e koineve, sidomos lidhur me zhvillimin e jetës së qyteteve që nga shek. XVII, pa përjashtuar edhe rolin e folklorit, në veçanti të epikës për të

folurit e fshatrave. Lidhur me këtë shënojmë se në fund të shek. XVII kemi dëshminë se gjuha e Shkodrës është më e lëvruar, në fillim të shek. XIX lidhur me pashallëkun e Janinës të Ali Pashë Tepelenës quhet më e përgjithësuar e folmja e Janinës, ndërsa deri në mesin e shek. XX ka ekzistuar bindja se e folmja e Elbasanit ishte mbështetja më e përshtatshme për një gjuhë kombëtare.

Gjuha e shkruar në shek. XVIII nuk është një vazhdim i pandërprerë i traditës së mëparshme. Përkundrazi, ajo i ripropozon të gjitha problemet që lidhen me të. Përdoren alfabeti latin, grek, sllav, arab, krijohen alfabete origjinale e hibride e vetëm më 1908 arrihet tek alfabeti i sotëm. Për drejtshkrimin dhe normën letrare gramatikore e leksikore është vendimtare marrëdhënia e gjuhës së shkruar me koinetë mbi bazë dialektore. Megjithëse u formuan dy variante letrare kryesore dhe vendosja e një gjuhe standard u takon dhjetëvjeçarëve të fundit, kjo nuk e ka penguar shqipen e shkruar të bëjë një luftë të gjatë për të fituar ato fusha, të cilat e bëjnë një mjet polifunksional, të aftë për të qenë shprehëse e kulturës shqiptare në tërësi. Kushtet vijuan të ishin të pafavorshme deri më 1912: gjuha shqipe nuk lejohej në veprimtarinë shtetërore, madje në shek. XIX ajo u përndoq zyrtarisht dhe u mallkua nga reaksioni fetar. Kjo është arsyeja përse në programin e lëvizjes së Rilindjes Kombëtare problemi gjuhësor ishte qendror dhe i pandarë nga lufta për pavarësi. Futja e shqipes në shërbesat fetare është parë si një hap për identitetin kulturor kombëtar. Kjo fushë kishte traditë dhe në shek. XIX u përkthye u e botua Bibla: më 1824 nga Vangjel Meksi, më 1866 nga K. Kristoforidhi dhe më 1908 nga Fan Noli. Përkthimi i Meksit i ka shërbyer si tekst bazë J. Xylander-it, Franz Bopp-it e J. G. von Hahn-it - po të përmendim vetëm disa emra, ndërsa te Kristoforidhi e Noli përkthimi arrin vlerat e një proze letrare.

Në veprimtarinë ekonomike e tregtare që në shek. XVIII krahas italishtes, greqishtes e turqishtes nis përdorimi i shqipes. (Gjatë

pushtimit osman shkoi duke rënë deri sa u mënjanua krejt përdorimi i ndonjë varianti të gjuhëve sllave jugore). Lidhja Shqiptare e Prizrenit paraqiti kërkesa të përcaktuara në programet e veta(13) për gjuhën e administratës e të gjyqeve. Në gjysmën e dytë të shek. XIX u botuan gazetat shqipe në kolonitë shqiptare dhe që nga viti 1879 edhe në Shqipëri. Gjuha e publicistikës njohu edhe vepra me forcë shprehëse, si të Sami Frashërit. Po në këtë kohë bëhen përpjekjet për gjuhën e shkencës, kryesisht lidhur me shkollën në gjuhën shqipe e me filologjinë, që e interesonin në radhë të parë lëvizjen kombëtare. Por sidomos lindi dhe u zhvillua një letërsi artistike me një varg veprash të shquara, të cilat edhe sot i ruajnë vlerat si modele të një gjuhe të përpunuar në aspektin e funksionit poetik-stilistik.

Shpallja e Pavarësisë më 1912 e gjeti kështu gjuhën shqipe të përgatitur për funksionet që duhej të merrte në shtetin shqiptar. Është interesante të vëmë në dukje se me mënjanimin e administratës osmane, nuk mbeti ndonjë shtresë popullsie bilingue shqip-turqisht në nivelin e komunikimit të përditshëm. Përpjekje për një variant stilistik, në të cilin orientalizmat të kishin kundrejt shqipes po atë rol poetik si sllavizmat kishtarë në rusishten, latinizmat në italishten etj., në etapat e konsolidimit të tyre, u bënë nga rryma që është quajtur e bejtexhinjve në shek. XVIII-XIX. Kësaj rryme iu kundërvu me sukses letërsia e Rilindjes Kombëtare, e cila nguliti një konceptim tjetër estetik. Njëkohësisht pati edhe një rrymë të fortë purizmi kundrejt orientalizmave. Mbeti vetëm ndonjë shtresë e orientalizuar shumë, siç është ndonjë enklavë në Prizren. Nevoja për një bilinguizëm në nivelin e komunikimit të përditshëm u zhduk. Nga ana tjetër turqishtja, greqishtja e pjesërisht italishtja e sllavishtja jo vetëm nuk ishin më gjuha e shkollës dhe kaluan në statusin e gjuhës së huaj, por edhe ndryshoi orientimi kulturor kundrejt gjuhëve të huaja, duke bërë të mundur që *marrëdhëniet kulturore*

*të jenë të drejtpërdrejta edhe me kulturën europiane. Pasojë gjuhësore e kësaj ishte një shtim i huazimeve nga italishtja e frëngjishtja e sotme, madje edhe nga anglishtja. por më tepër se huazimet e veçanta bie në sy përpunimi i stileve funksionale, i gjuhës së publicistikës, të shkencës e të veprimtarisë shtetërore, administrative, gjyqësore, diplomatike e tregtare, duke iu afruar *modeleve të gjuhëve të tjera europiane.**

Pikërisht kur u krijuan kushtet për zhvillimin e shqipes në kuadrin e një shteti kombëtar, areali i kësaj gjuhe u copëtua dhe pjesë të caktuara u ndodhën në situata të tjera, të ndara me kufij politikë nga Shqipëria e cunguar.

Pas vitit 1944 u krijuan rrethana historike-shoqërore krejt të reja edhe për gjuhën shqipe. Në radhë të parë, asaj i doli përballë detyra të përpunonte një sistem të tërë leksiko-semantik për të shprehur nocionet e dukuritë që lidheshin me sistemin e ri politik, me mënyrën e jetesës dhe me kulturën socialiste. Në Kongresin e kaluar të Shoqatës, pesë vjet më parë ne kemi pasur rastin të japim një paraqitje të këtyre proceseve lidhur me zhvillimin e leksikut politik-shoqëror pas Çlirimit. Aspekti tjetër themelor ishte kujdesi i vetëdijshëm i shoqërisë për arritjen e njësimit të gjuhës letrare kombëtare. Kjo u bë në kushte shumë të favorshme, kur u zhduk analfabetizmi, u shtri arsimi në gjithë popullsinë, u ngritën shkolla të larta, u krijua një shkencë shqiptare duke përfshirë edhe gjuhësinë, që lejoi zbatimin e një politike gjuhësore mbi baza shkencore, u zgjerua pa krahasim rrjeti i mjeteve të komunikimit masiv etj. Jo vetëm u forcua baza kombëtare e gjuhës, por ajo u bë objekt kujdesi i gjithë shoqërisë.

Sot ne kemi një gjuhë shqipe letrare, që është gjuha e një kombi, e një shteti dhe e një kulture kombëtare. Ajo është forma më e lartë e ekzistencës së kësaj gjuhe historikisht dhe në kohën e sotme. Ajo i ka përpunuar dhe po i zhvillon më tej funksionet e saj, duke qenë

në korrelacion me shoqërinë së cilës i shërben, me veprimtarinë politike, ekonomike, intelektuale e kulturore që ajo zhvillon. Karakteristikë e saj është lidhja e ngushtë me gjuhën e gjallë të folur, lidhje e cila ishte në qendër të vëmendjes edhe në Kongresin e Drejtshkrimit, 1972. Nga ana tjetër, kjo nënkupton edhe një specializim të gjuhës për nevojat funksionale, gjë që do të thotë se tashmë kemi edhe fenomenin e diglosisë, në kuptimin e përdorimit të regjistrave të ndryshëm shoqërorë-stilistikë nga po ai njeri. Duke mos pasur zbrazëti në sistemin e vet funksional, gjuha e sotme shqipe krijon mundësitë për një kontakt të gjerë me gjithë kulturën tjetër botërore, madje e lehtëson edhe përvetësimin e gjuhëve të huaja në shkollë. Pikërisht këto rrethana kanë bërë që gjendja e gjuhës shqipe jashtë kufijve të Shqipërisë nuk mund të kuptohet më jashtë marrëdhënieve me gjuhën letrare kombëtare dhe ndikimit të fortë të saj. Ky ndikim, ndër të tjera, përforcohet edhe me rolin specifik të veprave kodifikuese, si drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori i gjuhës së sotme shqipe, të cilat sigurojnë njësinë e gjuhës në shkollë, në botimet, në mjetet e komunikimit masiv dhe në veprimtaritë gojore publike.

Për ta thjeshtësuar paraqitjen, mund të bëjmë këtu një skematizim të përgjithshëm.

Gjuha shqipe ka:

- *tri faza të mëdha historike*: shqipja e vjetër, shqipja e mesme dhe shqipja e re;
- *shtrirjen e saj*: në arealin, në diasporën dhe në kolonitë;
- *variantet e saj*: krahinore
  - të shkruar dhe të folur
  - letrare
  - sipas shkallës së normativizimit funksionale;
- *situatat e përdorimit*: monolingvizëm, diglosi, bilingvizëm ose plurilingvizëm.

Në Kosovë, Malin e Zi e Maqedoni shtrihet një pjesë e arealit të shqipes. Këtu zhvillimi gjuhësor ka ecur nëpër ato faza historike që përshkruam më lart. Vetëm në shekullin tonë kjo pjesë u gjend në rrethana të ndryshme shtetërore e kulturore. Siç e ka vënë në dukje prof. Idriz Ajeti(14), pas viteve 1912-1918 mungonin kushtet për zhvillimin e kulturës më elementare në gjuhën shqipe dhe u ndërpre pjesëmarrja në konvergjencën e përgjithshme gjuhësore. Gjatë viteve të Luftës II Botërore shqipja u fut në shkollat fillore e të mesme, duke u përdorur varianti letrar verior i mesëm, i cili vazhdoi të mbahej edhe më pas, duke u zbatuar edhe në gjuhën e administratës. Pas vitit 1968 gjuha e sotme letrare u shtri në të gjitha shkollat, në botimet, në mjetet e komunikimit masiv, në administratë dhe në letërsinë artistike. Pozitat e shqipes si gjuha themelore e kësaj popullsie në këtë mënyrë u përforcuan me mbështetjen e gjuhës së shkruar. Pasojat kulturore të kësaj janë të dyfishta. Nga njëra anë, u mënjanua rreziku që kultura e trashëguar të kthehej në një kulturë krahinore të paaftë për zhvillimin bashkëkohor. Kjo me kohë do ta çonte atë në pozitat e inferioritetit, që do të reflektoheshin në vlerësime për vetë gjuhën. Tani ajo është në nivelin e kulturës kombëtare shqiptare dhe ka shkollat, institucionet e larta arsimore e shkencore, botimet, mjetet e komunikimit masiv, letërsinë, teatrin etj. në gjuhën letrare kombëtare, që u hap të gjitha mundësitë me pasuritë dhe me sistemin e saj funksional, stilistik e shprehës.

Nga ana tjetër, gjuha letrare jep mundësinë edhe për të marrë kulturën bashkëkohore, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar një gjuhe të huaj të ndërmjetme. Nuk do të ishte e tepërt të përmendim këtu rolin që kanë luajtur shkrimtarët, arsimtarët, historianët dhe vetë gjuhëtarët kosovarë për këtë drejtim të zhvillimit gjuhësor, duke qenë të vetëdijshëm se një popull i tërë mund të kulturohet vetëm në gjuhën amëtare, përndryshe do të lindnin probleme të pakapërcyeshme socio-psikologjike.

Përvetësimi i gjuhës letrare kombëtare dhe kushtet e tjera e kanë ndryshuar edhe karakterin e bilinguizmit të shqiptarëve në Jugosllavi. Serbokroatishtja si gjuhë e dytë tani përhapet kryesisht nëpërmjet veprimtarisë shtetërore, shkollës e mjeteve të komunikimit masiv. Kjo e ka zvogëluar rolin e varianteve krahinore të saj si gjuhë e folur në komunikimin e përditshëm, duke ulur edhe prestigjin e tyre. Përveç studimeve demografike (15) do të ishte nevoja të bëheshin edhe vëzhgime sociolinguistike për këtë dukuri, por ne besojmë se ky konstatim do të vërtetohet. Në këtë mënyrë kemi të bëjmë gjithnjë e më tepër me dy gjuhë letrare në kontakt. Njëkohësisht shqiptarët mësojnë edhe gjuhë të tjera të huaja në shkollë dhe për nevoja pune. Pozita e shqipes në këto situata plurilinguizmi si gjuhë dominante vjen duke u forcuar pikërisht në varësi të drejtpërdrejtë me shkallën e përvetësimit të gjuhës letrare. Është i kuptueshëm, nga ana tjetër, një ndikim i kalkimeve nga serbokroatishtja në gjuhën e mjeteve të komunikimit masiv, të politikës e të sendeve të konsumit të industrisë. Ka një përprjekje të gjerë për t'u bërë ballë këtyre kalkimeve dhe botohen mjaft shkrime, tashti edhe një revistë e posaçme "Gjuha shqipe". Mbështetja më e mirë për këto përprjekje është përpunimi i mëtejshëm i gjuhës letrare shqipe, proces në të cilin shqiptarët në Jugosllavi marrin pjesë jo në mënyrë pasive, por duke dhënë një kontribut me vlerë. Për këtë ndihmojnë edhe studimet dialektologjike e njohja e gjuhës së gjallë, e cila ruan mjaft pasuri ende të pashfrytëzuara, siç na bindin botimet e bëra, duke përfshirë edhe folklorin. Dukuria e diglosisë gjuhë letrare - dialekt shoqërohet me një vlerësim estetik të gjuhës letrare për shkak të prestigjit të lartë të kësaj deri në shfaqjen e hiperurbanizmave. Përhapja e trajtës letrare edhe në gjuhën e folur, gjë për të cilën janë të gjitha kushtet, do ta shndërrojë diglosinë në çështje të regjistrave gjuhësorë.

Për shqiptarët në Malin e Zi shkolla 8-vjeçare të plota dhe shkolla e parë e mesme në gjuhën shqipe u arrit të ekzistojnë më



1965. ndërsa teksti i parë shkollor në gjuhën shqipe u botua më 1976, deri atëhere librat vinin nga Kosova. Të dhënat demografike dhe sociolinguistike na mungojnë, por ngritja e një Enti për botimin e teksteve e të literaturës shkollore, ose botimi i revistës “Koha” tregojnë se me gjithë vonesën kundrejt Kosovës, edhe këtu procesi i përhapjes së gjuhës letrare shqipe po ecën përpara.

Veçantia e situatës për shqipen në Maqedoni lidhet me faktin se këtu ajo është në kontakt me një gjuhë tjetër sllave, e cila nga ana e vet u ngrit në statusin e një gjuhe letrare e shtetërore vetëm pas Luftës II Botërore. Gjithashtu në nivelin e komunikimit të përditshëm në këtë zonë kanë qenë të pranishme edhe turqishtja, greqishtja e arumanishtja, kurse sot nevojat shtetërore dhe mjetet e komunikimit masiv sjellin edhe serbokroatishten letrare. Ruajtja e shqipes si gjuha themelore e shqiptarëve në këto troje shpjegohet me vazhdimësinë e arealit të shqipes dhe me fatet e përbashkëta të këtyre popullsive në luftën për pavarësinë kombëtare. Nga ana tjetër, zbatimi i gjuhës letrare kombëtare ka sjellë po ato efekte pozitive si edhe në Kosovë. Fakti që në këtë zonë kalohet nga të folme geqe edhe në të folmet toske nuk dimë të ketë pasur ndonjë ndikim në këtë zbatim.

Në Greqi ka një pjesë të arealit të shqipes, por edhe lidhur me diasporën nuk mund të flitet për një shqipe të mesme në kuptimin e plotë të fjalës. Arsyeja është se lëvizja e popullsisë shqiptare ka qenë e vazhdueshme drejt Greqisë qendrore e jugore dhe ishujve, lidhjet me arealin nuk janë ndërprerë. Kjo ka sjellë që në kolonitë e ndryshme në fshatra po edhe në qytete, të ndeshemi sot edhe me veçori dialektore që i përkasin shqipes së re(17). Në këto koloni bilinguizmi ka qenë dhe vijon të jetë i përhapur. Në një varg rastesh ai ka çuar në asimilim të plotë, sidomos në rastet kur këto koloni kanë qenë ishuj të vegjël të izoluar, por gjurmët e tij ruhen në toponiminë shqipe, në këngë ose formula të veçanta që lidhen me

rite e me folklor. Dëshmitë për këto koloni janë të shumta që nga shekulli i kaluar. Sot ato vijnë në Atikë, Beoti, Lokridë, Peloponez, Korint e në ishuj si Eubea, Hidra, Speca, Salamina etj. Kjo është kudo një shqipe e folur. Përpjekjet që u bënë në fund të shekullit të kaluar nga disa shqiptarë për ta shkruar nuk patën sukses. Nuk ka shkolla në gjuhën shqipe, por kjo ka qenë e shoqëruar edhe më analfabetizmin, rrethanë që ka pasur pasoja kontradiktore. Mungesa e shkrimit e ka kufizuar rreth funksional të shqipes dhe kontaktin me zhvillimin e kulturës kombëtare shqiptare. Nga ana tjetër, nuk u fut edhe gjuha e shkruar e vendit, pra mungoi një bilinguizëm me një gjuhë letrare dominante. Prandaj bashkë me kulturën tradicionale, me zakonet, ritet, folklorin, u ruajt mjaft mirë në përdorimin familjar gjuha e folur shqipe. Një faktor i fortë negativ ka qenë identifikimi i fesë me kombësinë, por lidhur me popullsinë çame që i përket arealit dhe që ishte islamizuar, edhe ky faktor ka vepruar në të kundërtën e tij. Për studimet sociolinguistike kjo është një fushë e paprekur dhe me interes shkencor, nga e cila mund të nxirreshin rekomandime edhe për programet në fushën e arsimit, të kulturës e të gjuhës.

Një njohje më të detajuar kemi për gjendjen e shqipes në Itali. Ajo ka tërhequr vëmendjen e gjuhëtarëve sidomos sepse është parë si një fazë më e hershme e shqipes, e ruajtur në rrethana të veçanta dhe që me të dhënat e veta shërben për kronologjinë e një vargu dukurish gjuhësore(18). Ne do ta përcaktonim atë si shqipe të diasporës, që pasqyron etapën e fundit të shqipes së mesme dhe sot në gjendje bilinguizmi. Në shekullin e kaluar ndër arbëreshët e Italisë u ngrit një lëvizje e gjerë kulturore e letrare, e lidhur ngushtë me Rilindjen Kombëtare. U krijua një letërsi artistike me vlera, që u pranuan edhe në atë kohë, u themeluan kolegje të gjuhës shqipe si ai i Shën Adrianit në Kalabri, që kanë luajtur rol të veçantë kulturor. Faktori themelor i ruajtjes së kësaj diaspore në një rrethim

të gjerë të huaj ka qenë vetëdija e fortë kombëtare. shpresa për shumë kohë se do të ktheheshin në atdheun e parë dhe diferenca kulturore, gjuhësore e fetare. Deri në shek. XIX pjesa më e madhe e këtyre ngulimeve në Kalabri, Sicili e rreth Katanzaros vijonin të ishin monolingue. Nga mesi i shekullit u kalua në bilinguizmin e përgjithësuar shqip-dialekte romane(19) dhe pas Luftës II Botërore filloi të veprojë diglosia me italishten, që për arbëreshët kthehet në plurilinguizëm: shqip-italisht-dialekt italian. Situata e sotme përcaktohet nga veprimi i dy grupe faktorësh. E para, proceset ekonomike-shoqërore në Italinë e Jugut, zhvillimi i transportit, i mjeteve të komunikimit masiv, emigracioni etj., bashkë me mungesën e shkollës në gjuhën shqipe, ndikojnë për përhapjen e plurilinguizmit, duke e shtyrë arbërishten nga pozicioni i saj si gjuhë dominante. E dyta, ka një zgjim të ri të ndërgjegjes kombëtare, më 1981 është themeluar edhe “Lega Italiana di Difesa della Minoranza Arbëreshe”. Është rritur një veprimtari e gjerë në fushën e kulturës, botohen libra e revista, të cilat pas vitit 1972 janë orientuar nga gjuha letrare kombëtare, veprojnë qendra studimore universitare dhe ka disa shkrimtarë me autoritet e mjaft studiues e filologë (20). Kërkesa për shkollën shqipe është shtruar jo nga pozitat e ngushta të një autokonservimi të prapambetur, por si mjet për të marrë pjesë në mënyrë të plotë në shoqërinë bashkëkohore, duke ndihmuar edhe përmirësimin e aftësive shprehëse në gjuhën italiane e duke dhënë kontribut për pasurimin e botës kulturore italiane e europiane (21). Na duket se një konceptim i tillë do të ishte i frytshëm po të zbatohej edhe në vendet e tjera, ku ka sot koloni të gjera të gjuhës shqipe.

Me botimin nën kujdesin e Antonio Guzzetta të vëllimit *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia* (Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo 25-28 Novembre 1981) kemi në dorë studimin më të plotë nga pikëpamja sociolinguistike për gjendjen e shqipes në një kontekst të huaj sot. Autorët e

kontributeve vënë re situatën e arbërishtes si një dialekt, që nuk e ka mbulesën e gjuhës letrare (dachlose Mundart) dhe që i detyron folësit të përdorin një variant tjetër. Por me gjithë kushtet e krijuara kështu, arbërishtja demonstroi sot e kësaj dite një vitalitet të dukshëm dhe një forcë asimiluese në komunitetet italo-arbëreshe (f. 59-60). Janë vështruar problemet e bikulturalizmit e të industrisë kulturore e televizive, po edhe të presioneve monokulturaliste (duke pranuar që “preserving a culture in fact, also means preserving the man who possesses it and his possibilities of planning his own future”, f. 183). Nga pikëpamja e bilinguizmit janë vëzhguar problemet që lidhen me edukimin gjuhësor, me gjendjen në shkollë, me ndikimin e mjeteve të komunikimit masiv, të kushteve socio-demografike, të varianteve të repertorit gjuhësor, të zgjedhjes gjuhësore, të veçorive në familje, në llojet e ndryshme të profesioneve, sipas moshës, seksit, fesë etj. Për përfshirjen e plotë në jetën shoqërore theksohet (f. 218), se nuk është e nevojshme të braktiset gjuha amtare, por një bilinguizëm i vetëdijshëm, në kushte shkencërisht më të mira jep mundësinë si për të pasur një mjet të gjerë komunikimi, ashtu edhe për të ruajtur atë mjet, që garanton vazhdimësinë kulturore, duke i ruajtur me vetëdije dhe me kujdes rrënjët e veta. Është vënë në dukje (f. 217) se breza të rinjsh kanë fituar një vetëdije për vlerën e kulturës së vet dhe kanë marrë iniciativa, që në fakt e kanë përmirësuar cilësisht njohjen e gjuhës (aftësinë për ta lexuar e shkruar) dhe gjendjen e leksikut, i cili është azhurnuar e përtërirë me fjalë shqipe, të marra nga kontakti i drejtpërdrejtë me shqipen e sotme letrare. Si perspektiva më e mirë shihet një kontakt më i gjerë kulturor e gjuhësor ndërmjet bashkësive dhe me atdheun e parë, kontakt që do të sjellë në një koine gjuhësore kulturore, ku gjuha letrare shqipe, e përfshirë në qarkun komunikues sot në një masë të vogël e në të ardhmen gjithnjë e më gjerë, do të ndikojë për forcimin e vitalitetit të vetë gjuhës. Një perspektivë e

tillë është frytdhënëse edhe për kolonitë e gjuhës shqipe në shumë vende të tjera të botës, të cilat duke qenë se përfaqësojnë shqipen e sotme, e kanë edhe më të lehtë zotërimin aktiv të gjuhës letrare.

Kolonitë shqiptare në Rumani, Bullgari, Egjipt, SHBA luajtën një rol të madh gjatë Rilindjes Kombëtare. Atje u themeluan shoqëri, shtypshkronja, u botuan libra e gazeta shqipe. Vëmendjen e gjuhëtarëve e kanë tërhequr grupet e vogla në Bullgari (Mandricë), në Jugosllavi (Arbanas, Nikinci e Hrtkovci), në Ukrainë; për arsye ekonomike koloni janë formuar edhe në Australi, Argjentinë, në Europën Qendrore, në Siri e gjetkë. Vend të veçantë zë popullsia shqiptare në Turqi. Siç e vinte në dukje J. G. Hani në kohën e vet, në Turqinë Europiane dhe në bregun e Azisë së Vogël nuk kishte qytet pa shqiptarë. Numri i tyre ka shkuar duke u rritur, madje edhe pas Luftës II Botërore me kosovarë. Gjuha shqipe këtu është në situatën e bilinguizmit, por ka një veçanti. Kultura shqiptare nuk ka qenë në pozitë të inferioritetit dhe bikulturalizmi nuk është në situatë konfliktit. Prandaj për shqiptarët nuk ka vështirësi për përfshirjen në jetën ekonomike e shoqërore. Në këto rrethana të një bilinguizmi pa konflikt, i cili do të ishte një objekt mjaft interesant studimi sociolinguistik, shkolla shqipe dhe përvetësimi i gjuhës letrare do të shërbenin për një ngritje shumë të shpejtë kulturore, që do ta forconte rolin e shqiptarëve si faktor progresi. E njëjta gjë do të vlente për shqiptarët në SHBA, ku ka tradita të mëdha të këtij shekulli.

Ky vështrim i shkurtër i historisë së formimit dhe i gjendjes së shqipes së sotme na shtyn ta shikojmë atë jo vetëm si një sistem abstrakt, por edhe si mjetin themelor të shprehjes së kulturës e të vetëdijes kombëtare të një populli, si një shumësi variantesh, që u shërbejnë kërkesave të ndryshme të komunikimit e të zhvillimit shoqëror. E ndodhur në situata të ndryshme kulturore, kjo gjuhë tregon një vitalitet të plotë në plotësimin e këtyre funksioneve, duke

pasur sot edhe mbështetjen e gjuhës letrare. Nga ana tjetër, shqipja e diasporës, e kolonive po edhe një pjese të arealit nuk mund të shihet më si një kuriozitet historik e dialektologjik, por si një realitet sociolinguistik me të gjitha problemet e gjuhëve e të kulturave në kontakt.

## SHËNIMET

1. ÇABEJ, E. *Actes du Premier Congrès International des Etudes balkaniques et Sud-Est Européennes*, VI (1968), f. 225, dallon periudhën prarahistorike të shqipes, që vjen deri në kontaktet e saj me greqishten e vjetër dhe latinishten. Periudhën historike e ndan në paraletrare dhe letrare, duke pasur si kufi shek. XV ose XVI. Një periodizim tjetër jep S. Riza në *Emrat në shqipe: sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit*, T. 1965, f. 7. Sipas tij, periudha I është shqipja e lashtësisë deri në shek. IV; periudha II është shqipja e mesjetës deri në shek. XV dhe periudha III shqipja e kohëve të reja.
2. Shih edhe: E. Çabej, *L'ancien nom national des Albanais*, "Studia Albanica", 1972, I (IX), f. 31-40
3. Në *Formimi i emrave përmbledhës nga tema e shumësit*, "Studime filologjike", 1976, nr. 2, f. 27-30, ne kemi vënë në dukje se përdoret më dendur ndajfolja për emërtim in e gjuhëve dhe se marrëdhëniet ndërmjet *shqip*, *shqiptar*, *Shqipëri* janë mjaft të ndërlikuara.
4. Shih përmbledhjen në gjashtë vëllime: E. Çabej, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1976-1977.
5. ÇABEJ, E. *Studime gjuhësore*, III, f. 52.
6. SHUTERIQI, DH. S. *Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut (879-1555)*, "Studime filologjike", 1983, 1, f. 203.
7. Shih p.sh. Zija Shkodra, *Kontribut për historinë e diasporës shqiptare*, "Studime historike", 1971, nr. 3, f. 96.
8. SHKODRA, Z. *vep. cit.* f. 103.
9. TËRNAVA, M. *Shqiptarët në qytetet e Kosovës në shek. XV-XVI*, "Studime historike" 1979, nr. f. 110.
10. Këto punime i kemi tani në një disertacion të plotë: *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, Tiranë 1984. Siç vë re me mprehtësi autori, edhe po të shpërngulej e gjithë popullsia e Malësive të Veriut, ajo nuk mund të plotësonte me banorë ato zona, për të cilat thuhet se shqiptarët janë vendosur vetëm pas këtyre shekujve.

11. Nga ana tjetër, bilinguizmi bëhej i detyruar për shqiptarët që shtegtonin ose që vendoseshin në pjesët e ndryshme të perandorisë. "Procesin e huazimit të turqizimeve e shtuan shqiptarët, të cilët me hir ose pa hir shkolin në Turqi ose inkadroheshin në administratën e qeverisë turke dhe që, kur ktheheshin, sillnin me vete fjalë dhe shprehje të gjuhës turke. Aq më tepër disa prej tyre e përdornin aktivisht turqishten". L. Mulaku. *Turqizmat në gjuhën shqipe*. "Koha", 1983, nr. 3, f. 353.
12. KOSTALLARI, A. *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, "Studime filologjike", 1970, nr. 2; *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*. "Studime filologjike", 1973, nr. 1; *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, "Studime filologjike", 1982, nr. 2.
13. LLOSHI, XH. *Un aperçu sur des manuscrits inédits de la traduction en albanais de la Bible au XIXe siècle*, Akten des Internationales Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972, f. 484-495.
14. Në programin e 15 shtatorit 1878, p.sh., thuhej: "Gjuha osmane të mbetet si gjuhë zyrtare në korrespondencën dhe letërkëmbimin e vilajetit me Portën e Lartë. Megjithëkëtë në këshillat e gjykatave të përdoret gjuha shqipe dhe diskutimet të zhvillohen në këtë gjuhë".
15. LLOSHI, XH. *The development of socio-political vocabulary of the Albanian Language after the Liberation of the country*. "Studia Albanica", 1979, nr. 2, f. 105-114.
16. AJETI, I. *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë*, "Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike", 1973, IV, f. 8-9.
17. Kështu këngët e materiali i botuar nga Antonio Bellusci, *Pellegrinaggio a Milo con gli "Arvanites" di Grecia*, "Zgjimi", 1970, nr. 2-3; *Coparelli di Tebe*, "Zgjimi", 1972, nr. 3 etj., në rast se është regjistruar besnikërisht, është në gjuhën e sotme me veçoritë krejt të natyrshme dialektore.
18. Prof. E. Çabej e ka zbatuar rregullisht këtë kriter në studimet etimologjike. Shih në veçanti gjithashtu: E. Çabej, *Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre*, "Konferenca II e studimeve albanologjike", vëll. III, f. 107-115.
19. GAMBARARA, D. *Parlare albanese nell'Italia unita*, "Zjarri", 1980, nr. 27, f. 39.
20. "Questa azione di sensibilizzazione ha avuto negli ultimi anni in Calabria un rilevante impulso ed ha tuttora dei momenti particolarmente forti nelle ormai tradizionali 'Settimane della cultura albanese', promosse dalla rivista ZJARRI e poi continuate dalla 'Lega italiana di Difesa della Minoranza Albanese',

che hanno portato tra gli arbëreshë ad una riscoperta delle proprie radici etniche e linguistiche e ad una rivalutazione della propria identità culturale". *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia*, f. 63.

21. Në Parathënien për C. Candreva - C. Stamile, *Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh*, Calabria, 1979, Michele Famiglietti shkruan për një "azione formativa, che attraverso la coltivazione della lingua materna, in questo caso dell'albanese, liberi, potenzi le risorse di base del discente, faccia rivivere le peculiarità e la ricchezza umana di una cultura popolare, ancora prevalentemente orale, e nel contempo agisca pure a migliorare al massimo quelle competenze necessarie per una società moderna, ivi compresa la migliore capacità espressiva in lingua italiana" (f. 6). Kurse vetë autorët shënojnë: "Si può considerare un caso quasi unico nella storia dell'umanità che delle isole linguistiche minoritarie, come sono quelle dei paesi italo-albanesi, abbiano potuto esprimere una tale capacità di conservazione del loro patrimonio linguistico e culturale. Patrimonio che oggi, affermandosi la concezione pluralistica della cultura, può contribuire ad arricchire il mondo della cultura popolare italiana ed europea". (f. 19).

*Mbajtur si bashkëreferat në Kongresin e Pestë  
Ndërkombëtar të Studimeve për Europën Jug-  
Lindore, Beograd, 11-16 shtator 1984.*

*Botuar anglisht me titullin Modern Albanian in Dif-  
ferent Culture Contexts, në "Studia Albanica",  
1984, nr. 2, f. 165-176.*



## GJUHA LETRARE SHQIPE, STILET FUNKSIONALE DHE KULTURA SHQIPTARE

Gjuha shqipe, një nga më të vjetrat në Ballkan bashkë me popullin që e ka krijuar, është ruajtur përmes shekujve dhe është zhvilluar sot si shprehje e përqendruar e identitetit të tij kombëtar e të nivelit kulturor që ka arritur.

Dukuritë e lidhura me konsolidimin e shqipes në trajtën e një gjuhe letrare me sistemin e vet stilistik të përpunuar mund të ndiqen drejtpërdrejt si një realitet i gjallë e dinamik, dhe prandaj kanë interes edhe për teorinë gjuhësore. Duke i përfshirë këto dukuri në proceset e përgjithshme të ngulitjes së gjuhëve letrare të popujve të tjerë të Ballkanit, bie në sy se, krahas dallimeve, ndërmjet tyre ka edhe pika afrimi nga ky aspekt, të lidhura me kushtet historike-shoqërore të kohës së re, që *u shtohen si vazhdim problematikës së përbashkët historike e gjuhësore të këtyre popujve të Europës Juglindore.*

Meqë formimi i një gjuhe letrare dhe i sistemit të saj stilistik nuk mund të ndodhë rastësisht e nëpërmjet një politike gjuhësore artificiale afatshkurtër, është e nevojshme të dallohen disa etapa, të kushtëzuara edhe nga orientimet kulturore kryesore të secilës prej tyre përkatësisht.

Etapat kryesore të kristalizimit të gjuhës letrare shqipe, bazat e saj dhe mjaft çështje të tjera janë trajtuar në një varg punimesh të prof. A. Kostallarit(1), prandaj nuk do të ishte me vend që të përsëriteshin ato.

Nga pikëpamja historike mund të dallohen tri periudha kryesore:

1. Periudha e Rilindjes Kombëtare, nga dhjetëvjeçarët e parë të

shekullit të 19-të e deri në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të 20-të

2. Periudha e Pavarësisë, nga fundi i Luftës I Botërore deri në fundin e Luftës II Botërore.

3. Periudha pas Çlirimit, mesi i shekullit të 20-të deri në ditët tona.

1. Ndonëse si gjuhë e shkruar shqipja dokumentohet prej disa shekujsh, ajo pësoi në shekullin e 19-të disa ndryshime të dukshme cilësore(2). Rilindja Kombëtare, duke qenë një lëvizje e thellë politike e shoqërore, e konsideroi gjuhën si një nga mjetet më të rëndësishme për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare në luftën për liri. Ajo ishte edhe një orientim i caktuar kulturor në jetën e popullit, ndërsa për gjuhën kjo do të thoshte se faktori veprues kryesor bëhet *uniteti kombëtar*. Kjo periudhë përkon edhe me mbizotërimin e *romantizmit* përgjithësisht në kulturën shqiptare (3).

Për të dëshmuar konkretisht veprimin e këtyre faktorëve, do të sjellim dy fakte. E para, deri në periudhën e Rilindjes ishin përpunuar disa variante të shqipes së shkruar, por ato i kishin fare të dobëta marrëdhëniet ndërmjet tyre. Ndërsa tani ka një shumësi variantesh, autorët që i përdorin i njohin ato reciprokisht, por nuk vihet re tendenca për rivalitet. Përkundrazi, të gjithë përpiqen për të nxjerrë në dukje pasuritë e shqipes e për ta lëvruar atë. Një figurë e shquar si K. Kristoforidhi me dhjetëra vjet shkrimet dhe përkthimet e tij i ka botuar në dy variantet kryesore, madje një tregim të vetin e ka shkruar në 3 variante. E dyta, një drejtim letrar, i quajtur rryma e bejtexhinjve, bëri një përpjekje në shek. 18-19 për një variant stilistik të shqipes, në të cilin huazimet orientale të kishin kundrejt fjalës shqipe po atë rol stilistik, si dhe sllavizmat kishtarë në rusishten, latinizmat në italishten etj. në etapat e konsolidimit të tyre. Kësaj rryme iu kundërvu me sukses letërsia e Rilindjes Kombëtare, e cila me autorë të shquar si poeti kombëtar N. Frashëri, nguliti një konceptim tjetër estetik, i cili edhe për ligjërimin poetik i kërkonte burimet në gjuhën e gjallë të popullit.

Në këto rrethana, procesi i formimit të gjuhës letrare kombëtare kishte si një nga drejtimet themelore përpjekjet për të përpunuar gjuhën e sferave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore. Konvergjenca gjuhësore dhe përcaktimi i normës letrare nuk mund të realizoheshin pa përfshirë stilet funksionale (4). Lindi dhe u zhvillua një letërsi artistike me vepra të rëndësishme, që edhe sot i ruajnë vlerat për gjuhën e përpunuar nga ana e funksionit poetik-stilistik. Në gjysmën e dytë të shekullit nisi botimi i gazetave shqipe në kolonitë shqiptare e që nga viti 1879 edhe në Shqipëri. Gjuha e publicistikës njohu vepra me nivel që nga Parathënia e N. Veqilharxhit (1845) e deri te manifesti politik i S. Frashërit (1899). Përpjekje për gjuhën e shkencës u bënë kryesisht lidhur me shkencat shoqërore e me kërkesat e shkollës. Lidhja Shqiptare e Prizrenit paraqiti kërkesa të qarta për futjen e shqipes në administratë e në gjyqet dhe është interesante, se në gjithë dokumentet e saj nuk preket çështja e variantit konkret letrar. Në veprimtarinë ekonomike e tregtare gjithashtu zgjerohet hap pas hapi përdorimi i shqipes. Edhe futja e shqipes në librat e në shërbesat fetare u bë me një luftë të hapur për të afirmuar identitetin kulturor kombëtar në këtë fushë.

2. Shpallja e Pavarësisë më 1912 e gjeti gjuhën shqipe të përgatitur për funksionet që duhej të merrte në shtetin shqiptar. Megjithatë problemi i një gjuhe të vetme letrare nuk ishte zgjidhur dhe ai tani shtrohej në rrethana të reja. Në orientimet kulturore të vendit, krahas komponentëve që trashëgoheshin nga Rilindja Kombëtare, marrin gjithnjë e më tepër rëndësi faktorët politikë-shoqërorë. Vendin e romantizmit do ta zinte *realizmi*. Përpara shoqërisë shqiptare shtrohej çështja, a do të ecte në rrugën e përparimit e të demokracisë, apo do të ruhej prapambetja feudale e patriarkale me të gjitha pasojat e saj. Këto rrethana u reflektuan në mënyrë specifike mbi proceset gjuhësore. Ndonëse pikëpamjet e shprehura në atë kohë janë të ndryshme, madje janë bërë përpjekje edhe për ta përcaktuar zgjidhjen

me vendime zyrtare, objektivisht u përvijuan dy variante letrare kryesore.

Forcat demokratike e përparimtare e shihnin të ardhmen në konvergjencën e varianteve letrare, duke u pasuruar nga burimi i gjuhës së gjallë dhe në afrimin e stileve me modelet e gjuhëve që kishin tradita kulturore përparimtare. Kurse forcat regresive ishin për ta konservuar gjendjen, apo edhe për ta thelluar më tej dallimin midis dy varianteve. Ato përpiqeshin që dy variantet të shndërroheshin në dy orientime kulturore të ndryshme, madje të mbështetura në dallime gjeografike, etnografike, dialektore, fetare etj., duke vënë në dyshim vetë unitetin kombëtar. Në këtë mënyrë, vendin e unitetit e zuri rivaliteti. Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen për këtë çështje, për arsye se edhe pas Luftës II Botërore e deri më sot ka raste, kur në shkrimet e autorëve të huaj paraqitet si diçka “objektive” kundërvënja e dy varianteve të shqipes, “toskërishtes” me “gegërishten”, pra edhe gjendja e pakapërcyeshme. Një trajtim i tillë është vazhdim i koncepteve të forcave regresive në Shqipërinë e paraluftës, të cilat edhe në atë kohë nuk arritën të imponoheshin në kulturën shqiptare. Ashtu siç u përvijuan dy variante, po ashtu objektivisht procesi shkante drejt një norme të vetme letrare, por duhet theksuar se shqipja, qoftë edhe ngadalë, po bëhej shprehëse e një kulture bashkëkohore dhe stilet funksionale kanë përparuar, pavarësisht nga prania e ngjyimeve dialektore, që dallonin variantet letrare. Kështu p.sh., stili administrativ është përpunuar pavarësisht nga prania ose mungesa e rotacizmit, apo nga vendimet formale për të zbatuar këtë ose atë dialekt.

3. Pas Çlirimit Shqipëria hyri në rrugën e ndërtimit të një rendi tjetër shoqëror. Në këto rrethana vendosja e një gjuhe të vetmeletrare kombëtare ishte fokusi ku përqendroheshin të gjitha tendencat historike jashtëgjuhësore dhe gjuhësore. Me miratimin e një drejtshkrimi të njësuar më 1972, në të vërtetë konsakrohej mbyllja e

një procesi të gjatë historik dhe vendosja e një gjuhe të vetme letrare. Një faktor i ri është edhe kujdesi i gjithë shoqërisë për gjuhën si mjet i përparimit kulturor, gjë për të cilën japin ndihmesë edhe vetë gjuhëtarët shqiptarë. Gjuha letrare është sot gjuha e një kombi, e një kulture, e një shteti. Ajo i ka përpunuar dhe po i zhvillon më tej funksionet e veta, duke qenë në korrelacion me shoqërinë, së cilës i shërben, me veprimtarinë politike, ekonomike e intelektuale të saj. Gjuha letrare ka marrë përsipër të gjitha funksionet në çdo sferë dhe prandaj tani mund të flitet për një *sistem të plotë stilistik*. Nocioni për gjuhën letrare si një gjuhë polivalente, si një sistem tërësor variantesh funksionale është arritja më e rëndësishme pas nocionit për një normë të vetme kombëtare.

Gjatë Rilindjes e Pavarësisë përpjekjet për një normë unike u shoqëruan me procesin intensiv të diferencimit, shtresimit, rishpërndarjes, përpunimit e formësimit të trajtave, mjeteve, ndërtimeve, vlerave semantike e stilistike. Në kohën tonë *drejtimi kryesor është pasurimi dhe konsolidimi i tipareve të ligjërimeve e të stileve funksionale*. Gjuha letrare shqipe sot ka në plan të parë probleme të ngjashme me gjuhët e tjera të ngulitura e të lëvuara: përsosjen e sistemit të saj në dritën e dialektikës së njësisë e të ndryshueshmërisë (unitetit e variacionit). Shoqëria ka tani një shumësi mënyrash përdorimi të gjuhës, të përvijuara historikisht. Variacioni është i nevojshëm për vetë ekzistencën e gjuhës në jetën e gjatë të një populli. Por edhe njësia e gjuhës është e domosdoshme, që ajo të luajë rolin shoqëror e kulturor në shkallë gjithëkombëtare, të sigurojë trashëgiminë e pandërprerë, pa krijuar shkoputje të ndjeshme ndërmjet brezave dhe etapave kulturore. Ndeshja e këtyre dy prirjeve është një forcë lëvizëse e brendshme për zhvillimin e gjuhës letrare e të stileve të saj.

Në fushën e fonetikës vërehet ngulitja e normave të shqiptimit edhe në gjuhën e folur të përditshme, ndërkaq kjo shoqërohet nga përvijimi i variacioneve, që marrin vlera stilistike. Edhe disa tipare

fonetike dialektore tashmë lidhen me aspekte sociale e kulturore, historike e etnografike, marrin funksione stilistike e prandaj shfrytëzohen me sukses në letërsi, në kinematografi e në skenë; p.sh. për të ngjallur përfytyrimin e fshatit, për të dhënë tiparet e njeriut të thjeshtë nga popullit, por edhe për humor e ironi, për karakterizimin e shtresave të caktuara sociale etj.

Në fushën e morfologjisë vërehet, nga njëra anë, prirja për thjeshtësim, për rrafshimin e trajtave gramatikore, sidomos në stilet e shkruara. Por nga ana tjetër, ka edhe një prirje për të ruajtur me funksione stilistike trajtat me variacion, të ardhura nga gjuha e folur, nga dialektet e nga historia, sidomos në sistemin foljor, trajtat e shumësit e të rasave të emrave, llojshmërinë e parafjalëve, lidhëzave e pjesëzave, për të dhënë ngjyresa të ndryshme shprehëse.

Në fushën e sintaksës është përpunuar një varg strukturash të ndërlikuara, me shumë ndërvarësi, që u shërbejnë mendimeve të nivelit abstrakt, diferencimeve të imëta, ngjeshjes së informacionit në formulime të plota etj., të cilat çojnë drejt një intelektualizimi të sintaksës, por vërehet edhe një prirje e fortë, sidomos në letërsinë artistike e pjesërisht në publicistikë, për të thithur ndërtime të gjuhës së gjallë më të thjeshta, me shprehësi emocionale të drejtpërdrejtë. Edhe këtu ndeshen rrafshimi me sinoniminë, ndërkaq pasuria e ndërtimeve sinonimike shkon duke u shtuar.

Në fushën e fjalëformimit janë bërë shumë produktive disa modele, të cilat përfshijnë gjerësisht temat e një tipi. Është një fjalëformim që merr natyrë morfologjike, plotësimi i çerdhes së fjalëve bëhet i njëjtë me ndërtimin e paradigmave gramatikore, sidomos në rastin e paradigmave terminologjike. Si kundërpeshë ka një gjallërim të modeleve, që kanë qenë më të kufizuara, zakonisht me prejardhje nga gjuha e folur e në veçanti nga bashkëveprimi i varianteve të ndryshme. Është me interes në këtë vështrim, p.sh., fjalëformimi i ndajfoljeve. Në këtë rrugë arrihen efekte shprehëse në letërsi, krijohen

neologjizmat e shkrimtarëve, stilemat për vlerësime emocionale, ironike, përbuzëse etj., por edhe arrihen zgjidhje për vështirësitë terminologjike.

Në fushën e leksikut ka një pasurim intensiv të vargjeve sistemore në degët e ndryshme të terminologjisë tekniko-shkencore dhe të fushave tematike për nocionet intelektuale, kulturore e sociale, që janë shtuar e diferencuar sidomos si pasojë e revolucionit tekniko-shkencor, por njëkohësisht ka një orientim të përgjithshëm kulturor, artistik e gjuhësor për të gjurmuar visarin e fjalëve, të kuptimeve e të frazeologjisë popullore dhe për ta përfshirë atë në qarkullimin letrar, deri edhe në përkthimet që bëhen nga letërsia artistike botërore.

Ndryshe nga mjaft gjuhë të tjera, për shqipen përgjithësisht nuk është vërejtur dukuria e një shkëputjeje të ndjeshme midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, por kjo është një çështje që meriton një trajtim të veçantë.

Vendin qendror në sistemin e stileve funksionale(5) të shqipes së sotme e zë stili i veprimtarisë politike-shoqërore, për shkak të rolit të gjerë shoqëror dhe të forcës së madhe ndikuese që kanë komunikimi publik dhe mjetet e komunikimit masiv. Ky stil ka pësuar shndërrimet më të thella(6), ndërsa mjetet e komunikimit masiv i janë afruar gjuhës së gjallë të folur. Letërsia artistike luan rolin kryesor në përpunimin e aftësive shprehëse të shqipes, për pasqyrimin e gjithë gamës së tipave të ligjërimit, të procesit real të komunikimit gjuhësor dhe për eksplorimin e horizonteve të krijimtarisë e të origjinalitetit. Në stilin e punëve administrative e shtetërore është bërë një punë e vetëdijshme për një gjuhë më të shkathët, më pak konvencionale e konservatore, lidhur edhe me punën kundër burokratizmit të gjuhës. Gjithashtu kanë depërtuar në këtë stil elementë të terminologjisë tekniko-shkencore, meqë del nevoja të kodifikohen ligjërisht edhe fushat e shkencës e të teknikës.

Në pjesën e arealit të shqipes, që përfshin Kosovën dhe shqiptarët e Maqedonisë e të Malit të Zi, gjithashtu është zbatuar gjuha letrare

kombëtare në të gjitha sferat e stilet. Për këtë kanë luajtur rol të veçantë shkrimtarët, arsimtarët, historianët, publicistët, specialistët dhe vetë gjuhëtarët e këtyre viseve, të vetëdijshëm se një popull i tërë mund ta marrë kulturën kombëtare vetëm në gjuhën amëtare, përndryshe do të lindnin probleme të pakapërcyeshme socio-psikologjike. Kështu është kapërcyer rreziku, që kultura e trashëguar të shndërrohet në një kulturë provinciale, të paaftë për zhvillimin modern. Shqiptarët në Jugosllavi marrin pjesë në përpunimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe e të stileve të saj jo në mënyrë pasive, por duke dhënë ndihmesë me vlerë. Për diasporën shqiptare, siç është rasti i arbëreshëve të Italisë, por edhe për shqiptarët në vende të tjera të botës, si perspektiva më e mirë shihet një kontakt i gjerë kulturor e gjuhësor me atdheun e parë, kontakt që ndikon për një koine gjuhësore-kulturore, në qarkun komunikues të së cilës përfshihet gjuha letrare. Përgjithësisht gjuha letrare shërben si një nga faktorët themelorë për ruajtjen e konsolidimin e njësisë etnokulturore të shqiptarëve brenda e jashtë Shqipërisë.

Si përfundim, mund të thuhet se gjuha e sotme letrare shqipe është një mjet i kultivuar për shprehjen e kulturës e të vetëdijes së kombit, është një shumësi variantesh stilistike, që pasqyrojnë dhe u shërbejnë kërkesave të ndryshme të komunikimit në jetën shoqërore, politike, ekonomike, arsimore, kulturore e shkencore dhe tregon vitalitet në plotësimin e këtyre funksioneve. Duke mos pasur zbrazëti në sistemin e vet funksional, ajo krijon mundësitë edhe për një kontakt më të gjerë me kulturën botërore. Nga ana tjetër, ajo nuk është vetëm pasqyrë e shoqërisë së cilës i shërben, por është edhe pjesëmarrëse vepruese në të, ndikon me cilësitë e saj në shkallën e përparimit shoqëror e kulturor. Në studimet dhe në përfundimet që arrijnë gjuhëtarët, nuk mund ta harrojnë edhe këtë aspekt.



## SHËNIMET

1. Shih punimet e A. Kostallarit: *Sur les traits principaux de l'albanais littéraire contemporain*, "Actes du Premier Congrès International des Etudes balkaniques et Sud-Est Européennes", Sofia, 1968, VI: *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, "Studime filologjike", 1970, nr. 2; *La langue littéraire albanaise dans la période de l'édification du socialisme*, "Studia Albanica", 1970, nr. 1; *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973; *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, "Studime filologjike", 1982, nr. 2; *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, "Studime filologjike", 1984, nr. 4; *Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare kombëtare e njësuar*, "Studime filologjike", 1986, nr. 3.
2. Shih më hollësisht: Xh. Lloshi, *Modern Albanian in Different Culture Contexts*, "Studia Albanica", 1984, nr. 2, f. 165-176.
3. R. Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi*, I, Prishtinë, 1984, f. 131-146.
4. Stilet funksionale i kuptojmë si variacione funksionale, përdorime të gjuhës, që kanë si tipar praninë e organizimit dytësor, ato janë modelime kulturore si tipizime shoqërore për përdorimin e gjuhës, që u përgjigjen kërkesave të ndryshme, duke përfshirë edhe variacionin e individit. Stilet janë shfaqje gjuhësore e formave të ndryshme të njohjes, të vetëdijes e të veprimtarisë shoqërore. Sistemi i tyre është i ndërvarur nga niveli i arritur dhe nga përbërja e strukturës së veprimtarisë social-kulturore të shoqërisë në një etapë të caktuar historike.
5. Xh. Lloshi, *Tipare të sistemit stilistik në gjuhën e sotme shqipe*, "Studime filologjike", 1985, nr. 1, f. 63-70.
6. Shih më hollësisht Xh. Lloshi, *The development of socio-political vocabulary of the Albanian Language after the Liberation of the Country*, "Studia Albanica", 1979, nr. 2, f. 105-114.

*Mbajtur si kumtesë në Kongresin e Gjashtë Ndërkombëtar të Studimeve për Europën Jug-Lindore, Sofje, 30 gusht-5 shtator 1989.*

*Botuar anglisht si përmbledhje me titullin The Albanian Literary Language, the Functional Styles and the Albanian Culture, në: Sixieme Congrès International d'Etudes du Sud-Est Européen, Sofia, 30 août - 5 septembre 1989. Resumes des communications. Sofia, 1989, f. 241-242.*

## GJUHA SHQIPE

1. Emërtim i. 2. Shtrirja e gjuhës. 3. Natyra e gjuhës.
4. Prejardhja. 5. Periodizimi. 6. Dialektet. 7. Struktura.
8. Fjalori. 9. Gjuha e shkruar. 10. Kundërshtia.

1. Emërtim i. Ne e quajmë sot veten tonë *shqiptarë*, vendin tonë *Shqipëri* dhe gjuhën tonë *shqipe*. Këta terma kanë hyrë në përdorim nga fundi i shek. XVII-fillimi i shek. XVIII.

Të huajt na quajnë ndryshe: *albanesi* (ital.), *Albaner* (gjerm.), *Albanians* (angl.), *alvanos* (greq.), *arbanasi* (serb. e vj.); për vendin përdorin: *Albania*, *Albanie*, *Albanien*, *Alvania*, *Albanija*, kurse për gjuhën: *albanese*, *Albanisch*, *Albanian*, *alvaniki*, *arbanaski*. Të gjitha këto fjalë vijnë nga emri i një fisi iliri dhe i qendrës së tyre *Albanopolis*, që dëshmohet nga astronomi i Aleksandrisë Ptolemeu në shekullin II. *Alban* mund të ketë qenë një shumës i *alb-/arb-*, që shënonte banorët e fushave (ÇABEJ 1976). Ky emër i kapërceu kufijtë e fisit ilir në Shqipërinë Qendrore dhe u përgjithësua për të gjithë banorët. Ata e quanin veten *arbënesh/arbëresh*, vendin *Arbëni/Arbëri* dhe gjuhën *arbëneshë/arbëreshë*.

Në gjuhët e tjera kanë mbijetuar emërtimet mesjetare, por vetë shqiptarët i zëvendësuan ato me *shqiptarë*, *Shqipëri* dhe *shqipe*. Rrënja e parë e këtyre fjalëve është ndajfolja *shqip*, që do të thotë “qartë, kuptueshëm”, siç dëshmohet që nga Buzuku. Ka një paralele semantike shumë të ngjashme me këtë në emërtimin *Deutsche* për

gjermanët dhe për gjermanishten (LLOSHI 1984). *Shqip* u përhap nga veriu në jug dhe *Shqipni/Shqipëri* mund të jetë një emër përmbledhës, që ndjek modelin e zakonshëm si *Arbëni/Arbëri*. Ky ndryshim ka ndodhur pas pushtimit osman, për shkak të kundërvënies në të gjithë vijën në sferat politike, shoqërore, ekonomike, fetare dhe kulturore me një botë tërësisht të huaj të tipit oriental. Kësaj iu përgjigj edhe një vetëdije e re më e përgjithësuar etnike dhe gjuhësore e të gjithë kësaj popullsie, e cila dallohej nga të huajt si një bashkësi njerëzish (*shqiptarë*), që e kuptonin qartë njëri-tjetrin, pra që e kuptonin njëri-tjetrin *shqip*. Ndajfolja mbizotëron në përdorim edhe sot e kësaj dite, kurse emri *shqipe* dhe togfjalëshi *gjuha shqipe* janë krijime të gjuhës së shkruar në shekullin e fundit.

Nuk ka asgjë shkencore në shpjegimin, sipas të cilit *Shqipëri* do të thotë “vendi i shqipeve” dhe *shqiptarë* “bijtë e shqipeve”.

**2. Shtrirja e gjuhës.** Gjuha shqipe flitet nga mbi shtatë milion veta, prej të cilëve rreth tre milionë e gjysmë banojnë brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, më shumë se dy milionë jetojnë në Kosovë, Maqedoni e Malin e Zi, pjesa tjetër në vende të tjera, kryesisht në Greqi, Turqi, Itali, Gjermani, SHBA, Zvicër. Këto shifra janë relative, për shkak të rrymës së madhe të mërgimit nga Shqipëria dhe Kosova në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të njëzetë.

Historikisht megjithatë duhen bërë disa dallime.

**a. Areali i shqipes** - përfshin gjithë viset e Shqipërisë dhe të trevave me vijim të pandërprerë në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Greqinë e Veriut, ku gjuha shqipe është folur në mënyrë të vijueshme që nga lashtësia. Mbi këtë zonë zbatohet ndarja dialektore e shqipes dhe kjo është treva historike, në të cilën evoluimi i kësaj gjuhe si një tërësi ka ndodhur gjatë periudhave të ndryshme.

**b. Diaspora** - përfshin shqiptarët, që mërguan deri në fund të periudhës së shqipes së mesme (jo më vonë se fillimi i shekullit të

tetëmbëdhjetë). Për këtë arsye, ata nuk e quajnë veten me emrin e ri *shqiptarë*.

Shqiptarët e Italisë, mërgimi në masë i të cilëve shkon pas në shekullin e pesëmbëdhjetë, e quajnë veten *arbëreshë* dhe shumica e tyre jetojnë ende sot në Italinë e jugut (Kalabri dhe Sicili).

Shqiptarët e Greqisë, mërgimi masiv i të cilëve shkon pas në shekullin e katërmëdhjetë, e quajnë veten *arbëreshë*, por grekët i quajnë *arvanites*. Ata janë vendosur në vijën bregdetare të Jonit, në Peloponez, rreth Athinës dhe në ishuj të ndryshëm të Greqisë. Ata duhet të dallohen nga *çamët*, të cilët i përkasin arealit të shqipes, ndonëse *arvanitika* - e folmja e arvanitëve është më e afërt me *çamërishten* si një nëndialekt i toskërishtes jugore.

Disa enklava të diasporës shqiptare janë në ish Jugosllavinë, në Bullgari e deri në Ukrainë.

Të folmet arbëreshe të diasporës përfaqësojnë një dialekt historik, me evoluim në një gjendje dygjuhësie dhe pa lidhje të drejtpërdrejtë me arealin e shqipes. Vetëm në gjysmë e dytë të shekullit të njëzetë variantet e shkruara të diasporës u orientuan drejt shqipes standard.

*c. Kolonitë* - përfshijnë shqiptarët, që janë vendosur në vendet e huaja nga fillimi i shekullit të tetëmbëdhjetë, tashmë duke pasur si gjuhë shqipen e re. Kolonitë më të mëdha janë krijuar në Turqi, Rumani, Shtetet e Bashkuara, Egjipt. Të folmet e tyre janë të ndikuara nga dygjuhësia.

*d. Emigrantët* që flasin shqipen e sotme dhe që janë arsimuar me shqipen standard. Që para Luftës II Botërore dhe veçanërisht në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit të njëzetë ndodhi një emigrim masiv i shqiptarëve, për shkak të konflikteve politike gjatë Luftës II Botërore, të politikës së spastrimit etnik dhe të shtypjes së shqiptarëve në ish Jugosllavinë, si dhe me rënien e komunizmit në Shqipëri.

3. Natyra e gjuhës. *Shqipja i përket familjes indoeuropiane të gjuhëve*, ajo përbën një degë të veçantë krejt më vete brenda kësaj familjeje. Përcaktimi shkencor i shqipes si gjuhë indoeuropiane është arritur relativisht vonë, nga F. Bopi më 1854. Hollësitë e korrespondencave kryesore të shqipes me gjuhët indoeuropiane u trajtuan nga G. Majeri në vitet 1880-1890. Me punën e tij është pranuar, se për shkak të disa ndryshimeve të lashta fonetike, si pasqyrimi i tingullit të shkurtër indoeuropian *o* në *a* në gjuhën shqipe, kjo gjuhë bën pjesë në grupin verior të gjuhëve europiane dhe dallohet nga gjuhët italike e greqishtja në pasqyrimin e bashkëtingëlloreve tektale. Janë vënë në dukje bashkëpërkime të lashta leksikore ndërmjet shqipes dhe gjuhëve balto-sllave, si dhe me greqishten, me armenishten etj., dhe veçanërisht ndërmjet shqipes dhe rumanishtes.

Një përpunim të mëtejshëm kanë arritur me ndihmesat e tyre gjuhëtarët H. Pedersen dhe N. Jokl. Pedersen (1900) ka treguar se në shqipen tre vargjet e lashta të tektaleve janë pasqyruar në mënyra të ndryshme dhe mbi këtë bazë *shqipja përfshihet në grupin e gjuhëve satem*, por me disa zhvillime të vetat të veçanta. Mund të pranohet se ajo bën pjesë në një zonë kalimtare të arealit indoeuropian qendror, ashtu si gjuhët balto-sllave dhe armenishtja. Ndër tiparet shquese të shqipes si gjuhë indoeuropiane janë ruajtja e polivalencës së mbaresave të lakimit dhe të zgjedhimit, temat dhe trajtat apofonike e supletive të foljeve.

Natyra indoeuropiane e shqipes vihet re në të gjitha nënsistemet e saj (Demiraj 1986, 1988). Janë ruajtur elementë të trashëguar në fjalorin e saj, p.sh., gjithë numërorët (me përjashtim të *qind* dhe *mijë*, që vijnë nga latinishtja) janë nga trashëgimia indoeuropiane. Te numërorët e përbërë të tipit *tridhjetë*, *pesëdhjetë* shqipja ka ruajtur modelin indoeuropian (*njëzet*, *dyzet* i përkasin sistemit të veçantë që quhet vigezimal, domethënë mbi bazën e njëzetës).

Përemrat vetorë dhe pronorë janë përgjithësisht me prejardhje indoeuropiane. Janë vënë në dukje ndërrime të lashta, si kalimi parahistorik o > a si te *natë*: a > o si te *motër* (nga kuptimi i vjetër për nënën), e e gjatë < o si te *tetë*. Ka gjurmë edhe të opozicionit të lashtë të zanoreve të gjata me zanoret e shkurtra etj.

Gjatë evoluimit trashëgimia indoeuropiane e shqipes ka pësuar ndryshime të vazhdueshme dhe *kjo gjuhë ka zhvilluar edhe disa tipare të reja të vetat*, disa prej të cilave nuk ndeshen gjatë. Në periudhën historike kanë ndodhur ndryshime të tjera në elementët e trashëguar të shqipes: shndërrimi i sistemit të vjetër me tri gjini në një sistem me dy gjini; mbaresat të përfuara të reja të foljeve vazhdojnë të jenë polisemike. Ndërmjet risive të përgjithshme që janë shfaqur në shqipen, mund të përmendeshin disa:

- ndërrimet morfonologjike e/ie ~ i (*hedh - hidhni*), metafoia (*dash - desh, dal - del*), apofonia (e/ie ~ o: *mbledh - mbledha*; a ~ o: *marr - mora*), diftongizimi i o (*ftua - ftoi*), palatalizimi i bashkëtingëlloreve fundore të temës në emrat në numrin shumë ( *breg - brigje, zog - zogi*);

- përftimi i një teme të veçantë të shumësit në kundërvënie me tipin e rregullt (*prind - prindër*);

- përftimi i një lakimi të dyfishtë, të shquar dhe të pashquar;

- pjesëza e paravendosur me rol trajtëformues dhe fjalëformues para mbiemrave, numërorëve themelorë e rreshtorë, emrave të farefisnisë dhe trajtave të gjinorës;

- përemrat pronorë të përngjitur për vetën I dhe II;

- riorganizimi i zgjedhimit jovepror dhe ndërtimi i trajtave të pashtjelluara të foljeve (*me punue, pa punuar*);

- në sintaksë: përcaktorët e lidhur vendosen pas emrave, kurse përcaktorët e lirë si rregull vendosen para emrave.

Si rrjedhim i evoluimit të ngadalshëm shqipja është shndërruar nga një gjuhë dikur sintetike, në *një gjuhë analitiko-sintetike*.

Pas librit të K. Sandfeldit *Linguistique balkanique* (1930) shqipja pranohet si një pjesëtare e rëndësishme e grupimit (*Sprachbund*) ballkanik. Ndër tiparet ballkanike ose *ballkanizmat* kryesorë të shqipes mund të renditen:

- prapavendosja e nyjës së shquar, një shfaqje e prirjes së vjetër të shqipes për t'i vendosur pas emrit gjithë përcaktorët e lidhur;

- trajtat e njëjta të gjinore dhe dhanore;

- rimarrja e kundrinës së drejtë e të zhdrejtë me anë të trajtava të shkurtra të patheksuara të përemrave vetorë:

- zhdukja e paskajores, të zëvendësuar me lidhoren ose me trajta analitike;

- formimi i së ardhshmes me ndihmën e foljes *dua*, që ka përfunduar në një pjesëz *do* + lidhoren.

Kështu, shqipja mund të karakterizohet si *një gjuhë indoeuropiane ballkanike*.

Në trevën e Ballkanit shqipja u është nënshtruar ndikimeve të gjuhëve të tjera. Me gjithë trysinë e ndjeshme të greqishtes, latinishtes, sllavishtes dhe turqishtes, *shqipja i ka ruajtur tiparet e veta të qenësishme*. Siç e ka përmbledhur prof. Sh. Demiraj (1988): “Shqipja mund të karakterizohet si një gjuhë i.e., që ka ndjekur një rrugë evolucioni të vetën edhe në ato raste kur ajo shfaq bashkëpërkime me këto apo ato gjuhë të tjera simotra”. (f.53).

**4. Prejardhja.** Ndërmjet studiuesve shqiptarë praktikisht nuk ka ndonjë diskutim për tezën, që shqipja lidhet me ilirishten. *Gjuha shqipe është pasardhëse e drejtpërdrejtë e një grupi jugperëndimor dialektesh ilire*. Por janë paraqitur edhe hipoteza të tjera, ndërmjet të cilave e vlen të përmenden këto më poshtë.

**a. Hipoteza pellazgjike.** Shqipja është vazhduese e një gjuhe të një populli shumë të lashtë, të quajtur pellazgët, një hipotezë që ka qenë mjaft e përhapur në shekullin e nëntëmbëdhjetë. J.G. von Hahn (1854) e formuloi në mënyrë të prerë, që shqiptarët janë

pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve. maqedonasve dhe epirotëve. dhe së bashku me latinët e helenët ata përbënin në kohë shumë të largëta një popullsi të përbashkët. të quajtur pellazgët. me gjuhën e tyre. pellazgishten. A. Schleicher me drurin e tij të familjes së gjuhëve i dha edhe autoritet teorisë së prejardhjes pellazge. Sot kjo quhet një ide e pambështetur.

*b. Hipoteza trake (dake).* Shqipja është pasardhëse e trakishtes. Kjo tezë, që nënkupton një simbiozë shqiptaro-rumune, mbështetet sidomos nga studiuesit e rumanishtes: H. Hirt, K. Paul, G. Vajgand, H. Bariç, I. Popoviç, I.I. Russu etj. Po nga trakishtja ka vetëm disa dëshmi të pakta, megjithatë H. Hirti i quante shqiptarët si pasardhës të trakëve. Kjo do të thotë se në fillimet e mesjetës shqiptarët janë zhvendosur drejt perëndimit nga një trevë qendrore e Ballkanit, mirëpo nuk ka ndonjë gjurmë historike, që të mbështesë një shpërngulje kaq të madhe. Për H. Bariçin shqipja është një dialekt trak i ilirizuar.

*c. Hipoteza iliro-trake.* Shqipja e ka prejardhjen nga një përzierje e ilirishtes me trakishten. N. Jokli mbështeste idenë e një pozite të ndërmjetme të shqipes midis ilirishtes e trakishtes. Mirëpo trakishtja nuk njihet më mirë se ilirishtja dhe prandaj është e vështirë të dallosh elementët e veçantë të të dyjave, as vijën ndarëse ndërmjet ilirishtes dhe trakishtes. Për Joklin shqiptarët janë ndoshta pasardhës të fisit ilir të dardanëve, që kanë jetuar në brendësi të Gadishullit të Ballkanit, por janë zhvendosur drejt perëndimit nga fundi i epokës romake.

*d. Hipoteza dako-mize* mbështetet nga akademiku bullgar V.I. Georgiev.

*e. Hipoteza e pavarur.* Shqipja përbën një gjuhë indoeuropiane të veçantë, siç pohon H. Krahe. Puna e gjerë e prof. E. Çabejt për etimologjinë e shqipes (1976), një sintezë e pashoqe e gjithçkaje të njohur në këtë fushë, u referohet periudhave të lashta të shqipes si



një gjuhë indoeuropiane. pa e ndërfutur ilirishten. Po të ndiqej një metodë e rreptë, etimologjite e shqipes duheshin çuar prapa te format e ilirishtes. të cilat nga ana e tyre do të ndiqeshin prapa deri te rrënjët indoeuropiane, ashtu si etimologjite e fjalëve italiane çohen te format latine. E. Hamp (1972) pohon: "Shqipja nuk tregon ndonjë afri të dukshme të afërt me ndonjë gjuhë tjetër indoeuropiane: duket qartë se ajo është pasardhësja e vetme e sotme e nëngrupit të vet".

E gjithë kjo çështje lidhet ngushtë me problemin e trevës, ku është formuar shqipja, si dhe e vendit ku ka ndodhur shndërrimi i saj. Nuk është e rastit që prejardhja ilire e shqipes është paraqitur mbi baza historike nga H.E. Thunmann më 1774. Gjetjet arkeologjike të ditëve tona e mbështesin teorinë e autoktonisë së shqiptarëve, ndërsa midis mbështetësve të teorisë së prejardhjes ilire ka shumë historianë. Vazhdimësia e po asaj kulture materiale në po atë trevë është një fakt i provuar. Por argumentimi gjuhësor nuk është shumë i qenësishëm.

Gjuha ilire njihet vetëm nga disa fjalë të dhëna nga autorët antikë, nga disa mbishkrime të rralla dhe në një masë më të madhe nga emrat që na kanë mbërritur të njerëzve dhe të vendeve. Me gjithë studimet e shquara të H. Krahe, A. Ribezzo, A. Mayer dhe të tjerë, çështja e vendit që zënë ilirët në familjen indoeuropiane mbetet e diskutueshme. Shumë historianë e gjuhëtarë gjermanë, austriakë dhe italianë etj. e kanë mbështetur prejardhjen ilire të shqipes: G. Meyer, F. Miklosisch, H. Pedersen, P. Kretschmer, V. Pisani, W. Cimochofski dhe të tjerë.

Gjuhëtarët shqiptarë përgjithësisht: E. Çabej, S. Riza, M. Camaj, Sh. Demiraj, M. Domi, A. Kostallari, mbrojnë autoktoninë e shqiptarëve dhe vazhdimësinë iliro-shqiptare të gjuhës. Shqipja u formua nëpërmjet një evoluimi gradual të një grupi jugperëndimor dialektesh ilire gjatë periudhës ndërmjet fazës së fundit të ndikimit intensiv të latinishtes mbi ilirishten dhe ardhjes së sllavëve. Ky

proces i gjatë e mjaft i ndërlikuar ka ndodhur në shekujt e parë të erës sonë. Argumentet gjuhësore, të paraqitura nga kundërshtarët e prejardhjes ilire të shqipes nuk i qëndrojnë kritikës. Sh. Demiraj (1988): "Në dritë të këtyre fakteve mund të pohohet pa mëdyshje se gjuha shqipe është formuar, në vija të përgjithshme, në trevat e banuara nga shqiptarët në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit, ku në kohë të vjetra banonin fise ilire, që përbënin popullsinë mbizotëruese të këtyre trevave". (f.196).

**5. Periodizimi.** Janë paraqitur skema të ndryshme për periodizimin e gjuhës shqipe, të bazuara në kritere të ndryshme gjuhësore dhe historike: H. Pedersen, E. Çabej, S. Riza, A.V. Desnickaja, B. Bokshi, Xh. Lloshi, Sh. Demiraj. Problemi bëhet mjaft i ndërlikuar, nëse shihet i lidhur me hipotezat e ndryshme për prejardhjen e kësaj gjuhe. Nëse i përmbahemi mendimit për një prejardhje të pavarur, atëhere proto-shqipja do të kishte një periudhë të *shqipes arkaike*, që do të shërbente si hallka e parë e periodizimit. Përndryshe, proto-shqipja do të identifikohet me ilirishten, me trako-ilirishten etj. Në këto rrethana, zgjidhja më e pranueshme do të ishte që periodizimin ta nisnim me shekujt e parë të erës së re.

**1. Shqipja e vjetër** - deri në shek. 8-9. Kjo periudhë përfshin historinë e vonshme të gjuhës mëmë dhe shndërrimin e saj në shqipën e mirëfilltë. Në këtë kohë u përvijuan dy dialektet e saj kryesore dhe përfundoi rotacizmi. Me rishfaqjen e emrit etnik të shqiptarëve në shekullin e dhjetë, identiteti i gjuhës së tyre *arbëreshe* konsolidohet përfundimisht. Ka shumë pak të ngjarë që të ekzistojnë dokumente të shkruara në gjuhën arbëreshe të kësaj periudhe.

**2. Shqipja e mesme** - deri në shekullin e 17-të. Emërtimi *arbëreshe* pak nga pak u përhap mbi gjithë trevën e shqipes. Tashmë kjo gjuhë nuk është në kontakt me greqishten e vjetër dhe latinishten, por me gjuhë të tjera dhe me etapa të ndryshme të këtyre gjuhëve gjatë evoluimit historik. Që nga kjo kohë shqipja ka marrëdhënie

me italishten, greqishten e mesme, bullgarishten, serbishten, turqishten. Bashkë me lëkundjen e Perandorisë Bizantine në shekullin e dymbëdhjetë u ngrit si forcë politike klasa feudale arbëreshe dhe u krijuan principatat e Arbërit. Në këto rrethana, kur edhe popullsia, edhe klasa drejtuese ishin vendëse, lindi kërkesa historike për ta shkruar gjuhën shqipe. *Shqipja u bë gjuhë e shkruar*. Ndryshimet dialektore të kësaj periudhe janë më të vogla se në periudhën e mëvonshme. Pas pushtimit osman pati një vërshim të huazimeve orientale, por kundrejt gjendjes së re shqipja reagoi tashmë me pjesëmarrjen e kulturës reflekse. Kërkesa për lëvrimin e gjuhës amëtare u bë më e mprehtë tashti, kur ajo merri misionin për të mbrojtur kulturën kombëtare.

3. *Shqipja e re* deri në ditët tona. Duke nisur me shekullin e 18-të gjuha tashmë njihet me emrin e ri *shqip*. Duke nisur nga kjo kohë lëvrimi dhe ngulitja e gjuhës letrare del si problemi qendror dhe zhvillimi i përgjithshëm varet prej tij. Madje edhe çështja e huazimeve bëhet gjithnjë e më tepër një aspekt i orientimit kulturor. Duhet veçuar dy faza të rëndësishme: *faza e Rilindjes* (afërsisht 1820-1920) dhe *faza e shqipes së sotme* (pas 1920), ose *gjuha e sotme shqipe*.

Në tre dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të njëzetë *shqipja standard* është bërë një realitet praktik, një mjet themelor për shprehjen e kulturës kombëtare për të gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë kufijve politikë të shtetit shqiptar.

6. **Dialektet.** Shqipja flitet në një numër variantesh gjeografike, të cilat ndahen në dy grupe kryesore dialektesh:

I. Dialekti i veriut ose *gegërishtja*, në veri të lumit Shkumbin.

II. Dialekti i jugut ose *toskërishtja*, në jug të lumit Shkumbin.

Ndërmjet tyre ka një grup dialektor kalimtar në të dy anët e Shkumbinit.

Emërtimet për dallimet krahinore *Gegë* dhe *Toskë* u përhapën në gjysmën e dytë të shekullit të tetëmbëdhjetë, pasi u konsolidua

emri kombëtar *shqiptarë* për të gjithë banorët e krahinave të ndryshme të vendit.

Gegërishtja ndahet në dy nëndialekte: gegërishtja e veriut dhe gegërishtja e jugut. afërsisht në të dy anët e lumit Mat. Po të vazhdohet më tej ndarja, del se *Gegërishtja Veriore* ndahet në grupin veriperëndimor, duke përfshirë edhe shqipen e folur në Malin e Zi, dhe në grupin verilindor, duke përfshirë edhe shqipen e folur në Kosovë. *Gegërishtja Jugore* ndahet në grupin e gegërishtes qendrore, që përfshin edhe pjesën më të madhe të shqipes së folur në Maqedoni, dhe në gegërishten e Shqipërisë së Mesme, që përfshin edhe Tiranën.

Toskërishtja ndahet në dy nëndialekte gjithashtu: *Toskërishtja Veriore* dhe *Toskërishtja Jugore*, afërsisht në të dy anët e lumit Vjosa. Me një ndarje të mëtejshme, *Toskërishtja Jugore* ndahet në grupin e *Labërishtes* dhe në *Çamërishten*, që përfshin edhe një zonë të Greqisë veriperëndimore, por kjo nuk duhet përzier me arvanitët ose arbëreshët e Greqisë. Për dialekteologjinë shih J. Gjinari, 1989.

Ndryshimet dialektore ndërmjet gegërishtes e toskërishtes janë të pakta. Ato që bien më tepër në sy janë:

- zanore hundore në gegërishten, mungesa e tyre në toskërishten (*bā - bēj*);

- **zanore të gjata në gegërishten me vlerë fonologjike, mungesa e tyre në toskërishten;**

- ë shumë e dendur në toskërishten, edhe në pozicion të theksuar, që mungon në gegërishten dhe së cilës në disa pozicione i përgjigjet â hundore (*hân - hënë*);

- ue diftong ose u në gegërishten, së cilës i përgjigjet ua në toskërishten (të gjitha me prejardhje nga diftongizimi *uo > o*, (*due, du - dua; grue, gru - grua*);

- togu i fillimit *vo-* në një numër të vogël rastesh në gegërishten, të cilit i përgjigjet *va-* në toskërishten (*voj - vaj*);

- në gegërishten një -n- ndërzanore. Së cilës në toskërishten i përgjigjet rotacizmi me -r- (*ranë - rërë. venë - verë*);
- bashkëtingëlloret e zëshme të gegërishtes në fund të fjalëve dëgjohen të pazëshme në toskërishten (*kalb - kalp. i madh - i math*);
- togjet e bashkëtingëlloreve *mb. nd. ng. ngj* në toskërishten dëgjohen si dy tinguj të shquar, kurse në gegërishten reduktohen në *m. n. nj* (*nbush- mush; vënd - ven. ngas - nas; ngjesh - njesh*);
- tingulli ndërzanor nj i toskërishtes rrëgjohet në j në gegërishten (*rrënjë - rrái*);
- trajtave të së pakryerës së gegërishtes me *-sha, -she* u përgjigjen në toskërishten *-njã, -nje* (*punojsha - punonja*);
- huazimet nga turqishtja në gegërishten dalin me theks parafundor, kurse në toskërishten kanë ruajtur theksin e burimit në fund (*ag - agá. káfe - kafé*);
- ndryshime në disa trajta të shquara të emrave në ue/ua: gegërisht *thue - thoni*, toskërisht *thua - thoi*;
- gegërishtja i ruan mbaresat e foljeve me temë në bashkëtingëllore, toskërishtja i humbet mbaresat (*un hapi - unë hap*),
- toskërishtja i ruan mbaresat e pjesoreve, gegërishtja i humbet mbaresat (*hapur - hap; larë - la*);
- në gegërishten është i pranishëm përemri vetvetor *i vet*, në toskërishten mungon;
- në gegërishten ka një trajtë që merret si paskajore (*me shkue*), e cila mungon në toskërishten dhe zëvendësohet me një tog tjetër (*për të shkuar*);
- gegërishtja ka edhe një trajtë të së ardhshmes me foljen ndihmëse “kam” plus paskajoren e foljes (*kam me shkue*), që mungon në toskërishten;
- gegërishtja ka mbiemra prejfoljorë për të shprehur mundësinë me prapashtesën *-shem*, duke bërë dallimin me mbiemrat prejfoljorë nga pjesorja (*i punueshem - i punuem*).

Përgjithësisht, toskërishtja ka qenë më rinovuese në periudhën e mëparshme. ndërsa gegërishtja është sot më reduktuese. Gegërishtja dhe toskërishtja janë të kuptueshme ndërmjet tyre dhe në një vend të vogël, me lëvizje të mëdha demografike të kohëve të fundit ndarjet e vjetra krahinore po bëhen gjithnjë e më konvencionale. Dialektet historike që fliten në enklavat arbëreshe në Itali dhe Greqi pasqyrojnë prejardhjen nga toskërishtja.

**7. Struktura.** Struktura e shqipes, në veçanti kategoritë gramatikore dhe sintaksa janë mjaft të ngjashme me ato të gjuhëve të tjera europiane.

Shqipja standard ka 7 zanore të thjeshta (*a, e, ë, i, o, u, y*) dhe 29 bashkëtingëllore. Ato paraqiten me shkronja latine njëshe dhe të bashkuara me *h* (*dh, sh, th, xh, zh*) dhe me *j* (*gj, nj*), të dyfishuara (*ll, rr*) dhe me shenja diakritike (*ç, ë*). Bashkëtingëlloret ndahen në të zëshme (*b, v, d, z, x, xh, zh, dh, gj, g*) dhe në të shurdhëta (*p, f, t, s, c, ç, sh, th, q, k, h*), si dhe në sonante (*m, n, nj, r, rr, l, ll*).

Theksi është i ngulitur dhe, me përjashtime të rralla (si: *i madh - të mëdhenj*) nuk ndryshon vendin. Një fjalë tipike e shqipes është një dyrrrokëshe paroksitone me ritëm trokaik. Edhe fjalët njërrrokëshe në trajtat e tyre të shumta dhe të ndryshme gramatikore dalin më së shumti si fjalë dyrrrokëshe të këtij modeli, p.sh., *mal* shndërrohet në trajtën e shquar në *mali* dhe gjatë lakimit në *malit, malin*, në shumës në *male, malet, malesh*. Po e njëjta gjë ndodh me foljet, p.sh., *pi* gjatë zgjedhimit del *pimë, pini, pinë, pija, pinte, piva, piu, pirë* etj.

Fonetika e gjuhës shqipe është botuar më 1984. Sh. Demiraj ka botuar më 1996 *Fonologjia historike e shqipes*.

**Morfologjia.** Gramatika e shqipes standard dallon 10 pjesë të ligjëratës.

*Emrat* kanë kategori të dallueshme të gjinisë, numrit dhe të pesë rasave. Në trajtën e shquar emrat mashkullorë shtojnë

prapashtesën nyje ɹ (*det.* - *i*) ose ɹu (*krah.* - *v*): emrat femërorë shtojnë ɹa (*liri.* - *a*). Trajtat asnjane po bëhen të vjetruara dhe dallohen nga shtimi i nyjës njëjës -t(ë), -it (*ujë.* - *t. te ecur.* - *it*), që edhe zëvendësohet për t'u bërë emra mashkullorë (*ujë* - *uji*). Ndërkaq, lakimi i emrave asnjane është i njëjtë me lakimin e emrave mashkullorë.

Shumësi i emrave dallohet për parregullsinë e mjaft rasteve. Një grup emrash mashkullorë del i njëjtë me shumësat e femërorëve dhe pajtohet me mbiemrat në gjininë femërore, një shenjë kjo se në shumës ideja e gjinisë vjen duke u shuar (*male të larta.* ashtu si femërorja *shtëpi të larta*). Për të tria gjinitë kemi -t(ë) në shumësin e shquar.

Sistemi i rasave është ruajtur mirë. Nga pesë rasat, emërorja dhe kallëzorja janë të njëjta për trajtën e pashquar njëjës e shumës, po kështu janë gjinorja dhe dhanorja, njëjës e shumës (em. *burrë*, kall. *burrë*, gjin. *burri*, dhan. *burri*). Rrjedhorja njëjës është e njëjtë me dhanoren njëjës (*burri*); rrjedhorja shumës mund të mbarojë edhe në -sh (*burrave*, *burrash*), dhe ashtu si njëjësi funksionon pothuaj si mbiemër (*mur guri* do të thotë mur i gurtë; ose *sëmundje* *grash*). Nyja prapashtesë i jep shqipes një komplet të dalluar mbaresash, që e bën emrin e shqipes të ketë një paradigme të veçantë për trajtën e shquar. Një veçanti tjetër është pjesëza lidhëse, që e bashkon një emër me gjinoren pasuese dhe që ka një varg tiparësh të përbashkëta me nyjën shquese të prapavendosur (*shtëpia e babait*, *shtëpisë së babait*).

*Mbiemrat* janë të dy llojeve: a) Mbiemra të paraprirë nga pjesëza lidhëse (*i ëmbël*, *e ëmbël*). Prania e mbiemrave me pjesëzën e paravendosur nuk ndeshet në gjuhët e tjera europiane. Këta mbiemra janë të pandryshueshëm, me përjashtim të disa rasteve kur formojnë femëroren dhe shumësin, e kanë prejardhjen nga emra, ndajfolje, pjesore (*i mirë*, *i djeshëm*, *i shkruar*). b) Mbiemra të thjeshtë, pa

pjesëz përpara, që vijnë nga emra, mbiemra të tjerë, folje, duke përfshirë edhe mbiemra të përbërë (*trim, emëror, bukurosh, kërkues, zemërmadh*). Mbiemrat nuk ndryshojnë kur janë prapa emrave, vetëm pjesëza e mbiemrave të nyjshëm pajtohet me emrin paraprirës. Mbiemrat vihen para emrave për arsye emotive ose për theksim stilistik: në këto raste ata marrin epimin e emrit, ndërsa emri që vjen pas nuk ndryshon. Pjesa më e madhe e mbiemrave mund të emërzohen drejtpërdrejt.

*Foljet* kanë afërsisht të njëjtën larmi trajtash si në italishten dhe frëngjishten dhe kanë mjaft raste parregullsish në formimin e tyre. Sistemi i foljeve përfshin shumë tipare të vjetra, si ruajtja e mbaresave të dalluara për vepronen dhe mesoren (si në greqishten) dhe ndërrimin e zanores së temës g të së tashmes në o (nga \*e) në të shkuarën, një tipar që e kanë edhe gjuhët baltike: *mbledh - mblodha* (Hampi, 1972).

Foljet e shqipes kanë gjashtë mënyra: dëftore, lidhore, kushtore, dëshirore, habitore, urdhërore, si dhe format e pashtjelluara: pjesorja, përcjellorja, paskajorja. Paskajorja e gegërishtes *me + pjesoren* është e pranishme në togfjalësha të ndryshëm të shqipes standard (*domethënë, meqenëse, duke qenë se*); asaj i përgjigjet forma e toskërishtes *për të + pjesorja*. Mënyra habitore është e veçantë për shqipen. E tashmja përbëhet nga pjesorja e shkuar + *kam* (*punokam*). Shqipja ka vetëm një pjesore të pësores, ndërsa trajta veprone ndeshet te mbiemrat dhe emrat e veprimit (*kërkues* ai që kërkon dhe që e bën kërkimin, jo që kërkohet). Mënyra dëftore është e pasur me kohë; e kryera e thjeshtë dallohet nga e pakryera dhe nga kohët e kryera të përbëra. Ka gjithashtu disa forma analitike të tjera: *pa bërë, me të bërë, një të bërë, së bëri*.

Gramatikat e shqipes përfshijnë si përemra 7 grupe: vetorët, vetvetorët, dëftorët, pronorët, pyetësit, lidhorët, të pacaktuarit. Përemrat vetorë nuk janë të domosdoshëm në ndërtimin e një fjalie,



siç janë në gjermanishten, anglishten e frëngjishten, kurse në gjuhën e folur shpesh bien. Ata kanë trajtat e shkurtra në dhanore e kallëzore, mjaft të ngjashme me frëngjishten. Trajtrat e shkurtra paravendosen dhe mund të ngjiten prapa trajtave të urdhërores: *ia jep - jepia*. Veta e tretë e përemrave vetorë: *ai, ajo, ata, ato* shërben edhe si përemër dëftor, duke pasur si përgjegjëse për të shënuar dikë e diçka afër: *ky, kjo, këta, këto*. Në rastet kur anglishtja dhe gjermanishtja përdorin një përemër vetor të vetës së tretë asnjans ( *it, das*) shqipja shfrytëzon trajtat e femërores: *ajo, kjo*. Përemrat pronorë ndjekin emrin që përcaktojnë, por për vetën I dhe II me emrat e farefisnisë mund të vendosen edhe para këtyre emrave (*im bir - biri im, por vetëm libri im*). Ata lakohen si mbiemrat, domethënë pajtohen me emrin në gjini e numër. Por trajtat e përemrave pronorë janë mjaft të ndërlikuara, sepse shënojnë njëkohësisht pronën dhe pronarin.

Një tipar i veçantë i shqipes është përdorimi i parafjalëve me emrat në rasën emërore (*nga, te*), si dhe me disa ndajfolje (*për, deri*).

**Sintaksa.** Ndërtimi i fjalisë në gjuhën shqipe nuk ndryshon shumë nga ndërtimi në gjuhët e tjera të Europës, kurse gjuha e shkruar është e ndikuar mjaft prej tyre. Rendi i fjalëve është relativisht i lirë, ndërsa kryefjala nuk është e detyrueshme. Përcaktorët e lidhur vendosen pas emrave, kurse përcaktorët e vetëmjaftueshëm vendosen para emrave (*ky djalë, disa djem*). Kur një emër i shquar ose një që merret tashmë i njohur del si kundrinë e drejtë, duhet që në togfjalëshin foljor të futet një përemër në kallëzore, që ta përsërisë këtë informacion.

Disa aspekte të tjera të ndërtimit të shqipes janë përmendur edhe në raste të tjera këtu.

Gramatika akademike e shqipes është botuar më 1976, botimi i dytë i rishikuar ka dalë më 1995 (*Gramatika e gjuhës shqipe*); sintaksa është botuar më 1976 dhe 1983 (*Sintaksa*).

8. **Fjalori.** Bërthama e fjalorit të shqipes, domethënë pjesa që përbën natyrën e saj të veçantë, përfshin grupin e fjalëve të trashëguara nga gjuha e prejardhjes indoeuropiane (shih: **Prejardhja**). Është e kuptueshme, që ka edhe disa fjalë me origjinë paraindoeuropiane, por veçimi i tyre do të ishte një punë shumë e vështirë. Kjo trashëgimi është pasuruar vazhdimisht me fjalë të prejardhura, të përbëra e të përngjitura gjatë vetë evoluimit të shqipes, si edhe duke u krijuar fjalë të reja. Një pjesë të rëndësishme të leksikut të shqipes e përbëjnë togfjalëshat dhe idiomat, veçanërisht në gjuhën e gjallë të folur. Një grup prej nja pesëdhjetë foljesh e emrash ka një rreth shumë të gjerë togfjalëshash frazeologjikë.

Së bashku me fjalët e zakonshme indoeuropiane (*afër, at, bar, bëj, i butë, çel, diell, dimër, djeg, dhëndër, gjarpër, ha, jam, kam, marr, mirë, natë, pesë, them, i vogël etj.*) nga paraardhësja e saj shqipja ka trashëguar disa huazime të lashta nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja. Sipas A. Thumb (1926) nuk ka pasur më shumë se 20 elementë të greqishtes së vjetër me prejardhje dorike në shqipen, por kjo listë prej atëhere është shtuar.

Numri i fjalëve latine në shqipen është relativisht i madh. Kjo është pasojë e sundimit të gjatë romak, e administratës së gjatë politike e ushtarake, e pranisë së kampeve ushtarake (*castra*), e veteranëve, kolonistëve, e rrugëve të ndërtuara në thellësi të vendit, por gjuha shqipe ka shpëtuar nga romanizimi. Shtresa më e vjetër e elementëve latinë ka depërtuar në gjuhën “mëmë” para erës së re. Përmes huazimeve latine kanë depërtuar edhe disa ndajshitesa fjalëformuese (Çabej 1974). Huazimet latine me trajtat e tyre në shqipen dëshmojnë për ngjashmëritë e zhvillimit të latinishtes në Ballkan dhe veçanërisht në rumanishten.

Një çështje mjaft interesante dhe e ndërlikuar është prania e korrespondencave të vjetra leksikore shqiptaro-rumune, që shkojnë

prapa në një periudhë para ardhjes së sllavëve. Sipas prof. Çabej (1975) ato mund të shpjegohen me fqinjësinë e gjatë. Sh. Demiraj (1988) mendon se fjalët e kësaj shtrese të lashtë mund të jenë pjesërisht nga fondi i përbashkët indoeuropian për shqipen nga gjuha "mëmë" dhe për substratin e rumanishtes, pjesërisht ato mund të kenë depërtuar nga njëra gjuhë te tjetra dhe disa mund të jenë trashëguar nga një gjuhë më e lashtë e Ballkanit. Prania e një popullsie të madhe shtegtuese të arumunëve (vllehve) në Shqipërinë juglindore është gjithashtu një faktor, që nuk mund të përjashtohet. Gjatë mesjetës, duke përkuar me periudhën e shqipes së mesme, ndikimi roman vazhdoi në brezin bregdetar në fillim kryesisht nga dialekti venecian, kurse huazimet greke depërtonin në shqipen kryesisht nëpërmjet gjuhës së folur në dialektin jugor të shqipes. Por lindën dy faktorë të rinj për shkak të vërshimit sllav dhe të pushtimit osman.

Hyrja e sllavizmave në shqipen duhet të ketë nisur pasi kishte pushuar rotacizmi në dialektin jugor të shqipes. Huazimet sllave u përkasin shtresave të ndryshme kronologjike dhe gjeografike. Sllavizmat e dialekteve të shqipes së mesme dhe jugore janë me prejardhje bullgare, ndërsa ato të shqipes veriore janë me prejardhje serbe. Ndikimi i rusishtes është ndier mbi gjuhën e shkruar pas Luftës II Botërore, veçanërisht nëpërmjet kalkimeve.

Fjalët e para të ardhura nga turqishtja datohen që nga fundi i shekullit të 14-të, por pjesa më e madhe e tyre ka hyrë në shqipen pas shekullit të 17-të. Orientalizmat u pranuan bashkë me mënyrën orientale të jetesës, kurse zëvendësimi i tyre ka qenë synimi kryesor i prirjeve puriste të lidhura me lëvizjen e Rilindjes Kombëtare (gjysma e dytë e shekullit të 19-të). Statusi i orientalizmave në shqipen e sotme është mjaft i ndërlikuar dhe i pasur me mundësi stilistike.

Gjatë dy shekujve të fundit fjalori i shqipes është pasuruar intensivisht me neologjizma dhe huazime të shumta. Janë përvijuar

dy prirje të kundërta. E para ka qenë pastrimi nga shumë huazime turke, greke, sllave dhe romane. Por nga ana tjetër, huazimet neolatine (nga italishtja dhe frëngjishtja e sotme) e në kohët e fundit edhe nga anglishtja kanë vërshuar në gjuhën e shkruar, të kërkuara nga teknologjia, shkencë, kultura, arti, jeta politike dhe shoqërore, si dhe duke pasur mbështetje nga televizioni dhe mjetet e komunikimit masiv. Në shqipen ka fjalë ndërkombëtare po në atë masë, si edhe në gjuhët e tjera europiane.

Fjalori më i gjerë është *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, botuar më 1980 nga Akademia e Shkencave.

**9. Gjuha e shkruar.** Përpyekjet e para për ta shkruar shqipen duhen gjurmuar në shekujt 12-13. Është e kuptueshme, që dokumentet e para do të kenë qenë shkrime tregtare, ekonomike, administrative e fetare, të hartuara nga klerikë të zakonshëm. Një at domenikan, Guillelmus Adae, i njohur gabimisht si murgu Brokard, në një relacion të vitit 1332 ka vënë në dukje se : “Shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinishtja, por ata kanë në përdorim dhe në gjithë librat e tyre shkronjën latine” Në një dorëshkrim dekretesh e urdhrash, të hartuar më 1462 nga Pal Engjëlli, kryepeshkop i Durrësit dhe bashkëluftëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, gjejmë të parën fjali të shkruar shqip, një formulë pagëzimi.

Libri i parë në gjuhën shqipe, me sa e kemi të dokumentuar deri më sot, është botuar më 1555 nga Gjon Buzuku me titullin *Meshari*. Fjalori i parë i botuar është një fjalor dygjuhësh latinisht-shqip i Frang Bardhit më 1635. Po në atë shekull të shtatëmbëdhjetë u botua një varg librash të tjerë me tema fetare didaktike. Deri në shekullin e 18-të botimet kanë qenë të pakta, por u shtuan në mënyrë të dukshme në shekullin e 19-të me ardhjen e lëvizjes së zgjimit kombëtar. Dhiata e re e parë shqip u botua më 1827. Futja e shqipes në shërbesat fetare është parë si një hap drejt identitetit kulturor

kombëtar. Prodhimi letrar vijoi gjatë gjithë shekullit të 19-të të arbëreshët e Italisë.

Shqipja e shkruar e shekullit të 19-të nuk ka qenë një vazhdim i thjeshtë i traditës së mëparshme. Një numër problemesh të lidhura me të u rishtruan dhe kushtet për zgjidhjen e tyre nuk kanë qenë të favorshme deri më 1912, kur u fitua pavarësia nga sundimi osman. Problemi gjuhësor zinte një vend qendror në programet e Rilindjes Kombëtare. Por nuk ishte pjekur koha për të shtruar kërkesën e një gjuhe të vetme standard, e sidomos në një vend, ku nuk kishte qendra botimi e shtypjeje, ku nuk kishte shkolla e gazeta deri në fund të shekullit të 19-të. Mund të dallohen tri faza kryesore në procesin e kristalizimit të shqipes së shkruar letrare.

**1. Rilindja Kombëtare** nga dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të 19-të deri në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të 20-të. Rilindja ishte një orientim kulturor i caktuar, që vinte në qendër unitetin kombëtar. Në kulturën shqiptare përgjithësisht kjo periudhë përkon me mbizotërimin e romantizmit.

Mbi bazën e dy dialekteve kryesore u përfatuan dy variante letrare kryesore; brenda këtyre kishte një larmi përdorimesh të gjuhës. Autorët e kohës i njihnin variantet e njëri-tjetrit dhe nuk kishte ndonjë prirje të shfaqur për rivalitet midis tyre. I pari autor që e ka ndjekur në mënyrë të vetëdijshme këtë ndarje ka qenë K. Kristoforidhi, i cili i ka botuar përkthimet e tij nga Bibla në të dy variantet njëkohësisht. Kurorëzim i kësaj periudhe ka qenë Kongresi i Manastirit më 1908, i cili hodhi bazat për zbatimin e alfabetit mbi bazë latine, që përdoret sot në Shqipëri, pas një periudhe të gjatë me shumë alfabete, që janë përdorur në përputhje me orientimet kulturore e politike të autorëve përkatës.

**2. Pavarësia** që nga fundi i Luftës I Botërore deri në fund të Luftës II Botërore afërsisht. Kjo periudhë hapet me një ngjarje shumë të rëndësishme: më 1916-1917 u thirr në Shkodër një Komisi

Letrare. U morën një varg vendimesh për drejtshkrimin e shqipes. Parimi bazë i Komissisë për drejtshkrimin ishte fonetik, domethënë grafema e një fjale duhet t'i përshtatet shqiptimit të saj. U miratuan dy grupe rregullash të ndryshme për dy variantet kryesore letrare, duke i afruar ato sa më tepër ishte e mundshme. Varianti i gegërishtes jugore të Elbasanit, me disa përmirësime, u propozua si baza për konvergencën e ardhshme graduale të dy varianteve në një shqipe letrare të njësuar. Që nga kjo kohë drejtshkrimi dhe gjuha letrare u bënë sinonime për publikun e gjerë shqiptar. Vendimet e Komissisë Letrare të Shkodrës përbëjnë një kapërcyell për në fazën e re të shqipes së re: *shqipja e sotme*.

Por çështja tani shtrohej në rrethana të tjera. Pas Pavarësisë faktorët e brendshëm socio-politikë morën gjithnjë e më shumë përparësi. Në orientimet kulturore romantizmi u zëvendësua nga realizmi. U kuptua se zgjedhja e variantit standard nuk bazohej vetëm në kriteret gjuhësore ose estetike, por edhe në kriteret politike, shoqërore dhe kulturore. Duke qenë ende të ushqyer me idealet e periudhës së Rilindjes, shqiptarët miratuan më 1920 në Kongresin e Lushnjes hullinë e vendosur në Shkodër. Me një dekret të vitit 1923 varianti i Elbasanit u shpall "gjuha shqipe zyrtare". Ky nënvariant pati një farë ndikimi deri në fund të Luftës II Botërore, por nuk arriti të imponohej si baza e një gjuhe standard. Si rezultat i zhvillimit objektiv, të dy variantet letrare kryesore e vijuan konvergencën e tyre, por njëkohësisht u konsoliduan si tërësi më vete.

Nga fundi i periudhës, kur nevoja për një standard të vetëm po bëhej domosdoshmëri, doli në sipërfaqe rivaliteti ndërmjet dy varianteve. Paralelisht me idenë e vjetër të konvergencës së tyre, u përvijua alternativa për ta ruajtur situatën e krijuar dhe madje për t'i zgjeruar dallimet midis dy varianteve kryesore. Kjo ishte një përpjekje që dy variantet të shndërroheshin në dy orientime

kulturore të ndryshme, të mbështetura në dallimet gjeografike, etnografike, dialektore, fetare dhe të tjera, madje duke e vënë në pikëpyetje edhe njësinë kombëtare. Shprehja e përqendruar e të gjitha këtyre ka qenë parulla: ashtu si shqipja në flamur ka dy krerë, ashtu edhe gjuha shqipe ka dy kryedialekte. Kundërshtitë e sotme i kanë rrënjët në këtë debat të asaj kohe. Por diskutimet për gjuhën kombëtare shqipe u ndërpre në Lufta II Botërore.

3. *Shqipja standard*. Vendosja e diktaturës në Shqipëri pas Luftës II ka pasur pasoja mbi gjithë jetën e kombit, duke mos përjashtuar edhe çështjet e gjuhës. Ndërmjet tyre duhen veçuar dy aspekte të problemit gjuhësor. Së pari, synimi gjithëpërfshirës i partisë-shtet për të standardizuar gjithë jetën sipas një modeli ideologjik u shfaq në këtë fushë si synimi, i mbështetur nga regjimi, për të njëjësuar shqipen. Së dyti, zhvillimi i brendshëm objektiv i vetë gjuhës, që i përgjigjet evoluimit të saj në kohët moderne. Do të ishte një mendjelehtësi të shpërfilleshin kërkesat e një shteti të centralizuar në kohën tonë dhe të një kulture në sfondin e mjeteve të komunikimit masiv, të lëvizjeve demografike masive, të telekomunikimeve masive, të propagandës masive e kështu me radhë.

Pas një procesi të gjatë e të ndërlikuar historik ishin pjekur rrethanat që njëra nga format e “shqipes së lëvruar” të kthehej në gjuhë standard. Rrugën e këtij procesi e shënojnë disa ngjarje kryesore.

Dy konferenca më 1952 u përqendruan në çështjen e “gjuhës letrare kombëtare”. Në referatin e paraqitur në konferencën e dytë (shtator 1952), Dh. S. Shuteriqi mbrojti idenë se toskërishtja letrare ka mbizotëruar mbi gegërishten letrare. Referati i Shuteriqit ndeshi edhe kundërshtime. Prof. A. Xhuvani dhe E. Çabej këmbëngulën për një proces evolimi për disa breznitë, duke pritur një afrim të dy dialekteve në shkrim. Por tashmë këtij debati të gjatë e të ndërlikuar iu dha fund dhe ai do të ringjallej dyzet vjet më vonë.

Konferenca kombëtare për ortografinë më 1953 rekomandoi vazhdimin e procesit të njësimit të drejtshkrimit, duke nënkuptuar se shqipja letrare duhej të mbështetej në variantin e përpunuar të ortografisë së toskërishtes. Varianti toskë, tashmë më i njësuar dhe i pasuruar intensivisht, mbizotëroi në botimet zyrtare dhe të tjera. Më 1956 një drejtshkrim i rishikuar trajtonte me hollësi problemet e njësimit dhe bëri një hap përpara në standardizimin e të dy varianteve letrare, që ende ishin në përdorim në atë kohë. Zgjidhjet në dy variante u pakësuan ndjeshëm. Por gegërishtja letrare, më e larmishme në trajta sepse vetë dialekti i gegërishtes ka më shumë nënvariate të dallueshme, u kufizua në letërsi, teatër, film, humor e këngë. Përdorimi i përgjithshëm publik *de facto* tashmë e kishte dhënë zgjidhjen, që gjuha standard do të bazohej në shumë tipare (veçanërisht në fonetikë) të përbashkëta për shumicën e varianteve të toskërishtes, por pa përjashtuar disa tipare nga gegërishtja. Fjalët dhe shprehjet janë parë si pjesë e përbashkët e gjuhës shqipe, pavarësisht nga trajtat dialektore të prejardhjes së tyre.

Hapi vendimtar drejt standardizimit u ndërmor më 1967 me botimin e *Rregullave të drejtshkrimit të shqipes*, me synimin që të paraqitej një gjuhë kombëtare e njëtrajtshme. Edhe në Kosovë u organizuan tri konferenca: më 1952, 1957 dhe 1965. *Orthografia* e botuar më 1964 ishte kodifikimi më i avancuar i variantit gegë, duke përfshirë elementë të rinj të konvergjencës. Një pikë kthese ka qenë Konferenca gjuhësore e Prishtinës më 1968, që miratoi gjuhën letrare të përdorur në Shqipëri, duke hequr dorë nga standardi i gegërishtes dhe duke zbatuar parimin: “Një komb - një gjuhë”. Ishte hapur rruga për *Kongresin e Drejtshkrimit* të vitit 1972 në Tiranë, me përfaqësues të autoritetshëm nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Italia.

Kongresi i Drejtshkrimit miratoi një rezolutë. Ajo konsiderohet si një moment kthese në standardizimin e gjuhës shqipe. Pamjen e



një gjuhë kombëtare të stabilizuar e të lëvruar e plotësuar një varg botimesh të rëndësishme akademike: rregullat e drejtshkrimit më 1973 dhe fjalori drejtshkrimor më 1976, gramatika (1976), fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980). Për kujdesin ndaj kulturës së gjuhës (Sprachpflege) u hapën dy revista të reja: *Gjuha jonë* (1981 në Tiranë) dhe *Gjuha shqipe* (1984 në Prishtinë). U mbajt një seminar për problemet e gjuhës letrare më 1980 në Prishtinë (punimet janë botuar më 1983). Ndërsa në Tiranë u organizua një konferencë tjetër gjuhësore “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”. Këtë radhë u përcaktua një synim i ri: të ecej më tej në standardizimin e gjuhës së folur, një synim ky irreal, i proganduar nga prof. A. Kostallari.

Përdorimi i variantit standard njëtrajtësh u bë i detyrueshëm pas vitit 1972 dhe nuk u botuan më tekste të reja letrare në variantin e gegërishtes. Shqiptarët e Kosovës nisën ta përdornin variantin standard me vetëdije në veprimtaritë zyrtare, në media dhe në veprat letrare, duke i kushtuar gjithë kujdesin. Kërcënimi nga ana e serbëve për të shpikur një gjuhë shqipe tjetër, që do të quhej “shiftarski jezik”, ka qenë një faktor i rëndësishëm për shqiptarët e Kosovës që të miratonin shqipen standard, si një mjet për identifikimin kombëtar me shqiptarët e tjerë (Lloshi, 1991). Pasojat e Kongresit të vitit 1972 qenë të menjëhershme në gjithë botën shqipfolëse. Madje edhe librat e gramatikës së shqipes, të përgatitura nga të huajt u mbështetën këtej e tutje në standardin letrar të njësuar, edhe radiostacionet e huaja, që japin emisione shqip, pranuan standardin. Domosdoshmëria objektive fitoi epërsi mbi të gjitha paragjykimet.

Shqipja standard sot është e aftë t’u përgjigjet gjithë kërkesave dhe nevojave të jetës shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, artistike dhe intelektuale. Variante krahinore jetojnë në bisedën e përditshme, në letërsinë artistike, shfrytëzohen për efekte stilistike, por kjo është një situatë jo fort e ndryshme nga gjendja në gjuhët e

tjera standard të Europës. Në thelb, gjuha e shkruar nuk ka shumë dallime nga gjuha e përditshme. Varianti i shkruar ushtron ndikim mbi gjuhën e folur, sepse është varianti me prestigj.

*10. Kundërshtia.* Ndryshimet e mëdha në Europën Lindore më 1989 e tronditën edhe regjimin e rreptë totalitar në Shqipëri; zgjedhjet e para demokratike u mbajtën në mars 1991. Që në fillimet e tij “revolucioni demokratik” në Shqipëri u shoqërua nga një komponente e fortë gjuhësore. Veprimtaritë publike, manifestimet politike dhe demonstratat e dhunshme ushqyen një dëshirë të akumuluar prej kohësh për të shkatërruar gjuhën e fosilizuar dhe të kontrolluar rreptësisht të ideologjisë komuniste ortodokse. Disa njerëz shpresonin se shkatërrimi i modelit autoritar dhe ultracentralist të regjimit të vjetër do të gjente jehonë edhe në gjuhë e, në mënyrë më të përgjithshme, në çdo aspekt të kulturës. Nisi të frynte një erë e tipit të “proletkultit” pas revolucionit në Rusi. Në këtë atmosferë u sulmua edhe shqipja letrare e njësuar. Ka disa rrethana, që përcaktojnë rreziqet e regresit, me të cilin mund të përballohet shqipja standard. Është krejt e mundshme që analfabetizmi mund të ringjallet përsëri në Shqipëri. Me sa duket pakkush tregon ndonjë kujdes të veçantë, që të përdoret gjuha e rregullt në veprimtaritë publike dhe në botimet e shumëllojshme. Fjalori i pahijshëm ka marrë të drejta qytetare madje edhe në gojën e fëmijëve. U është hapur porta më dy kanatat huazimeve të pakontrolluara, në pjesën më të madhe të panevojshme. Purizmi është flakur si shfaqje e politikës së mëparshme të izolimit.

Një shfaqje interesante e pluralizmit të posavendosur në Shqipëri është rigjallërimi i interesit për të shkruar variantin gegë. Në dimrin e vitit 1990 nisi botimi i një reviste jetëshkurtër, me synimin e vendosur, që “të mos lihet gegërishtja letrare të vdesë, ashtu siç e kishte dekretuar qeveria shqiptare staliniste”. Për këtë qëllim u organizua një tryezë e rrumbullakët në Shkodër më 26

korrik 1992 dhe u botua një Deklaratë. por e nënshkruar nga një numër “gjuhëtarësh shkodranë” kaq i ekzagjeruar, sa që e bën të pabesueshme. Në nënvariantin e Shkodrës nisi botimi i disa revistave, midis tyre i një titulli të vjetër me prestigj të orientimit katolik. Shkrimtarët gegë janë tashmë të lirë të përdorin variantin që parapëlqejnë.

Për të përkujtuar njëzetvjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit më 20-21 nëntor 1992 u organizua në Tiranë një konferencë me temën: “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe bota shqiptare sot”. Shumica e pjesëmarrësve, duke përfshirë shqiptarët nga Kosova dhe diaspora, e mbështetën standardin kombëtar, por pati edhe reagime negative. Materialet nuk u botuan, që do të thotë se rezultatet nuk u konsideruan të kënaqshme nga drejtuesit e sapoemëruar të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë. Një vit më vonë u thirr një konsultë tjetër, kushtuar gjuhës shqipe me nismën e Institutit (tetor 1993), duke synuar që të hapej rruga për “strategjinë e re” në gjuhësinë shqiptare. Këtë radhë reagimi në shtyp ishte i nxehtë dhe tejet i politizuar nga të dyja anët. Së fundi, pas një seminari për gjuhën dhe letërsinë shqipe, të organizuar më 1995 në Tiranë nga Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, kur autoritetet më të larta shtetërore deklaruan se gjuha standard nuk ishte një çorbë e regjimit të kaluar, ujërat sikur u qetësuan. U pranua se shqipja standard është një mjet i pazëvendësueshëm i njësisë kombëtare, se ka qenë produkt i një zhvillimi të gjatë kulturor dhe se zgjidhja më realiste është të vazhdojë të zhvillohet më tej dhe të përsoset. Nga ana tjetër, asgjë nuk ka përse të pengojë përdorimin e lirë të variantit verior (si dhe të nënvarianteve më të kufizuara) në letërsi, në shfaqjet artistike, në gazetari ose gojëtar.

Gjatë pesë vjetëve diskutimi gjuhësor në Shqipëri u shndërrua në një debat politik lakuriq dhe mjaft agresiv. Shkatërrimtari më i

zellshëm i shqipësis letrare ka qenë A. Pipa (1989), me librin e tij që është burimi i të gjitha çështjeve në diskutim. Ai e sulmoi shqipëris letrare në të gjitha anët, duke e quajtur një dukuri të kolonializmit gjuhësor të brendshëm, një stratagjemë të përpunuar për të vendosur hegjemoninë kulturore të një pjese minoritare të kombit mbi pjesën tjetër dhe një mashtrim kolosal. Madje ai sulmoi edhe procesin historik deri më 1944.

Shumica dërrmuese e autorëve e pranojnë shqipëris letrare po me ato cilësime, që është karakterizuar në 30 vjetët e fundit. Një varg shkrimtarësh bashkëkohorë janë shprehur drejtpërdrejt në mbrojtje të gjuhës letrare (I. Kadare, R. Qosja, D. Agolli, M. Isaku etj.). Mjaft gjuhëtarë shqiptarë, duke e pranuar domosdoshmërinë e gjuhës standard, nuk janë pajtuar me interpretimet e imponuara nga A. Kostallari (1968, 1970, 1972), por njëkohësisht pa e mohuar kontributin e tij. Ata hedhin poshtë si përpjekjet e A. Kostallarit për të vërtetuar se kjo është “një *koine* letrare e njësuar *sui generis*”, ashtu edhe orientimin regresiv të A. Pipës: “dialektet duhet të lireshin të evoluonin në rrugën e tyre të natyrshme”. Ata pohojnë ndërkaq, se shqipja letrare është një gjuhë standard e zakonshme dhe jo ndonjë produkt i konvergjencës së dy dialekteve; duket qartë se ajo është bazuar në fonologjinë dhe morfologjinë e toskërishtes dhe, natyrisht, në strukturën e saj përfshihen elementët themelorë të gjuhës shqipe. Kurrë ndonjëherë dialektet nuk evoluojnë vetvetiu deri në nivelin e një gjuhe standard ose të shkrihen në një gjuhë të përbashkët. Një gjuhë standard gjithmonë nënkupton një zgjedhje, ky është një akt i politikës kulturore kombëtare, që pasqyron nevojën historike për të krijuar një gjuhë kombëtare të përbashkët jo në kuptimin e përdorimit të përditshëm, por për komunikimin social, për përdorimin publik, në radhë të parë në trajtën e shkruar, madje që kërkon të mësohet në shkollë. Mbështetësit e A. Pipës në fakt tashmë luftojnë jo për një gegërishte standard, por për një nënvariant të ngushtë mbi bazën e së folmes së Shkodrës.

Edhe ata që e mbështesin plotësisht shqipen standard janë për një rishikim të procesit historik mbi baza më objektive dhe jo tendencioze. Ka disa çështje në diskutim: interpretimi teorik, shtypja e diskutimit të lirë, politizimi i skajshëm, këmbëngulja e tepruar në normativizimin, ndalimi i variantit verior në letërsinë e re, rrugët e përmirësimit të mëtejshëm të drejtshkrimit. Të paktën tashmë shpresohet që diskutimi të vazhdohet me një rrugë më shkencore e të arsyeshme dhe jo të papërmbyjtur.

Ngritja e shqipes deri në nivelin e një standardi kombëtar mund të vëzhgohet drejtpërdrejt si një realitet i gjallë e dinamik dhe prandaj është me interes edhe për gjuhësinë teorike.

#### BIBLIOGRAFI

- BARIC, H. (1955): *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*. Prishtinë.
- BOPP, F. (1854): *Ueber das Albanesische in seinem verwandtschaftlichen Beziehungen*. "Abhandl. d. Press. Akad. d. Wissenschaften, Phil. hist. kl".
- CIMOCHOWSKI, W. (1973): *Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoeuropiane*.
- ÇABEJ, E. (1976): *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Tiranë, vëll. I 1982, vëll. II 1976, vëll. III 1987, vëll. IV 1997.
- ÇABEJ, E. (1976): *Studime gjuhësore*, Prishtinë, vëll. I-III 1976, vëll. IV, VI 1977, vëll. V 1975.
- ÇABEJ, E. (1974): *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*. "Studime filologjike", nr. 2
- ÇABEJ, E. (1975): *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare*. "Studime filologjike", nr. 1.
- DEMIRAJ, SH. (1986): *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- DEMIRAJ, SH. (1988): *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Tiranë.
- GEORGIEV, VL. (1960): *Albanisch, Dakisch-Mysisch und Rumanisch*. "Balkansko ezikoznanie", nr. 2
- GJINARI, J. (1989): *Dialektet e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- HAHN, GEORG VON (1854): *Albanesische Studien*. Wien.
- HAMP, E.P. (1972): *Albanian*. "Linguistics in Western Europe", vol. 9. Series Current Trends in Linguistics.

- JOKL, N. (1911): *Studien zur albanesischen Etymologie und Worthildung*. Wien.
- JOKL, N. (1967): *Marrëdhëniet e afrisë së shqipes me gjuhët e tjera indoevropiane*. "Studime filologjike", nr. 3.
- KOSTALLARI, A. (1968): *Sur les traits principaux de l'albanais littéraire contemporain*. "Actes du Premier Congrès Int. des Etudes balkaniques et Sud-Est Européennes". Sofje, VI.
- KOSTALLARI, A. (1970): *La langue littéraire albanaise dans la période de l'édification du socialisme*. "Studia Albanica", nr. 1.
- KOSTALLARI, A. (1972): *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrim it të saj*. "Kongresi i Drejtshkrim it të gjuhës shqipe 1972". Tiranë.
- LLOSHI, XH. (1984): *Modern Albanian in different cultural contexts*. "Studia Albanica", nr. 2.
- LLOSHI, XH. (1991): *Kultura shqiptare përpara shqetësimesh të reja*. "SOT", nr. 5-6.
- LLOSHI, XH. (1996): *Albanian: The Rise of a Language to a National Standard*. "Sprache und Politik: Die Balkansprachen in Vergangenheit und Gegenwart". München.
- MEYER, G. (1884): *Ueber die Stellung des Albanesischen im Kreise der indogermanischen Sprachen*. "Beiträge zur Kunde der indogerm. Sprachen". Göttingen.
- PEDERSEN, H. (1900): *Die Gutturale im Albanesischen*. "Zeitschrift für vergl. Sprachforsch. auf dem Gebiete der IG. Sprachen". Berlin.
- PIPA, A. (1989): *Politics of Language in Socialist Albania*. Boulder, Columbia U.P.
- SANDFELD, K. (1930): *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*. Paris.
- THUMB, A. (1926): *Altgriechische Elemente der Albanesischen*. "Indogermanischen Forschungen", 26.
- THUNMANN, J. (1774): *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker*. Leipzig.
- WEIGAND, G. (1925): *Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrer oder der Thraker?* "Balkan Archiv", Leipzig.

*Hartuar anglisht për vëllimin: Handbuch der Südosteuropa - Linguistik, përgatitur nga prof. Uwe Hinrichs, Leipzig, 1997.*



## **PËRMBAJTJA**

<i>1. Kultura shqiptare përpara shqetësimesh të reja .....</i>	<i>3</i>
<i>2. Variacioni dhe norma drejtshkrimore .....</i>	<i>53</i>
<i>3. Nënstandardi i shqipes dhe marrëdhëniet e tij me shqipen standard .</i>	<i>63</i>
<i>4. Shqipja: ngritja e një gjuhe në nivelin e standardit kombëtar .....</i>	<i>74</i>
<i>5. Shqipja e sotme në kontekste të ndryshme kulturore .....</i>	<i>97</i>
<i>6. Gjuha letrare shqipe, stilet funksionale dhe kultura shqiptare.....</i>	<i>120</i>
<i>7. Gjuha shqipe.....</i>	<i>129</i>



XHEVAT LLOSHI

*MBESHTETJE PER GJUHEN LETRARE*

Formati: 61x86/16

Tirazhi: 1000 kopje

Nr. i botimit: 00271

Shtypur në Shtypshkronjën  
e Shtëpisë Botuese "Toena"

Rr. "M. Gjollësia"; Kutia Postare 1420

Tel: (042) 40116; 40117

Tel/Fax: (042) 27232

Tiranë, 1997

Gjatë këtyre viteve të përmbysjeve të mëdha politike e shoqërore në Shqipëri u sulmua edhe gjuha shqipe letrare, madje u vu në pikëpyetje edhe parimi "Një gjuhë - një komb".

Me argumentime shkencore dhe historike, disa herë edhe me një stil të fortë polemik, autori i këtij libri, dr. Xhevat Lloshi, po gjatë këtyre viteve ka shkruar për të provuar se "Gjuha letrare është një arritje e rëndësishme e kulturës shqiptare"

Disa nga punimet botohen për herë të parë shqip, pasi ato janë lexuar në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe ishin botuar vetëm në gjuhë të huaj.

Një libër jo vetëm për mësuesit e studentët, por për gjithë dashamirët e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare.